



Muhamed Xhevàd Mugnijeh

FIKHU I IMAM

XHA'FERR SADIKUT

(Paqja goftë mbi të!)

III

Titulli: **Fikhu i Imam Xha`ferr Sadikut** (*Paqja qoftë mbi të!*) **III**

Autori: **Muhamed Xhevàd Mugnijeh**

Përktheu: **H. Selim Stafa** (*Allahu e mëshiroftë!*)

Recensent: **H. Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Perkujdesja garfike: **Sabrie Feza**

Kapaku: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata FLLADI**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

AGJËRIMI

Kuptimi i agjërimit

Nga ana gjuhësore, fjala “agjërim” do të thotë: ndalim, heqje dorë, lënie. Ai që ndalohet, që heq dorë e që lë një send, në të vërtetë ai ka agjëruar. Për këtë kuptim të agjërimit flet ajeti 26 i sures “Merjem”:

“فَقُولِي إِنِّي نَذَرْتُ لِلرَّحْمَنِ صَوْمًا فَلَنْ أُكَلِّمَ الْيَوْمَ إِنْسِيًّا”

“...dhe thuaj: unë kam vendosur heshtje për të Gjithëmëshirshmin dhe sot nuk i flas asnjë njeriu.”

Agjërim, në ligjin e fesë, do të thotë: ndalim prej disa gjerave të veçanta, të cilat, në ligjin e fesë janë të ndaluara, si ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime me gruan. Agjërimi është në kohë të përcaktuar, që fillon me zbardhjen e agimit dhe mbaron me perëndimin e diellit, me kusht që ky ndalim të jetë me nijet për

afrim te Allahu i Lartësuar, bindje e nënshtrim ndaj madhështisë së Tij dhe përvetësim të urdhrit të Tij.

Kategoritë e agjërimit

Agjërimi i ligjësuar, në ligjin e fesë, ndahet në katër kategori: agjërimit detyrim, që është agjërimi në Muajin e Ramazanit dhe agjërimit kaza për ditët e Ramazanit, në të cilat nuk është agjësuar, agjërimit haram, siç është agjërimi në dy ditët e bajrameve, agjërimit mustehab siç është agjërimi në ditët e bardha, që i korrespondojnë datave: 13, 14 e 15 të çdo muaji hënor, si dhe agjërimit mekruh, në kuptimin e pakësimit të shpërblimit, siç është agjërimi tri ditë pas ditës së Bajramit, sepse këto ditë, ashtu siç ka thënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), janë ditë për të ngrënë e për të pirë.

Nijeti i agjërimit

Në të vërtetë, nijeti për afrim te Allahu është shpirti e trupi i adhurimit, qoftë për agjërimit, qoftë për falje namazi, ose për kryerjen e Haxhit, ose për dhënien e zekatit. Më sipër e kemi trajtuar kuptimin e nijetit si nxitës për veprim. Këtu është e rëndësishme të dihet fillimi i kohës së agjërimit, domethënë: në ç'kohë duhet të fillohet agjërimi. Meqenëse dihet se agjërimi fillon me zbardhjen e agimit të vërtetë dhe duke ditur se nijeti është kusht për vlefshmërinë e agjërimit, vetvetiu rezulton se është detyrim i imponuar që nijeti të bëhet që në fillim të agimit, ose edhe para agimit dhe ky nijet të vazhdojë deri në fundin e ditës,

atëherë kur përfundon agjërimi. Është shumë i njohur hadithi i Profetit më të madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “S’ka agjërim, kur nijeti për agjërimin nuk bëhet natën.” Kjo është baza e kërkesës për nijetin, pa asnjë dallim, nëse është agjërim farz, apo është agjërim jo farz. Gjithashtu, s’ka asnjë dallim, nëse nijeti është lënë me qëllim apo është lënë nga harresa. Fukahatë, prej këtij rregulli bazë, pasi është vërtetuar prej Ehli Bejtit vlefshmëria e agjërimin në disa raste, kanë nxjerrë argumente që tregojnë vlefshmërinë e agjërimin, edhe kur është vonuar nijeti më shumë se koha e agimit. Këto raste janë:

1- Kur udhëtari arrin deri në kufirin e lejimit para kohës, kur dielli kapërcen zenitin dhe ai akoma nuk ka shtënë gjë në gojë, por as nuk ka bërë nijet të agjërojë. Në këtë rast, ai ka të drejtë të bëjë nijet agjërimin e kësaj dite dhe agjërimi i tij është i vlefshëm, madje edhe kur kjo ndodh në muajin e agjërimin. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që kthehet nga udhëtimi në Muajin e Ramazanit, por ai nuk ka marrë asnjë ushqim, deri para kohës kur dielli kapërcen zenitin. Si duhet të veprojë ky njeri? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Ai agjëron.”

Në një transmetim tjetër, i përcjellë prej Ebu Besirit, tregon se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nëse ai kthehet para se dielli të kapërcejë zenitin, ai e ka detyrim të agjërojë në këtë ditë, madje me këtë ditë ai futet në agjërimin e zakonshëm.”

I ngjashëm me shembullin e këtij udhëtari është edhe rasti kur i sëmuri shërohet para se dielli ta kapërcejë zenitin, kur ai nuk ka marrë asgjë nga sendet që prishin agjërimin.

2- Kur nuk e di se nesër është Ramazan, ose ka harruar plotësisht se e nesërmja është ditë Ramazani, ai e bën nijet të agjërojë para se dielli të kapërcejë zenitin dhe agjërimi i tij është i vlefshëm dhe mbi atë nuk rëndon asnjë detyrim. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët në lidhje me çështjen e mësipërme dhe për këtë janë mbështetur në transmetimin që tregon se, kur një banor i shkretëtirës erdhi te Profeti (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ditën e dyshimit dhe dëshmoi se ai ka parë hënën e re, ndërkaq Profeti (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhëroi dikë që thoshte: “Kush nuk kishte ngrënë, le të agjëronte dhe, kush kishte ngrënë, le të ndërpriste ngrënien e pijen.”

Ky transmetim, në mënyrë të veçantë, bën vlerësimin për atë që nuk e di se është Ramazan. Gjithashtu, për analogji me atë që nuk di, është futur në këtë rregull edhe ai që harron. Pra, baza për këtë rregull është fjala e përbashkët e të gjithë fukahave.

3- Ai ka të drejtë të bëjë nijet me përzgjedhje, deri para se dielli të kapërcejë zenitin, kur agjëron kaza muajin e Ramazanit. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që kishte detyrim të agjëronte disa ditë prej Muajit të Ramazanit dhe ai ka qëllim që t’i agjërojë ato ditë. Kur e bën nijetin e agjërimit ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Ai e ka me përzgjedhje, pra, e bën nijetin për të agjëruar deri para kohës që dielli kapërcen zenitin dhe le të agjërojë, pavarësisht se ka bërë nijet të mos agjërojë.” Pyetësi tha: “Nëse ai ka bërë nijet për të mos agjëruar, a është në rrugën e drejtë, nëse ai bën nijet të agjërojë, pasi dielli ka kapërcyer zenitin?” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Jo.”

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Po, le të agjërojë.”, duke vënë në konsideratë sikur atij nuk i ka ndodhur ndonjë gjë që e bën detyrë prishjen e agjërimit. Mbase këtë transmetim e kanë adresuar për rastet e domosdoshmërisë.

I ngjashëm me këtë rast, është edhe rasti i atij që ka detyrim agjërim të taksur (nedhr), ose ka detyrim agjërim për shkeljen e betimit, ose ka detyrim të agjërojë për shlyerje (prishje e agjërimit me dashje në ditët e Ramazanit). Ky njeri ka të drejtë të bëjë nijet agjërimin, deri para se dielli të kapërcejë zenitin, me kusht që të mos ketë marrë e të mos ketë bërë asgjë nga ato që prishin agjërimin.

4- Për atë që dëshiron të kryejë agjërim të vullnetshëm, ose agjërim nafile, ai ka të drejtë të bëjë nijetin për agjërimin gjithë ditën, madje, edhe pasi dielli të ketë kapërcyer zenitin. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që kryen agjërim të vullnetshëm, por atij i del një nevojë? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai le të për zgjedhë, nëse qëndron deri pas namazit të pasdites dhe pastaj atij i rezulton se duhet të agjërojë, nëse dëshiron, ai agjëron, edhe nëse më parë nuk e kishte bërë nijet të agjëronte.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon: “Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), hynte në familjen e vet dhe thoshte: “Kini ndonjë send për të ngrënë, ndryshe agjërova.” Nëse ato kishin ndonjë send, ia jepnin, ndryshe ai agjëronte.

Nga këto që u thanë, u bë e qartë se, kush ka detyrim të agjërojë Muajin e Ramazanit, duhet të bëjë nijetin, sapo të zbardhë agimi, ose para agimit dhe, kush e le nijetin pa bërë me qëllim, agjërimi i tij është pa vlerë dhe kërkon faljen e mëkatit për personin në nevojë, siç është ai që nuk e di dhe ai që harron. Prandaj le të bëjë nijetin deri në kohën para se dielli të kapërcejë zenitin. Kurse ai që ka detyrim agjërimin jo në Muajin e Ramazanit, ai ka të drejtë të shtyjë nijetin sipas dëshirës, deri para kohës kur dielli kapërcen zenitin, me kusht që ky agjërim i detyrueshëm të mos jetë i ngushtuar në kohën e tij, ndryshe ky agjërim hyn plotësisht në dispozitën e agjërimit në Muajin e Ramazanit.

Kurse ai që ka dëshirë të kryejë agjërim të vullnetshëm, ka të drejtë të bëjë nijetin për agjërim deri në fundin e ditës. Prej këndeje dalin disa çështje:

- Mjafton edhe një nijet i vetëm për të gjithë Muajin e Ramazanit dhe nuk është detyrë që nijeti të bëhet për çdo ditë të veçantë, duke ditur se më sipër kemi edhe motivimin për nijetin.

- Në qoftë se ai e le nijetin e agjërimit në Muajin e Ramazanit me qëllim, duke qenë i vendosur që natën e parë për të mos e agjëruar të nesërmen, por kur gdhin me këtë nijet, ai pendohet, bën teube dhe kthen në rrugën e Zotit të tij.

Përveç kësaj, ai akoma nuk ka ngrënë e nuk ka pirë asgjë dhe nuk ka bërë ndonjë veprim që e prish agjërimin, me fjalën e përbashkët të fukahave, ai nuk e përsërit nijetin për agjërimin, as para se dielli të kapërcejë zenitin e as pas kësaj kohe. Fukahatë kanë mes tyre kundërshtime, nëse mbi këtë person mbetet detyrë

që krahas agjërimit kaza të kësaj dite, të kryejë edhe agjërimit për shlyerje, apo mjafton të kryejë vetëm agjërimit kaza të kësaj dite. Në të vërtetë, ai as nuk kryen as agjërimit kaza dhe as agjërimit për shlyerje, për shkak të origjinës së shfaqjesimit për detyrimin e shlyerjes, sepse argumentet e bazojnë detyrimin për shlyerjen në ngrënien, pirjen, në kryerjen e marrëdhënieve intime me gruan, si dhe me prishësit e tjerë të agjërimit.

- Kush agjëron ditën e dyshimit me nijet se ajo ditë është prej ditëve të muajit Shaban, ose agjëron thjesht si agjërimit i vullnetshëm e agjërimit nafile, ose kryen agjërimit kaza që kishte detyrë, por më pas për të bëhet e qartë se ajo është ditë Ramazani, kjo ditë agjërimit është e vlefshme vetëm si ditë agjërimit në Ramazan dhe jo për gjë tjetër, sepse agjërimit në Ramazan është detyrimi konkret që kryhet me nijetin e afrimit të Allahu i Lartësuar.

Nijeti për agjërimit nafile, ose për agjërimit kaza në Muajin e Ramazanit, është pa vlerë, është i tepërt dhe s'ka asnjë ndikim mbi origjinën e nijetit, pasi vetë Allahu i Lartësuar e shuan atë nijet. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që agjëron ditën e dyshimit, por në fakt ajo ishte ditë e Ramazanit. A duhet ta agjërojë kaza ai këtë ditë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha pyetësit: "Jo, ajo ishte një ditë në të cilën ai qëlloi."

Në qoftë se ai ka qëllim një punë të lidhur me këtë ditë, sido që të jetë, padyshim që agjërimit i tij është i vlefshëm, sepse puna dhe i urdhëruari ekzistojnë faktikisht dhe qëllimi ka lidhje me bindjen ndaj urdhrit për kryerjen e punës, të cilën ai në fakt po kryen. Për pasojë, përsëritja nuk sjell asnjë dëm në përfytyrimin e

tij, derisa qëllimi vazhdon të jetë i orientuar vetëm në drejtim të punës konkrete.

Në qoftë se ai ngurron në përcaktimin, ai bën qëllim kryerjen e detyrimit, nëse ajo është ditë Ramazani, ose bën qëllim agjërim nafile, në qoftë se dita është prej ditëve të muajit Shaban. Shumica e fukahave të mëvonshëm kanë thënë: “Agjërimi i tij prishet, sepse adhurimi është i kushtëzuar me caktimin.

Sej’jid El Hakijm, në librin “El Mustemsek”, thotë: “Po, agjërimi është i vlefshëm, sepse për të ishte bërë e qartë se ajo ditë ishte e muajit Shaban dhe ai nijetin e kishte bërë për këtë ditë.” E njëjta gjë është edhe kur për të bëhet e qartë se ajo ditë është Ramazan. Nuk ka asnjë argument për të vendosur për njërën prej të dyjave në mënyrë specifike, madje argumenti është mosqenia e kësaj dite, prandaj, kur është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për agjërimin në ditën e dyshimit, ka thënë: “Agjëroje atë ditë, nëse ajo ditë është prej Shabanit. Agjërimi është agjërim i vullnetshëm dhe, nëse ajo ditë është e Ramazanit, ti ke qëlluar në ditën e duhur.”

Pikërisht kjo është e vërteta, sepse ajo që kërkohet, është afrimi te Allahu i Gjithëpushtetshëm. Veç kësaj, agjërimi është detyrim, kur kjo ditë, është ditë Ramazani, prandaj thjesht ngurrimi, nuk sjell asnjë dëm mbi origjinën e qëllimit, derisa qëllimi është një dhe jo për gjë tjetër, sepse nijeti në adhurim, në realitet është detyrim kur ajo që kërkohet është disa, si për shembull, kur personi ka për të kryer më shumë se një detyrim, ose si ai që dëshiron të kryejë dy adhurime, njërin adhurim mustehab, si për shembull, namazi i agimit dhe tjetri adhurim farz, siç është namazi i mëngjesit.

Koha e agjërimit

Allahu i Gjithëpushtetshëm e ka kufizuar fillimin dhe fundin e agjërimit me fjalën e Tij të lartësuar:

“...وَكُلُوا وَاشْرَبُوا حَتَّى يَتَبَيَّنَ لَكُمُ الْخَيْطُ الْأَبْيَضُ مِنَ الْخَيْطِ الْأَسْوَدِ مِنَ الْفَجْرِ ۖ ثُمَّ أَتُمُوا الصَّيَّامَ إِلَى اللَّيْلِ...”

“...dhe hani e pini, derisa në agim të dallohet qartë peri i bardhë prej perit të zi dhe pastaj plotësoni agjërimin deri në mbrëmje...” (Sure “El Bekare”, ajeti 187)

Në lidhje me këtë përkufizim, nuk ka kundërshtim as edhe një mysliman, sepse është prej domosdoshmërive të fesë. Përveç kësaj, këtë përkufizim nuk e kanë kundërshtuar as shumica e fukahave, të cilët janë mjaftuar me thënien e tyre: është haram agjërimi natën, ditën e dy bajrameve, në ditët e Teshrikut për atë që është në Mina dhe që korrespondojnë me datat njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë të muajit Dhul Hixhe.

Kushtet

Disa prej kushteve të agjërimit janë të atilla që e bëjnë agjërimin detyrim. Krahas këtyre kushteve, ka edhe kushte të vetë gjendjes së personit, si për shembull mendja, pastërtia prej menstruacioneve, prej hemorragjisë së lehonisë, sëmundjes dhe të mos jetë udhëtar.

Agjërimi as nuk është detyrim për të çmendurin e as nuk është i vlefshëm, kur i çmenduri agjëron, madje as atëherë, kur çmenduria i shfaqet agjëruetit vetëm një orë në ditë dhe pastaj ajo zhduket, ashtu siç nuk është detyrim për gruan me menstruacione

dhe për gruan në kohën e hemorragjisë së lehonisë, madje edhe kur këto dy lloj hemorragjish shfaqen te gruaja vetëm një çast para se të mbarojë dita, ose ato ndërpriten një çast para agimit.

Gjithashtu, agjërimi nuk është detyrim për të sëmurin, kur agjërimi e dëmton, ashtu siç nuk është detyrim për udhëtarin, përveçse kur ai udhëton për ndonjë mëkat, ose kur udhëtimin e ka profesion, ose kur bën nijet të qëndrojë dhjetë ditë në një vend, ose pas vajtje-ardhjeve tridhjetë ditë në të njëjtin vend, ose kur agjëron tri ditë në Haxh në vend të kurbanit, kur kryen Haxh temetu, ose agjëron dhjetë ditë për të zëvendësuar kurbanin detyrim për atë që është larguar me qëllim prej Arafatit, para perëndimit të diellit, ose kryen agjërim nedhr në një ditë të veçantë, qoftë edhe në udhëtim. A ka të drejtë udhëtari të kryejë agjërim nafile e agjërim mustehab gjatë udhëtimit?

Autori i librit “El Xheuàhir” ka cituar lejimin me kerahet te shumica e fukahave, duke bashkuar transmetimet që argumentojë ndalimin dhe transmetimet që lejojnë agjërimin mustehab dhe ndalimin e agjërimit farz.

Prej kushteve ka që janë të posaçme vetëm me gjendjen e personit, domethënë me shëndetin e tij, por jo me kushtet që e bëjnë agjërimin detyrim, si Islami, sepse agjërimi i jomyslimanit, me fjalën e përbashkët të fukahave, është i pavlefshëm, megjithëse është detyrim edhe për të.

Të tjera kushte kanë të bëjnë vetëm me detyrimin dhe jo me gjendjen e personit, si për shembull, agjërimi i fëmijës që dallon. Shumica e fukahave janë shprehur se adhurimi i këtij fëmije është i vlefshëm, megjithëse ai nuk është detyrim për fëmijën, por

shpërblimi llogaritet për prindërit e fëmijës. Është evidente që shëndeti nuk qëndron në ekzistencën e urdhrit në atë mënyrë që të thuhet: Si të ketë shëndetin dhe fëmija nuk është urdhëruar me këtë adhurim. Nuk ka lidhje mes dispozitave pozitive dhe atyre obliguese.

Ai që është në gjumë dhe ai që humb vetëdijen

Ka mbetur të flasim për atë që është në gjumë dhe për atë që ka humbur vetëdijen. Për sa i përket atij që është në gjumë, ai e ka bërë nijet për të agjëruar, por vazhdon në gjumë deri natën, agjërimi i tij është i vlefshëm dhe ai nuk ka detyrim ta agjërojë këtë ditë kaza. I këtij mendimi është edhe autori i librit “El-Xhevàhir”: “Me fjalën e përbashkët të fukahave, duke u bazuar edhe te transmetimet, nëse ai nuk bërë fare nijet për të agjëruar dhe zgjohet nga gjumi para se dielli të kapërcejë zenitin, ai bën nijet të agjërojë dhe nuk ka detyrim që këtë ditë ta agjërojë kaza. Por në qoftë se ai vazhdon të jetë në gjumë, derisa dielli ka kapërcyer zenitin, atëherë ai ka detyrim që këtë ditë ta agjërojë kaza.”

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë problem, ai ka detyrim të agjërojë për shkak të humbjes së nijetit që është prej kushteve të agjërimit.”

Për sa i përket atij që ka humbur vetëdijen, disa prej fukahave ia kanë aneksuar atij që është në gjumë, prandaj edhe për atë që humb vetëdijen, kanë bërë detyrim ta plotësojë agjërimin kaza, qoftë edhe në rastet kur gjendja e humbjes së vetëdijes vazhdon për disa ditë.

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se ai që humb vetëdijen, nuk ka detyrim të agjërojë kaza ditët kur ishte në gjendjen e humbjes së vetëdijes, madje ata kanë thënë: “Edhe sikur humbja e vetëdijes shfaqet vetëm në njërën prej pjesëve të ditës.”, sepse humbja e vetëdijes e shuan mendjen dhe mungesa e mendjes rrëzon obligimin, qoftë për adhurim farz, qoftë për adhurim mustehab.

Autori i librit “El Xhevàhir” ka thënë: “Kjo është e ngjashme me bazat e me rregullat e medh’hebit, në të cilat vërtetohet emri agjëruës për atë që është në gjumë dhe nuk vërtetohet për të çmendurin e për atë që humb vetëdijen.

Kjo është e vërteta, sepse atij që është në gjumë, nuk i hiqet mendja plotësisht, prandaj ai kur zgjohet, ngrihet me mendje në kokë dhe është e kundërta e atij që ka humbur vetëdijen, prej të cilit mendja largohet menjëherë. Prandaj kur ai zgjohet, është i trullosur dhe nuk ka vëmendje. Pikërisht prej këtij rezultoni se obligimi për atë që është në gjumë vazhdon të mbetet obligim, megjithëse qëllimi i urdhrit nuk ka arritur gradën e veprimit, për shkak të pengesës që ai vazhdon të jetë i shkujdesur, por, kur bëhet i vëmendshëm, zhduket pengesa dhe bëhet detyrim puna dhe është plotësisht si personi që nuk di, megjithëse, ai, pa dyshim, është i obliguar, duke qenë i justifikuar vetëm për aq sa vazhdon mosdija e tij. Por kur ai e mëson çështjen, justifikimi e pengesa bie, për pasojë puna për atë bëhet detyrim.

* * *

PRISHËSIT E AGJËRIMIT

Agjëruesi ka detyrë të ndalohet nga gjërat e veprimet e mëposhtme:

1 dhe 2- Ngrënia e pija, qoftë edhe gjëra jo të zakonshme, si për shembull, gëlltitja e një guraleci dhe pirja e vajgurit.

3- Marrëdhëniet intime me gruan nga përpara e nga prapa prishin agjërimin për vepruesin dhe për atë mbi të cilën u veprua. Për këtë çështje nuk do të zgjatemi në kërkim të argumenteve për të tre pikat, sepse janë argumente të vërtetuara dhe të njohura si domosdoshmëri të fesë.

4- Masturbimi, është i barabartë, qoftë kur kryhet me dorë, qoftë kur kryhet me mjet, sepse masturbimi, në vetvete, është haram dhe si i tillë e prish agjërimin. Por, a i priset agjërimi atij që përkëdhel gruan e vet, ndërkaq sekreton spermë?

Përgjigje:

Në qoftë se sekretimi i spermës është diçka e zakonshme te ky njeri, kur përkëdhel gruan, agjërimi i tij është prishur dhe ai ka

detyrim të kryejë dhe shlyerjen. Por nëse ai nuk kishte qëllim marrëdhëniet intime dhe sekretimi i spermës nuk është i zakonshëm për këtë njeri (në rastin e përkëdheljes), mbi atë nuk rëndon asnjë detyrim. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ngjitet në trupin e gruas së tij në Muajin e Ramazanit. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Derisa nuk ka frikë për veten e vet, s’ka ndonjë problem.”

Për këtë çështje është pyetur edhe babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*). Ai tha: “Unë kam frikë për këtë person, prandaj ai bën mirë të ruhet prej kësaj, përveçse kur ka siguri se nuk do sekretojë spermë.”

Bazuar mbi këto dy transmetime dhe në përmbajtjen e transmetimeve të tjera, në mënyrë absolute dhe pa asnjë hollësi, nëse ndodh sekretimi i spermës, shlyerja (kef’faret) është bërë detyrim.

Kur burri fle ditën dhe, kur zgjohet e shikon veten xhunub, agjërimi i këtij burri është i vlefshëm dhe mbi atë nuk rëndon asnjë detyrim.

5- Të gjithë fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët: Nëse ai që thotë rrena me qëllim për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) agjërimi i atij personi është prishur dhe ai ka detyrim të kryejë shlyerjen. Argumentin për këtë thënie, fukahatë e kanë nxjerrë prej fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ai që thotë rrena për Allahun e për të Dërguarin e Tij, duke qenë agjëruar, agjërimi dhe abdesi i këtij njeriu është prishur.”

Në të vërtetë ky ves i ulët është veprim haram, prandaj njeriu patjetër duhet të ndalohet prej këtij vesi, madje vesi për të thënë rrena është prej mëkateve të mëdha. Detyra për t'u përmbajtur prej rrenës është gjë dhe që rrena është prej prishësve të agjërimit, është një gjë tjetër. Për sa i përket fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Rrena për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij, prish agjërimin dhe abdesin e atij.", është e njëjtë me fjalën tjetër të tij: "Ai që përgojon vëllain e vet mysliman, agjërimi i tij është pa vlerë dhe abdesi i tij është prishur."; "Përgojimi e prish agjërimin dhe përgojuesi ka detyrë të agjërojë këtë ditë kaza.", pavarësisht se dihet se askush nuk ka thënë që përgojimi është prej prishësve të agjërimit, ose prej prishësve të abdesit. Qëllimi me këtë transmetim dhe me transmetimet e tjera të ngjashme, në kuptim me transmetimin e mësipërm, është shtrëngimi i fortë kundër rrenës e përgojimit, sepse, kushdo që i bën këto dy veprime, ose edhe vetëm njërin, është si ai që fal namaz pa abdes, ose si ai që ha e pi në Muajin e Ramazanit, sepse ajo që kërkohet me ndalimin gjatë muajit të adhurimit, muajit të bindjes e muajit të faljes së mëkateve, nuk është thjesht vetëm lënia e ngrënies e pijes, pasi agjërim do të thotë ndalim nga të gjitha gjërat e veprimet haram, veçanërisht rrena për Allahun e për të Dërguarin e Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke shtuar se kjo çështje është përmendur shumë herë në Librin e Allahut, në fjalët e të Dërguarit të Tij dhe në thëniet e Ehli Bejtit të tij, madje edhe në shprehjet e arabëve të mëparshëm e të mëvonshëm.

Në lidhje me mosprishjen e agjërimit për shkak të rrenës për Allahun e për të Dërguarin e Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) janë shprehur studiues të

mëdhenj (muhak'kikijn), ndër të cilët autori i librit “El Xheuàhir”, si dhe autori i librit “Misbàhul Fakijh”.

Gjithashtu, për mosprishjen e agjërimit për shkak të rrenës për Allahun e për të Dërguarin e Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), janë shprehur shumica e fukahave të mëvonshëm, të cilët kanë si dëshmi autorin e librit “El Xheuàhir” dhe autorin e librit “Elu Hadàik”.

6- Ndër fukahatë ka një përhapje shumë të madhe thënia, të cilën e citon edhe autori i librit “El Xheuàhir”, se zhytja e kokës në ujë¹ është prej prishësve të agjërimit dhe është e barabartë, qoftë kur zhyt vetëm kokën, qoftë kur zhyt kokën dhe trupin. Fukahatë e kanë nxjerrë këtë argument prej fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “As agjëruesi e as ai që ka veshur ihramin (rroba e Haxhit) nuk e zhyt kokën në ujë.”

Gjithashtu, fukahatë kanë thënë se motiv për këtë ndalim është dispozita pozitive, domethënë prishja e agjërimit dhe jo vetëm dispozita obliguese, e cila konsiston vetëm në emërtim haram të zhytjes së kokës në ujë. Pikërisht për këtë shkak, fukahatë kanë rënë në konsensus se dispozita për çështjet e adhurimit, tregon prishjen e adhurimit.

Të tjerë kanë thënë: Zhytja e kokës në ujë gjatë agjërimit as nuk është haram dhe as nuk e prish agjërimin, por është thjesht vetëm një veprim mekruh (jo i preferueshëm). Për të argumentuar këtë thënie, ata kanë mbartur transmetimet që e ndalojnë këtë veprim. Këtyre fukahave u është përgjigjur autori i librit “El

¹ Larja e kokës duke derdhur ujë mbi kokë prej një ibriku, ose prej ndonjë mjeti të ngjashëm me ibrikun, me fjalën e përbashkët të fukahave, nuk e prish agjërimin.

Xhevàhir”: “Për jurstin (fakijhun) nuk ka rrugëdalje që të mos pohojë se zhytja e kokës në ujë e prish agjërimin, sepse kjo sentencë është vërtetuar në librin e haditheve të sakta, si dhe me fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Adhuruesit nuk i sjell ndonjë dëm (në agjërimin e tij) ato që ai mund të bëjë, kur ai i largohet ushqimit e pijes, grave dhe zhytjes së kokës në ujë.” Ja, kjo është e vërteta.

7- Arritja e pluhurit të trashë në gojë, pavarësisht nga lloji i pluhurit. Unë nuk kam gjetur ndonjë argument, me të cilin mund të qetësohet shpirti dhe të tregojë se ky lloj pluhuri është prej prishësve të agjërimit. Por autori i librit “El Xheuàvir” ka thënë: “Fjala më e përhapur dëshmon për këtë dhe unë në këtë thënie nuk gjej ndonjë kundërshtim.” Gjithashtu, fukahatë kanë atashuar edhe pirjen e duhanit në dispozitën e pluhurit të trashë. Në të vërtetë, nuk ka dyshim se lënia e duhanit gjatë agjërimit të Ramazanit është veprimi më i mirë e më i plotë, sidomos tani që është rrënjësuar në mendjet e njerëzve se ai që pi duhan, nuk mund të quhet agjëruar. Ne e themi këtë, duke e ditur se dispozitat e ligjit të fesë nuk merren as prej zakoneve dhe as prej rrugëve të njerëzve, përveçse atëherë kur për një veprim ka vendosur Imami i pastër nga gabimet. Gjithashtu, ne e dimë mirë se në kohën e Imamit të pastër nga gabimet, duhani nuk njihej, për rrjedhojë nuk praktikohej as duhanpirja.

Ai që mbështet në miratimin e në argumentet shkresore, ka të drejtë të thotë: Pirja e duhanit mohon edukatën dhe pikërisht për këtë shkak ne nuk pimë duhan kur këndojmë Kur’anin Famëlartë, nuk pimë duhan në xhamitë e në mesh’hedet e nderuara. Gjithashtu, nuk pimë duhan kur falim namaz, madje

nuk pimë duhan as në praninë e të mëdhenjve, prandaj edukata ka vendin e parë në Muajin e madhëruar të Allahut.

8- Prej prishësve të agjërimit është edhe nxjerrja e gjakut të grumbulluar. Në lidhje me këtë çështje prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*) kanë ardhur disa transmetime. Njëri prej transmetimeve i ndalon njerëzit të bëjnë nxjerrjen e gjakut, kur agjërojnë, madje ndalimi është i formës së prerë, pa bërë asnjë diferencim mes të gjakut të lëngshëm dhe gjakut të mpiksur. Transmetimi i dytë thotë: “Për agjëruesin nuk lejohet të bëjë nxjerrjen e gjakut të grumbulluar në brendësi të trupit.” Gjithashtu, pa bërë asnjë diferencim mes llojeve të gjakut. Transmetimi i tretë thotë: “S’ka problem për nxjerrjen e gjakut të mpiksur.”, domethënë, nxjerrja e gjakut të lëngshëm e prish agjërimin, kurse nxjerrja e gjakut të mpiksur nuk e prish agjërimin. Meqenëse ky transmetim bën diferencimin mes dy llojeve të gjakut të mbledhur në brendësi të trupit, në mënyrë të pashmangshme, duhet një transmetim përgjithësues, që të bëjë bashkimin ndërmjet dy transmetimeve, të cilët, nga ana e jashtme, duken kontradiktore, njëkohësisht transmetimi përgjithësues të shërbejë si shoqërues ligjor dhe të vërtetojë se qëllimi me transmetimin e parë, i cili mohon veshjen e specifikës së nxjerrjes së gjakut me termin i mpiksur dhe prej transmetimit të dytë, që vërteton për njerëzit lejimin e nxjerrjes së gjakut të lëngshëm. Vetëm me këtë përjasje bie edhe kontradikta në mes dy transmetimeve.

9- Vjellja me qëllim. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Agjëruesi që provokon të vjellat me qëllim, në të vërtetë, e ka prishur agjërimin, prandaj ka detyrim që këtë ditë ta përsërisë.” Djali i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), Imam Kadhimi (*Paqja*

qoftë mbi të!), ka thënë: “Në qoftë se ai vjell me qëllim, ai ka detyrim të agjërojë kaza. Por nëse vjellja nuk është provokuar me qëllim, atëherë mbi këtë person nuk rëndon asnjë detyrim.”

Qëndrimi në gjendjen *xhunub*

10- I dhjeti e i fundit prej prishësve të agjërimin, është rasti kur agjëruesi, me qëllim, vazhdon të qëndrojë në gjendjen *xhunub* deri në daljen e agimit, pa pasur asnjë domosdoshmëri që e detyron të qëndrojë në këtë gjendje dhe, supozohet se ai po kryen agjërim farz dhe jo agjërim mustehab. Kjo është thënia që ka përhapjen më të madhe, e mbështetur me dëshminë e autorit të librit “El Hadàik” dhe të librit “El Xheuàhir”.

Për këtë çështje, fukahatë e kanë nxjerrë argumentin prej rastit, kur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë, i cili bëhet *xhunub* në Muajin e Ramazanit natën, por ai nuk bën gusël, me qëllim, derisa vjen mëngjesi. Si duhet të veprojë ky burrë? Ai (*Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: “Ai i jep lirinë një robi, ose agjëron dy muaj rresht, ose ushqen gjashtëdhjetë të varfër.”

Çdo gjë e ardhur prej Ehli Bejtin (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!)*, përveç këtyre dy transmetimeve, ose edhe të transmetimeve të tjera, që janë në kuptimin e dy transmetimeve të mësipërme, si dhe kur thënia është e përforcuar dhe është sipas ligjit të fesë, shikojmë: Nëse fjala e ardhur prej Ehli Bejtin është gjithëpërfshirëse, në lidhje me personin që qëndron *xhunub* me qëllim dhe për të tjerë, atëherë del detyrë që personi të kushtëzohet me këtë transmetim dhe, nëse ai kundërshton të

përmbahet në kërkesat e këtij transmetimi, ai është anormal me dëshminë e asaj që ka cituar autori i librit “El Hadàik”, të përcjellë prej Muhak’ikut në librin “El Mu’teber”.

Bazuar mbi sa u tha, dalin këto çështje:

1- Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për atë që qëndron xhunub me qëllim dhe është duke kryer agjërim të vullnetshëm ose nafile: Një burrë kryen agjërim të vullnetshëm në tri datat 13, 14 dhe 15 të çdo muaji hënor, por ai bëhet xhunub në fillimin e natës dhe e di që është bërë xhunub, megjithëkëtë ai fle me qëllim deri në mëngjes. Të agjërojë ky person apo jo?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai agjëron.”

2- Kush gdhihet xhunub në muajin e Ramazanit, pa qëllim, agjërimi i tij është i vlefshëm dhe mbi atë nuk rëndon asnjë detyrim. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë, që bëhet xhunub në fillim të natës gjatë Muajit të Ramazanit dhe ai fle deri në mëngjes. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “S’ka problem, ai bën gusël, fal namaz dhe agjëron.”

Nëse kjo gjendje i ndodh atij kur është duke kryer kaza agjërimin e Ramazanit, agjërimi i tij nuk është i vlefshëm. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që bëhet xhunub dhe nuk bën gusël deri në agim. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Ai nuk e agjëron këtë ditë, por agjëron të nesërmen.” Kjo është dispozita kur koha për të kryer agjërimin kaza është e gjerë. Por nëse koha është e ngushtë, ai hyn plotësisht në dispozitën e Ramazanit.

Të gjithë fukahatë kanë rënë në një fjalë të përbashkët se, ai që bëhet xhunub ditën nga ëndrrat, në mënyrë absolute, agjërimi i tij nuk është prishur, qoftë agjërim farz, qoftë agjërim nafile. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Tri gjëra nuk e bëjnë agjëruetin të prishë agjërimin: vjellja, domethënë vjellja kundër dëshirës, bërja xhunub në ëndërr dhe marrja e gjakut (hixhameh).”

3- Kur ai fle, pa bërë nijet, që të bëjë gusël, agjërimi i tij është prishur dhe ai ka detyrim që këtë ditë ta agjërojë kaza. Do të qe më mirë sikur të mos kishte bërë nijet të agjëronte.

4- Ai që bëhet xhunub në netët e Ramazanit dhe fle me nijet që të bëjë gusël para agimit, por ai vazhdoi të flejë deri në mëngjes, agjërimi i tij është i vlefshëm dhe ai nuk ka detyrim të agjërojë kaza dhe, kur zgjohet, pastaj fle përsëri, me nijetin e tij të parë, që të bëjë gusël para se të vijë mëngjesi. Në këtë rast, ai ka detyrë ta përsërisë agjërimin e kësaj dite. Por nëse zgjohet dhe fle për herë të tretë deri në mëngjes, ai ka detyrë jo vetëm të agjërojë kaza, por ka detyrimin të bëjë edhe agjërimin për shlyerjen.

Argumenti për këtë dispozitë është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur ti bëhesh xhunub në fillim të natës, s’ka ndonjë problem të flesh me nijetin që të ngrihesh e bësh gusël para agimit dhe, nëse të mposht gjumi deri në mëngjes, mbi ty nuk rëndon asnjë detyrim, me përjashtim të rastit kur ti je zgjuar natën dhe fle përsëri pa bërë gusël, ngaqë përtove, atëherë ti ke detyrim agjërimin e kësaj dite dhe përsëritjen e agjëritit në një ditë tjetër. Por nëse ti, me qëllim ke fjetur deri në mëngjes, atëherë ke detyrim të kryesh kaza agjërimin e kësaj dite dhe të bësh agjërimin për shlyerjen.” Shlyerja për prishjen e agjëritit farz me

dashje është: Agjërimi dy muaj rresht, dhënia e lirisë një robi, ose ushqimi i gjashtëdhjetë të varfërve.

5- Kur personi xhunub nuk ka mundësi të bëjë gusël për shkak se s'ka ujë, ose për shkak të sëmundjes, ai ka detyrë të bëjë tejemum para agimit. Por nëse e le tejemumin me qëllim, agjërimi i tij është prishur, plotësisht ashtu siç është çështja në analogjisë me guslin, për arsye se dheu është në pozitën e ujit dhe Allahu e ka bërë dheun të pastër e pastrues, ashtu siç ka bërë të pastër e pastrues edhe ujin, përveç shembujve të tjerë të mundshëm.

6- Kur gruaja në Muajin e Ramazanit pastrohet natën krejtësisht prej menstruacioneve, ose lehona prej hemorragjisë së lehonisë dhe e le gushin, pa pasur ndonjë pengesë, agjërimi i saj është prishur dhe ajo ka detyrim të agjërojë kaza, plotësisht ashtu si burri xhunub. Për këtë çështje tregon fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Në qoftë se gruaja pastrohet prej menstruacioneve natën dhe nga përtacia nuk ka bërë gusël deri në mëngjes, ajo ka detyrë që këtë ditë ta agjërojë kaza.” Dispozita për gruan që pastrohet natën prej menstruacioneve, është vepruese edhe për lehonën që pastrohet prej hemorragjisë së lehonisë. Askush nuk ka folur për ndonjë dallim mes këtyre dy grave. Gjithashtu, nëse këto dy gra kanë pengesë për të bërë gusël, duhet të bëjnë tejemum, pasi tejemumi zë vendin e guslit.

A hyn gruaja me menstruacione dhe gruaja lehonë në të njëjtën dispozitë me burrin xhunub, kur këto dy gra flenë me nijetin për të bërë gusël, por nuk zgjohen deri në mëngjes? Për këto dy gra nuk ka asnjë detyrim, por, nëse ato zgjohen dhe flenë përsëri, ato kanë detyrim vetëm agjërimin kaza. Nëse ato zgjohen

dhe flenë për herë të tretë, atëherë ato kanë detyrim vetëm agjërimin kaza, apo kanë detyrim edhe agjërimin e shlyerjes?

Përgjigje:

Jo, sepse teksti për këtë çështje është specifik vetëm për burrin xhunub. Për më tepër, analogjia te ne është veprim i gabuar. Për sa i përket fjalës së autorit të librit “El Xheuàhir”, i cili thotë se gjendja e gruas me menstruacione është më e rëndë se gjendja e burrit xhunub, do të qe më e plotë, sikur për këtë çështje, në ligjin e fesë, të kishte ndonjë tekst që të tregonte qartë pengesat e sanksionuara në vetë tekstin, prandaj asnjëri prej nesh, cilido qoftë ai, nuk ka të drejtë të vërë pengesa në dispozitat e ligjit të fesë sipas hulumtimeve personale.

Në lidhje me gruan me metrarogji, agjërimi i saj është i vlefshëm, kur ajo bën gusël natën ose ditën, sipas detyrimit që i del, ashtu si shembulli që kemi përmendur në kapitullim “Pastrimi”, kur kemi trajtuar çështjen e gruas me metrarogji, si dhe dispozitat e ligjit të fesë në lidhje me këto kategori grash.

Bazuar mbi sa u tha, ajo ka detyrë të agjërojë kaza, në qoftë se i shkel detyrimet që ka. Autori i librit “El Hadàik” ka thënë: “Meqenëse kjo dispozitë ka konsensusin e fukahave, patjetër që, për rezervë, ka një konsensus akoma më të gjerë, prandaj nuk është e nevojshme të rikthehemi në këtë dispozitë.”

* * *

VEPRIME MEKRUH DHE JO MEKRUH

Të gjitha sendet e veprimet që kemi përmendur në kapitullin e mësipërm, tregojnë se agjëruesi duhet të ndalohet në mënyrë të prerë nga gjëra e veprime të caktuara, por kemi edhe veprime të tjera, të cilat fukahatë i kanë lejuar të bëhen prej agjëruesit pa kerahet, ashtu siç ka veprime të tjera të lejuara, por me kerahet.

Veprimet me kerahet

1- Për agjëruesin është kerahet ta përkëdhelë gruan e tij, sidomos për të rinjtë. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një agjërues që puth gruan e vet. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Për të moshuarin s’ka ndonjë problem, kurse për të riun jo, sepse ai nuk është i sigurt prej epshit.” Fukahatë kanë thënë: “Qëllimi me këtë thënie është për ndalim kerahet dhe jo për ndalim haram.

2- Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për agjëruesen që lyen sytë me kohl. A është i prishur agjërimi i saj? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “S’ka problem, kur

ajo nuk ndien në fytin e saj shijen e kohlit.” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka mohuar krekosjen, por edhe nëse ka më shumë se kerahet. Fukahatë kanë kuptuar prej këtij transmetimi mohimin për dënim, krahas animit që ata kanë për lënien e kohlit gjatë agjërimit.

3- Hyrja në banë, krahas frikës nga dobësia.

4- Nxjerrja e gjakut të grumbulluar me hixhame, ose me mënyra të tjera.

5- Futja e ilaçit në hundë, duke e ditur se ai arrin në fyt. Në lidhje me këtë, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Për agjëruesin është kerahet të fusë ilaç në hundë.”

6- Nuhatja e luleve aromatike, veçanërisht narcisës. Në lidhje me këtë, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Agjëruesi nuk nuhat bimë aromatike.”

Në një transmetim tjetër, ai ka ndaluar nuhatjen e narcizës me emër.

7- Nxjerrja e gjakut të mpiksur, të grumbulluar në brendësi të trupit.

8- Ulja e gruas në ujë.

9- Heqja e dhëmballës.

10- Pastrimi i dhëmbëve me siva të njomur.

11- Shpërlaja e gojës, duke përplasur ujin në gojë (madmadah).

12- Polemika e hipokrizia. Në lidhje me këtë, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur të agjëroni, ruajeni gjuhën tuaj prej rrenës, ulni sytë tuaj, mos u grindni me njëri-tjetrit, mos kini smirë njëri-tjetrit, mos përgojoni njëri-tjetrit, mos shfaqni hipokrizi ndaj njëri-tjetrit, mos përgënjeshtroi dhe mos kundërshtoni njëri-tjetrit...etj.”

Veprime jo mekruh

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka etje në Ramazan. Si duhet të veprojë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “S’ka problem që ai të thithë unazën.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një grua agjëruese që ka një foshnje, për cilën ajo mbllaçit bukën dhe me të e ushqen. A është i prishur agjërimi i saj? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “S’ka problem.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për agjëruesin që futet në ujë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “Po, por ai nuk e zhyt kokën në ujë.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për puthjen që jep agjëruesi në Muajin e Ramazanit. A e prishë ai agjërimin? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “Jo.”

* * *

PRISHJA E AGJËRIMIT DHE DETYRIMI PËR SHLYERJEN

Kur agjëruesi merr ndonjë gjë prej prishësve të agjërimit, me vetëdashje, qoftë kur e di që është agjërueshëm, ose kur harron, ose kur detyrohet për të prishur agjërimin, ose nuk e di se duhet të jetë agjërueshëm, s'ka dyshim se dija, krahas kujtimit që është Ramazan, të gjitha këto janë prishës të agjërimit, shkaktojnë kryerjen e mëkatit dhe bëjnë detyrim agjërimit kaza. Për shlyerjen do të flitet më poshtë me hollësi.

Harresa

Nuk rëndon asnjë detyrim mbi atë që ha, ose pi, ose kryen marrëdhënie intime me gruan, ose bën veprime të tjera prej veprimeve prishëse të agjërimit, duke harruar se po agjëron. Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, përfshirë edhe fjalën e Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur ai harron dhe ha e pi, pastaj kujtohet, ai nuk e prish agjërimin, sepse ajo që ai mori, ishte për të një furnizim nga ana e Allahut të Lartësuar. Prandaj ai le ta

plotësojë agjërimin.” Në këtë kuptim kanë ardhur shumë transmetime të tjera.

Imponimi

Kur agjëruesi e mposht një tjetër dhe i fut në fyt ushqim ose pije kundër dëshirës së tij, me fjalën e përbashkët të fukahave, mbi këtë njeri nuk rëndon asnjë detyrim, sepse në këtë rast, ai është si një vegël që kurdiset. Kur agjëruesi gjendet para një kërcënuesi të fuqishëm, nëse nuk ha ose nuk pi dhe ai ka frikë dëmtimin që mund të pësojë, në këtë gjendje agjëruesi ha dhe pi për të sprapsur dëmtimin prej vetvetes. Për këtë gjendje, shumica e fukahave janë të mendimit se agjërimi i tij është i vlefshëm. Është e padiskutueshme që detyrimi për ndalimin prej prishësve të agjërit nuk mund të trajtohet në një gjendje të tillë. Në të kundërt, ai i largohet gjendjes së vullnetit e të përzgjedhjes, sepse nuk ka ndalim krahas imponimit e domosdoshmërisë. Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) ka thënë: “Prishja e agjërit një ditë në Muajin e Ramazanit, për mua është më e dashur se sa të më presin kokën.”

Autori i librit “El Urvetul Uthkà” ka thënë: “Marrja e ushqimit për shkak të imponimit dhe për të shpëtuar prej dëmtimit, e prish agjërimin. Këtë thënie e të tij e ka miratuar edhe Sej’jid El Hakijm, në librin “El Mustemsek”, i cili thotë: “Hadithi i ngritjes së detyrit shërben për vërtetimin e veprimit të saktë, por ai është transmetim mohues dhe nuk është vërtetues.” Me këtë fjalë, ai ka qëllim hadithin e Profetit (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Prej umetit tim është hequr rëndimi për gjërat që atij i imponohen.” Ky hadith mohon që ngrënia me imponim është haram, por mohimi i haramit është një

gjë dhe vlefshmëria e agjërimit është një gjë tjetër, atëherë hadithi është i huaj të ballafaqohet për vlefshmërinë e namazit, edhe pse tregon mohimin e mëkatit e të dënimit.

Në përgjigje, ne themi: Ajo që kuptohet zakonisht prej argumenteve që tregojnë detyrimin për t'u ndaluar nga marrja e prishësve të agjërimit, në të vërtetë, është ndalim me përzgjedhje e me vullnet, kurse për të imponuarin e detyruar, argumentet janë larguar prej tij. Këtë fakt e përforcojnë transmetimet e ardhura, në lidhje me të drejtën e atij që harron, i cili nuk mban përgjegjësi. Në lidhje me pretendimin e mungesës së këtij koncepti dhe mungesën e këtij largimi prej atij që nuk është i imponuar, është një argument vetëm për ata që e pretendojnë, por jo për të tjerët dhe është plotësisht si pretendimi i largimit. Thënë me një shprehje më të shkurtër e më të qartë, i imponuari, me konsensusin e fukahave, as nuk dënohet e as nuk ndëshkohet. Gjithashtu, me konsensusin e fukahave, mbi të imponuarin nuk rëndon detyrimi për shlyerjen, sepse shlyerja është për fajin e kryer. Këtu nuk kemi faj, atëherë nuk mbetet gjë tjetër ndër ne, përveç kryerjes së adhurimit kaza. Pa dyshim që edhe kryerja kaza ka nevojë për një argument, kurse për mohimin e kryerjes së agjërimit kaza, s'ka nevojë që për këtë çështje të ketë argument, sepse ai përputhet me origjinën.

Mospasja dijeni

Është mjaft i përhapur te fukahatë dhe me dëshminë e autorit të librit “El Xheuàhir” transmetimi që thotë: “Kur agjëruesi merr ndonjë send prej prishësve të agjërimit, duke mos e ditur se ai send e prish agjërimin, mbi këtë njeri mbetet detyrim agjërimi

kaza, si dhe detyrimi për shlyerjen, sepse argumentet tregojnë qartë se kush e prish agjërimin, ai ka detyrim agjërimin kaza dhe shlyerjen. Prandaj kjo vërtetohet si detyrim edhe për atë, që nga padituria, fal namazin të shkurtuar, si dhe për atë që i vë kufi veprimeve, sepse, si njëri, ashtu edhe tjetri, e kanë bërë veprimin me qëllim e me paramendim.

Të gjithë fukahatë, ndër ta edhe Sej'jid El Hakijm, i cili në librin "El Mustemsek" ka thënë: "Në mënyrë absolute, dy kategoritë e atij që di nuk kanë asnjë detyrim.", kanë këtë mendim. Thënien e tyre e kundërshton vetëm autori mjaft i dëgjuar i librit "El Urvetul Uthkà", i cili tregon se dy Imamët, Imam Bakiri e Imam Sadiku (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë për të dy!*) janë pyetur për një burrë, i cili kryen marrëdhënie intime me gruan e vet në Muajin e Ramazanit, ose ai ka veshur ihramin, por mendon se ky veprim për atë është i lejuar. Ata të dy thanë: "Mbi të nuk rëndon asnjë detyrim."

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Çdo njëri që kryen një punë nga padituria, mbi të nuk rëndon asnjë detyrim."

Kur ne nuk pajtohemi me Sej'jid El Hakijmin, në lidhje me çështjen e të imponuarit, në të vërtetë, ne pajtohemi me atë në lidhje me çështjen e personit të paditur (xhahil).

Etja e madhe

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka aq shumë etje, sa ka frikë për jetën e vet. Si duhet të veprojë?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Ai të pijë sa të njomë fytyrën dhe të mos pijë sa të ngopet e të freskohet.”

Disa prej shokëve të vet, i thanë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ne kemi vajza e djem që nuk e përballojnë dot agjërimin për shkak etjes së madhe.” Ai u tha: “Ata le të pinë, aq sa të freskojnë shpirtrat e tyre.”

Kjo thënie e Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka konsensusin e përbashkët të fukahave, plus argumentet që mohojnë dëmin dhe vështirësinë e madhe.

Shlyerja

Agjërimi herë është mustehab dhe herë është farz: agjërim farz në Muajin e Ramazanit, agjërim kaza, agjërim i taksur (nedhr), agjërim në iëtikâf. Agjërimi për shlyerje. Me këtë agjërim bëhet shlyerja për prishjen e agjërimin me qëllim, si dhe agjërimet të tjera. Në mënyrë absolute, nuk ka asnjë detyrim mbi atë që kryen agjërim të vullnetshëm dhe, është e barabartë qoftë kur ai e merr prishësin e agjërimin para se dielli të kapërcejë zenitin, qoftë kur e merr prishësin, pasi dielli e ka kapërcyer zenitin. Me dispozitën e agjërimëve jo nafile do të njihemi më poshtë.

Shlyerja e Ramazanit

Është detyrim agjërimi kaza dhe agjërimi për shlyerje me të drejtën e përzgjedhjes të njërit prej tri mundësive të shlyerjes:

agjërim dy muaj rresht¹, ose lirim të një robi, ose ushqim për gjashtëdhjetë të varfër. Agjërimi kaza dhe agjërimi për shlyerje, së bashku, është detyrim për atë që prish agjërimin në Muajin e Ramazanit me sendet vijuese:

- Me fjalën e përbashkët të fukahave, me tekst, madje si domosdoshmëri të fesë, kur agjëruesi e prish agjërimin me ngrënie, pirje dhe kryerje të marrëdhënieve intime.

Kush prish agjërimin në Muajin e Ramazanit me ndonjë gjë haram, si për shembull pi verë, ose prostituon me femër ose me mashkull, ose ha e pi prej pasurive të njerëzve, në mënyrë të padrejtë e me agresion, kushdo që bën ndonjëherë prej këtyre veprimeve, ka detyrim të bëjë njëherësh agjërimin kaza për ditën që prishi, si dhe agjërimin për shlyerjen me njëherë prej tri kategorive të shlyerjeve, domethënë, ai agjëron dy muaj rresht, ose i jep lirinë një robi, ose ushqen gjashtëdhjetë të varfër.

Transmetohet prej Imamit Rizait (*Paqja qoftë mbi të!*), nipit të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) se dikush i ka thënë atij: “O djali i të Dërguarit të Allahut. Prej të parëve tuaj është transmetuar për një person që në Muajin e Ramazanit, kryen marrëdhënie intime, ose e prish agjërimin me ngrënie e pirje. Ata janë shprehur se ky person ka detyrim të kryejë të tri kategoritë e shlyerjes, por gjithashtu është transmetuar, po prej tyre, se ai ka detyrim të

¹ Që të realizohet agjërimi i dy muajve rresht, është e mjaftueshme të agjërohet një muaj i plotë dhe një ditë prej muajit të dytë. Kur ai e prish agjërimin pas muajit dhe pas kësaj dite, kryen kaza ditët që i kanë mbetur. Në qoftë se ai agjëron një muaj të plotë, pa e agjëruar ditën e muajit pasardhës, ai ka detyrim të rifillojë agjërimin për shlyerjen nga e para, sikur të mos kishte agjëruar asnjë ditë. Në lidhje me këtë dispozitë kanë ardhur disa transmetime prej Ehli Bejt (Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta!).

kryejë vetëm njërin prej shlyerjeve. Cilin të marrim prej këtyre dy transmetimeve?" Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) u tha: "Merri të dy transmetimet."

Kur burri kryen marrëdhënie intime haram, ose e prish agjërimin në Muajin e Ramazanit me sende haram, ka detyrim të plotësojë tri kategoritë e shlyerjeve: i jep lirinë një robi, agjëron dy muaj rresht dhe jep ushqim për gjashtëdhjetë të varfër, plus agjërimin kaza të asaj dite. Por nëse kryen marrëdhënie intime hallall, ose e prish agjërimin me sende hallall, ai ka detyrim të kryejë vetëm një shlyerje, por ai nuk ka asnjë detyrim, nëse e prish agjërimin nga harresa.

Kjo ishte kur ai e prish agjërimin ditën me sende haram. Por kur ai merr prishësin e agjërimit, sapo të perëndojë dielli, ai nuk ka detyrim të kryejë shlyerjen.

4- Prej shkaqeve që e bëjnë detyrim agjërimin kaza dhe shlyerjen për prishjen e agjërimit në Muajin e Ramazanit është edhe masturbimi. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që përkëdhel veten në Muajin e Ramazanit, derisa sekreton spermë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: "Ky person ka të njëjtin detyrim që ka edhe personi që kryen marrëdhënie intime me gruan e tij." Fukahatë janë shprehur se përkëdheljet e qëllimshme provokojnë sekretimin e spermës.

5- Agjëruesi qëndron xhunub deri në mëngjes. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që në Muajin e Ramazanit bëhet xhunub natën, por me qëllim ai e le guslin deri në mëngjes. Çfarë duhet të bëjë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë*

mbi të!) i është përgjigjur: “I jep lirinë një robi, ose agjëron dy muaj rresht, ose ushqen gjashtëdhjetë të varfër.”

6- Kur agjëruesi fle me nijet që të mos bëjë gusël për shkak të xhunubllëkut, deri në mëngjes, ose ai fle me nijet që të bëjë gusël, pastaj zgjohet dhe pastaj fle për të tretën herë. Hollësitë në lidhje me këtë çështje janë dhënë në kapitullin “Prishësit e agjërimit”.

7- Gruaja shtatzënë në muajt e fundit të shtatzënisë dhe gruaja me fëmijë në gji, që ka pak qumësht, kanë të drejtë të mos agjërojnë, kur agjërimi dëmton fëmijën e këtyre grave. Shlyerja për këtë rast bëhet duke dhënë një “med”, por mbi këto gra mbetet detyrim agjërimi kaza i ditëve që nuk kanë agjëruar. Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Për gruan shtatzënë në periudhën afër lindjes dhe për gruan që ka fëmijë në gji e që ka pak qumësht, nuk ka ndonjë problem, nëse prishin agjërimin në Muajin e Ramazanit, për shkak se nuk e përballojnë dot. Mbi to mbetet detyrim të japin sadaka një “med” për çdo ditë që kanë prishur agjërimin, gjithashtu, mbi to mbetet detyrim të agjërojnë kaza për çdo ditë të humbur gjatë Muajit Ramazan.”

8- Arritja e pluhurit të trashë në fyt. Autori i librit “Esh Sheràiu uel Xheuàhiru” ka thënë: “Bën detyrim agjërimin kaza dhe shlyerjen.” Të tjerë kanë thënë: “Bën detyrim vetëm agjërimin kaza dhe jo shlyerjen.”

Autori i librit “Esh Sheràiu uel Medàrik” ka thënë: “Rrena për Allahun e për të Dërguarin e Allahut, si dhe zhytja e gjithë trupit në ujë, nuk bëjnë detyrim as agjërimin kaza e as shlyerjen.” Autori i librit “Esh Sheràiu” ka thënë: “Marrja e gjakut të lëngshëm bën detyrim vetëm agjërimin kaza.”

Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Nuk bën detyrim as agjërimin kaza e as shlyerjen.”

Në lidhje me të vjellat me qëllim, autori i librit “El Xheuàhir”, ka thënë: “Fukahatë më në zë janë shprehur se vjellja bën detyrim vetëm agjërimin kaza.”

Shlyerja për kryerjen kaza të Ramazanit

Kur agjëruesi që kryen kaza Muajin e Ramazanit, e prish agjërimin, ai shikon: Në qoftë se e ka prishur para se dielli të kapërcejë zenitin, mbi të nuk rëndon asnjë detyrim, sepse prishja e agjërimin në këtë gjendje, në origjinë, nuk është haram, përveçse kur koha është e ngushtë. Por, në qoftë se e ka prishur agjërimin, pasi dielli kishte kapërcyer zenitin, ai ka detyrim të bëjë shlyerjen, duke ushqyer dhjetë të varfër. Nëse nuk ka mundësi të japë ushqim për dhjetë vetë, atëherë ka detyrim të agjërojë tri ditë. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që kryen marrëdhënie intime me gruan tij, ditën, kur është duke agjëruar kaza Muajin e Ramazanit. A është i vlefshëm agjërimi i tij? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “Në qoftë se ai ka shkuar te gruaja e tij, para se dielli të kapërcejë zenitin, mbi të nuk rëndon asnjë detyrim, përveç ditës më shumë që do të agjërojë në vend të ditës, kur e prishi. Por në qoftë se ai ka shkuar te gruaja e tij, pasi dielli kishte kapërcyer zenitin, ai ka detyrim të japë sadaka për dhjetë të varfër. Në rast se nuk ka mundësi të japë sadaka, atëherë ka detyrim të agjërojë një ditë, në vend të ditës që humbi. Gjithashtu, ka detyrim të bëjë edhe shlyerjen, duke agjëruar tri ditë. Kjo lloj shlyerje quhet “shlyerja e vogël”.

Shlyerja për agjërimin e taksur (nedhr)

Kur personi bën nijet të agjërojë në një ditë të caktuar, jo ditë në përgjithësi, por ai e prish agjërimin e asaj dite, domethënë nuk e mbajti besën për taksjen që kishte bërë, ky person ka detyrim të kryejë shlyerjen e madhe, që është: ose agjërim dy muaj rresht, ose lirim të një robi, ose ushqimin e gjashtëdhjetë të varfërve. Autori i librit “El Xheuàhir ka thënë: “Ky është gjykimi më i përmendur.”

Në librin “El Intisàr” transmetohet se ky gjykim ka edhe fjalën e përbashkët të fukahave, bazuar në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me një burrë që ishte betuar për Allahun, që të mos hipte mbi kafshë, duke qenë me ihram, madje ai kishte përcaktuar me emër llojin e kafshës mbi të cilën nuk do të hipte. Por ai i hipi asaj kafshe. Ky person ka detyrimin të bëjë shlyerjen: ose lirinë një robi, ose agjëron dy muaj rresht, ose ushqen gjashtëdhjetë të varfër.

Shlyerja për agjërimin e i'tikàfit

Fukahatë kanë thënë: “Kush hyn në i'tikàf, me nijetin për të bërë adhurim për Allahun e Gjithëpushtetshëm dhe agjëron ngaqë ka hyrë në i'tikàf, por gjatë ditës të agjërimin ai kryen marrëdhënie intime me gruan e vet, ky person ka detyrim të kryejë shlyerjen e madhe. Por në qoftë se kryerja e marrëdhënies intime ka ndodhur natën dhe jo ditën, atëherë shlyerja që ai do të kryejë, është vetëm për shkak të i'tikàfit dhe jo për shkak të agjërimin. Në mënyrë absolute, shlyerja nuk është detyrim, kur prishja e agjërimin nuk ka ndodhur për shkak të marrëdhënies intime.

Dispozitën për këtë çështje fukahatë e kanë nxjerrë nga fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili, kur është pyetur për një burrë që ishte në i'tikaf dhe kryen marrëdhënie intime gruan e vet, është përgjigjur: “Ai është në pozitën e atij që prish një ditë agjërimit në Muajin e Ramazanit.”

Më poshtë do të flitet për i'tikàfin.

Fukahatë ndajnë një fjalë të vetme se shlyerja, përveç katër rasteve të mësipërme, nuk është detyrim për prishjen e agjërimit të taksur, pa e përcaktuar ditën, domethënë agjëron në një ditë prej ditëve, si dhe për prishjen e agjërimit për shlyerje dhe agjërimit mustehab. Autori i librit “El Xhevàhir” ka thënë: “Nuk përjashtohet lejimi i prishjes së agjërimit në llojet e agjërimit që u thanë.”, patjetër përveç katër rasteve të mësipërme, sepse nuk ka ndonjë argument që të tregojë prishjen e punës në përgjithësi.

Disa shlyerje

Kur personi merr njërin prej prishësve të agjërimit që e bën detyrim shlyerjen më shumë se një herë, si për shembull: ha, pi dhe kryen marrëdhënie intime me gruan e tij, ose ha disa herë, ose pi dhe kryen marrëdhënie intime, ky person do të kryejë shlyerje për çdo prishës agjërimit, apo do të mjaftonte një shlyerje e vetme?

Përgjigje:

Me fjalën e përbashkët të fukahave, kur ai e merr prishësin e agjërimit për më shumë se një ditë, numri i shlyerjeve shtohet

sipas shtimit të numrit të ditëve, ku ai e ka prishur agjërimin. Por fukahatë kanë pasur mendime të ndryshme, kur kjo është përsëritur prej tij brenda një ditë të vetme. Një grup fukahash ka thënë, ndër të cilët autori i librit “Esh Sheràiu”, autori i librit “El Medàrik” dhe autori i librit “El Mustemsek”: “Ai ka detyrim të kryejë një shlyerje të vetme, pa bërë dallim, nëse prishësi i agjërit disa herë ishte prej të njëjtit lloj.”, si për shembull ka ngrënë disa herë, ose ka pirë disa herë. Gjithashtu, nuk ka dallim, nëse prishësi i agjërit që ai ka marrë ishte disa llojesh, si për shembull, ai ka ngrënë, pastaj ka kryer marrëdhënie intime me gruan dhe nuk bën dallim mes realizimit apo mos realizimit faktik të marrëdhënieve intime.

Kjo është e vërteta, sepse Ligjvënësi e ka lidhur detyrimin për shlyerjen me marrjen e prishësit të agjërit. S’ka dyshim që kjo marrje e prishësit të agjërit, në këndvështrimin e zakonshëm për ngrënie e për pirje, është e besueshme për herë të parë, por nuk mund të jetë e besueshme, në qoftë se e bën për herë të dytë, sepse nuk ka kuptim të thuhet që prishi agjërimin ai që e ka prishur.

Për sa i përket thënies se ngrënia prej tij për herë të dytë është haram, kjo është kështu: Ndalimi nga marrja e ushqimit gjatë agjërit, në vetvete, është detyrim, por jo mjet. Me fjalë të tjera, ngrënia që bën detyrim shlyerjen, është ngrënia që prish agjërimin dhe jo ngrënia haram në përgjithësi, pasi ngrënia e dytë, edhe pse është haram, nuk është prishëse e agjërit. Pra, kemi të kundërtën e rastit të parë, kur ngrënia, në të njëjtën kohë, ishte haram dhe prishëse e agjërit, duke e shtuar këtë mbi origjinën e mospërgjegjësisë prej detyrit për ato që shtohen mbi një shlyerje të vetme.

Ai e prish agjërimin, pastaj agjërimi nuk është më detyrim për të

Kur ai e prish me qëllim agjërimin në Muajin e Ramazanit dhe pastaj udhëton, ose për të bëhet e qartë se agjërimi i tij nuk ishte agjërim farz, për shkak të ndonjë sëmundjeje që i erdhi, ose për shkak të çmendurisë, ose për shkak të humbjes së vetëdijes, ose gruas i erdhën menstruacionet në fundin e ditës, në këtë gjendje, personi a e ka apo jo detyrim shlyerjen?

Përgjigje:

Shumica e fukahave janë shprehur se mbi këtë person mbetet detyrim shlyerja dhe detyrimi për shlyerjen nuk hiqet prej tij. Argumentin për këtë shprehje ata e kanë nxjerrë nga fakti se ai ka prishur agjërimin farz në Muajin e Ramazanit, prandaj kanë vendosur që ai ka detyrim shlyerjen, sikur në themel mbi të nuk do të kalonte asnjë justifikues e ndalim.

Në të vërtetë, duhet të sqarohet, të bëhet e qartë dhe të zbulohet prania e penguesit dhe e justifikuesit real e të vërtetë, për shembull, agjëruesi sëmuret, çmendet, ose humb vetëdijen, ose gruas i vijnë menstruacionet. Gjithashtu, duhet të sqarojmë e të zbulojmë edhe shkakun justifikues për prishjen e agjërimin, që ai stis nga vetja e tij, si për shembull, udhëtimi. Për supozimin e parë mbi këtë person nuk mbetet detyrim as të agjërojë kaza e as të kryejë shlyerjen, sepse në bazë, ai nuk është i obliguar të agjërojë, kurse për supozimin e dytë, ai ka detyrim të agjërojë kaza, për shkak të prishjes me paramendim të agjërimin.

Shlyerje dhe rrahje

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që kryen marrëdhënie intime me gruan e tij, kur ai dhe ajo janë agjërueshëm. Ai tha: “Në qoftë se gruaja ka kundërshtuar, mbi të rëndojnë dy shlyerje dhe, në qoftë se ajo e ka miratuar qëllimin e tij, atëherë mbi të dy mbetet detyrim nga një shlyerje e vetme. Në qoftë se ai e ka detyruar atë, atëherë ai dënohet me njëzet goditje me kamxhik, pra, dënohet me gjysmën e dënimit që parashikon ligji i fesë. Në qoftë se ajo e ka pranuar veprimin e tij, që të dy rrihen me nga njëzet e pesë kamxhikë.”

Në të dy rastet, përveç rrahjes, patjetër duhet të shtohet edhe qortimi. Në qoftë se gruaja i imponohet burrit të vet, sipas teksteve, mbi të nuk mbetet asnjë përgjegjësi.

Ekzekutimi i agjërimitprishësit kundërshtar dhe neglizhues

Ai që e mohon se agjërimi është detyrim, në origjinë, është renegat, ka mohuar Allahun dhe të Dërguarin të Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Prandaj, me fjalën e përbashkët të fukahave, ekzekutimi i këtij njeriu bëhet detyrim. Kurse ai që beson se agjërimi është detyrim, por e le agjërimit nga shkujdesja, ose e merr si gjë pa rëndësi, ai ndëshkohet ashtu siç e sheh të arsyeshme sundimtari. Thuhet se ai ndëshkohet me rrahje, me njëzet e pesë kamxhikë dhe, në rast përsëritje, ndëshkohet për herë të dytë. Nëse ai e përsërit edhe pas kësaj here, atëherë ai ekzekutohet. Kjo vërtetohet prej transmetimeve të ardhura prej Ehli Bejtit: Të gjithë ata që kryejnë mëkate të mëdha, mbi ta zbatohet ndëshkimi fizik, sipas ligjit të fesë dhe në rast përsëritjeje,

ndëshkimi përsëritet për herë të dytë. Pastaj në rast përsëritjeje për herë të tretë, ai ekzekutohet. Është thënë se ekzekutimi bëhet në herën e katër të përsëritjes.

Pamundësia për të kryer shlyerjen

Kur agjëruesi bën njërin prej veprimeve që bëjnë detyrim shlyerjen dhe nuk ka mundësi të kryejë shlyerjen, nuk ka mundësi as të agjërojë dy muaj rresht, as të lirojë një rob e as të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Si duhet të veprojë?

Përgjigje:

Në qoftë se ai nuk ka mundësi të kryejë asnjërin prej shlyerjeve, atëherë është e mjaftueshme që ai të agjërojë tetëmbëdhjetë ditë rresht. Në qoftë se nuk e përballon dot as këtë agjërim, le të japë sadaka me aq sa ka mundësi. Në qoftë se nuk ka mundësi të japë as sadaka, atëherë le t'i kërkojë Allahut faljen e mëkatit. Në lidhje me këtë çështje ka transmetime të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*), me të cilat kanë punuar fukahatë. Ndër to është edhe fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kushdo që është i pamundur të kryejë shlyerjen që ai ka detyrim: agjërim, ose lirimin e një robi, ose dhënien sadaka, ose kur shlyerjen e bën për shkelje të betimit, ose për mosplotësimin e të taksurës (nedhr), ose për vrasje, ose për veprime të tjera, ka detyrim të kryejë shlyerjen. Kërkimi i faljes së mëkatit prej Allahut, është shlyerje për të, me përjashtim të atij që

betohet dhe i thotë gruas se të kam në vend të nënës (dhihàr), kur me këtë fjalë synon mosafrimin te gruaja e tij.”

Shpenzimi për shlyerjen

Kush dëshiron të kryejë shlyerjen, duke ushqyer gjashtëdhjetë të varfër, ai e fton këtë numër të varfërish në shtëpinë e tij njëherësh, ose me grupe të njëpasnjëshme dhe i ushqen ata derisa të ngopen. Gjithashtu, ai ka të drejtë të japë për çdo person një “med” grurë, ose ushqime të ngjashme, me kusht që asnjërit të mos i japë më shumë se një “med”. Por nëse i jep, atëherë do të llogarisë t’i japë aq sa mjafton për ushqimin e një të varfëri. Patjetër, ai që ka mundësi, le të japë edhe më shumë. Masa një “med”, në ligjin e fesë, është më pak se 800 gram.

* * *

AGJËRIMI DHE AGJËRIMI KAZA

Ai që ndjek transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit dhe fjalët e fukahave, në lidhje me agjërimin e me çështjet që e pasojnë agjërimin, për marrjen e prishësit të agjërimin, do të gjejë disa gjendje. Disa nga këto gjendje nuk e bëjnë detyrim as agjërimin kaza e as shlyerjen, si për shembull, kur agjëruesi ha dhe harron që është agjërueshëm. Gjendje të tjera bëjnë detyrim agjërimin kaza dhe shlyerjen, si për shembull, kur agjëruesi ha me qëllim, megjithëse e di që është agjërueshëm. Për këtë rast, në kapitullin “Shlyerja”, është folur me hollësi. Të tjera gjendje bëjnë detyrim shlyerjen, por jo agjërimin kaza, kurse të tjera gjendje bëjnë detyrim agjërimin kaza, por jo shlyerjen. Në këtë kapitull do të trajtohen pikërisht dy gjendjet e fundit dhe gjithçka që lidhet e ka të bëjë me këto dy gjendje.

Shlyerja, pa agjërim kaza

Është detyrim shlyerja, pa agjërimin kaza, për kategoritë e mëposhtme:

1- Plaku e plaka, shumë të moshuar, kur nga agjërimi kanë vështirësi të mëdha, saqë i shkatërron fizikisht. Pavarësisht nga kjo gjendje, mbi ata të dy mbetet detyrimi të agjërojnë dhe patjetër që kanë edhe dyfishin e shpërblimit. Megjithëkëtë ata kanë të drejtë të mos agjërojnë, por kanë detyrimin të bëjnë shlyerjen, duke i dhënë ushqim një të varfëri për çdo ditë. Pas kësaj shlyerje, ata nuk kanë detyrim të agjërojnë kaza. Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Plaku e plaka e moshuar, që i mundon etja, nuk ka ndonjë problem, kur hanë e pinë gjatë Muajit të Ramazanit, por secili prej tyre jep sadaka ushqim për çdo ditë. Gjithashtu, ata të dy nuk kanë detyrim të kryejnë agjërim kaza.”

Thuhet se ajeti 184 i sures “El Bekare” ka zbritur për këtë çështje. Ja dhe fjala e lartë e Allahut të Gjithëpushtetshëm:

“وَعَلَى الَّذِينَ يُطِيقُونَهُ فِدْيَةٌ طَعَامُ مِسْكِينٍ ۖ فَمَنْ تَطَوَّعَ خَيْرًا فَهُوَ خَيْرٌ لَهُ ۖ وَأَنْ تَصُومُوا خَيْرٌ لَّكُمْ ۖ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ”

“...dhe atyre që i rëndon agjërimi, janë të detyruar të bëjnë shlyerjen, duke dhënë ushqim (ditor) për një të varfër, por, nëse me vullnet jep më tepër, është akoma më mirë për dhënësin dhe, nëse e dini, agjërimi është shumë më i mirë për ju.”

Fjala e ajetit “jep më tepër” (tetav’vea), do të thotë: i jep të varfrit më shumë ushqim.

2- Ai që vuan nga sëmundja e etjes së madhe (polydispi), sëmundja nga e cila i sëmuri nuk ngopet me ujë, ka të drejtë të mos agjërojë, por ka detyrim të japë për çdo ditë një “med” ushqim. Gjithashtu, ai nuk kryen as agjërim kaza, pra, është si të

moshuarit e vjetër. Thuhet se kur të shërohet, ai ka detyrim të agjërojë kaza, sepse argumentet që flasin për detyrimin e agjërimin kaza e përfshijnë edhe këtë kategori të sëmuresh.

Ne i përgjigjemi: Kur argumentet, sipas dukjes së jashtme, e përfshijnë edhe këtë kategori të sëmuresh, gjithsesi janë të kushtëzuara prej fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nuk ka agjërim kaza për plakun e për plakën e moshuar, si dhe për atë që vuan nga sëmundja e etjes së madhe.”

3- Kur një person sëmuret në Muajin e Ramazanit dhe sëmundja vazhdon deri në fundin e Ramazanit, ai nuk ka detyrim të agjërojë kaza, por ka detyrim të japë sadaka për shlyerje një “med” për çdo ditë.

Është pyetur Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që sëmuret dhe Muaji i Ramazanit e gjen të sëmure e vazhdon të jetë i sëmure, edhe pasi del Muaji i Ramazanit, derisa vjen Ramazani tjetër. Ai iu përgjigj: “Jep sadaka për Ramazanin e parë dhe agjëron të dytin.”

4- Kur një person harron të bëjë gusël për xhunubllëk gjatë gjithë ditëve të Muajit të Ramazanit, ose gjatë disa ditëve prej këtij muaji, por pastaj kujtohet, kërkesa bazë për këtë person është që ai ka detyrim të falë kaza namazet, por jo të agjërojë kaza, sepse pastrimi prej papastërtisë së madhe (el hadethul ekber) është kusht real për faljen e namazit, kurse për agjërimin është kusht vetëm kur agjëruesi e mëson gjendjen e xhunubllëkut para zbardhjes së agimit, prandaj ai që fle dhe gdhahet xhunub, agjërimi i tij është i vlefshëm, edhe sikur ta këtë lënë guslin me qëllim gjatë gjithë ditës. Kështu kanë thënë Ibn Idrijsi dhe

Muhak'kiku, në librin "Esh Sheràiu". Pjesa më e madhe e fukahave janë shprehur se ai ka detyrim të falë kaza namazet dhe të agjërojë kaza, megjithëse të gjithë kanë pohuar se më afër me bazat e medh'hebit e me rregullat e tij është detyrimi për faljen kaza të namazit dhe jo agjërimi kaza. Megjithëkëtë mbetet detyrë të dilet prej kësaj baze dhe gjykimi jepet: "Është detyrim të kryhet kaza namazi dhe agjërimi, për shkak se për këtë çështje ka tekst."

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që bëhet xhunub në Muajin e Ramazanit, mirëpo ai harron të bëjë nusël, derisa Ramazani përfundon. Si duhet të veprojë ky burrë? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: "Ai ka detyrim të kryejë kaza namazin dhe agjërimin."

Agjërim kaza, pa shlyerje

Është detyrim agjërimi kaza pa bërë shlyerje në rastet e mëposhtme:

1- Më sipër u tha se ai që bëhet xhunub natën, gjatë Muajit të Ramazanit dhe fle me nijet që të bëjë gusël dhe për këtë i bie ndërmend para agimit, por fle për herë të dytë, më sipër u shpjegua se ai ka detyrim vetëm agjërimin kaza dhe jo shlyerjen.

2- Edhe për atë që harron të bëjë gusël për shkak të xhunubllëkut e trajtuam në pikën e katër të paragrafit të mëparshëm.

3- Për atë që ha e pi natën e agjërimin, pa i kushtuar vëmendje dhe pa parë, nëse ka dalë apo jo agimi, por më pas për të bëhet e qartë se agimi kishte dalë, ndërsa ai hante e pinte, autori

i librit “El Xheuàhir”, ka thënë: “Nuk gjej kundërshtim se ai ka detyrim vetëm agjërimin kaza dhe jo shlyerjen.”

Për këtë tregon qartë edhe transmetimi i përgjigjes së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për një burrë që ha dhe pi në Muajin e Ramazanit, pasi ka zbardhur agimi. Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në qoftë se ai është ngritur të shikojë dhe nuk e ka parë agimin, prandaj ai ha, por pas ngrënies ngrihet të shikojë përsëri dhe atëherë sheh agimin, ai le të plotësojë agjërimin e tij dhe për të nuk është detyrim të agjërojë kaza.”

Në qoftë se ai ngrihet dhe ha e pi, pastaj shikon agimin që ka dalë, ai le të plotësojë agjërimin, por ka detyrim të agjërojë kaza një ditë tjetër (pas Ramazanit), sepse ai filloi ngrënien para se të shikonte, prandaj për të mbetet detyrim agjërimi kaza.

Me këtë transmetim e me transmetime të tjera, vërtetohet detyrimi për agjërimin kaza dhe në origjinë mohohet detyrimi për shlyerje, sidomos kur vihet në konsideratë se marrja e prishësit të agjëritit nuk ishte me qëllim.

Gjithashtu, është detyrim agjërimi kaza dhe jo shlyerja, kur agjëruesi ha e pi natën, i bazuar në fjalën e lajmëruesit se ka akoma natë. Një prej shokëve të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon: “I thashë atij: “Urdhërova shërbyesën të shikonte, nëse është shfaqur apo jo agimi.” Ajo më tha: “Akoma nuk është shfaqur.” Prandaj unë hëngra. Pastaj u ngrita të shikoj vetë dhe pashë se agimi ishte shfaqur. Ai tha: “Plotësoje këtë ditë dhe pastaj agjëro kaza, sepse, nëse do të kishe dalë vetë për të shikuar, nuk do të ishte detyrim të agjërojë kaza.”

Ky transmetim flet hapur e qartë se shkaku për rënien e detyrimit për të agjëruar kaza qëndron në detyrën e njeriut që të studiojë dhe të shikojë vetë dhe nuk ka vlerë që ai të mbështet në fjalën e tjetrit.

Pyetje: Sikur të kemi një argument ligjor, të përbërë prej dëshmisë së dy burrave të drejtë, se ka akoma natë dhe ai ha e pi, i bazuar mbi fjalën e atyre të dyve, a është detyrim që ai të agjërojë kaza, pasi për të të bëhet e qartë e kundërta?

Përgjigje:

Patjetër që ai ka detyrim të agjërojë kaza, sepse argumenti është një rrugë për të njohur realitetin, por është zbuluar e kundërta, ashtu siç është supozimi. Gjithashtu, vënia në konsideratë e argumentit si rrugë që duhet ndjekur, nuk nënkupton rrëzimin e detyrimit për agjërimin kaza, por vetëm justifikon ngrënien e pirjen, pasi baza për të dyja qëndron vetëm në marrjen e prishësit të agjërimin dhe jo në rënien e detyrimit për agjërimin kaza. Kjo çështje është plotësisht e ngjashme me çështjen e rregullit të shoqërimit. Argumenti ligjor e ka bazuar rënien e detyrimit për agjërim kaza, kur vetë agjëruesi del të vërtetojë me shkimin e tij dhe jo me ndërmjetësinë e të tjerëve.

5- Agjëruesi njoftohet prej lajmëruesit për daljen e agimit, megjithatë ai ha e pi, duke kujtuar se lajmëruesi nuk është serioz. Më pas bëhet e qartë se lajmëruesi ishte i vërtetë në njoftimin që dha. Si duhet të veprojë ky njeri? Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, në origjinë, për këtë njeri bie detyrimi për

të kryer shlyerjen. Njëkohësisht vërtetohet detyrimi që ai të agjërojë kaza.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që gjatë muajit të Ramazanit shkon së bashku me miqtë e me shokët e tij në një shtëpi, ku do të hanë edhe syfyryn. Aty ai shikon agimin, ndërkaq i njofton të tjerët. Disa ndaluan ngrënien e pijen, kurse disa të tjerë menduan se ai po tallet, prandaj vazhduan ngrënien. Si duhet të veprohet në këtë rast? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Plotëson agjërimin dhe më pas agjëron kaza.”

6- Prej rasteve, kur agjëruesi kryen agjërim kaza dhe nuk kryen shlyerjen, është edhe kur dikush e njofton agjëruesin se hyri nata dhe ai, bazuar në njoftimin që mori prej atij njoftuesi, fillon të marrë ushqim e të pijë dhe të bëjë të tjera punë dhe vërtetohet që nata ka hyrë. Nuk ka asnjë dallim, nëse njoftuesi është vetëm një apo shumë.

Gjithashtu, nuk ka dallim, nëse argumenti është ligjor, ose i një lloji tjetër. Madje nuk ka dallim as mes rastit kur lejohet imitimi, si për shembull rasti i të verbrit dhe mes faktit kur imitimi nuk lejohet, sepse mes lejimit për prishjen e agjërimin dhe mes vërtetimit për agjërimin kaza, nuk ka kundërshtim. Madje nuk ka dallim as mes vërtetimit për kryerjen e shlyerjes. Këtë rast e pamë më sipër, në lidhje me çështjen e të moshuarit dhe në lidhje me personin, të cilit sëmundja i vazhdon një vit të plotë.

Edhe një pyetje: Kur agjëruesin nuk e lajmëron askush për hyrjen e natës përveç një personi dhe agjëruesi, bazuar mbi këtë dëshmi, çel agjërimin, megjithëse në vetvete agjëruesi ishte i

paqartë për hyrjen e natës. Në këtë gjendje, a ka detyrim ky agjërues të agjërojë kaza apo jo?

Përgjigje:

Në një rast ai agjëron kaza dhe në një rast tjetër ai nuk agjëron kaza. Ja dhe shpjegimi:

Agjëruesi nuk e di se në qiell ka re, ose ndonjë pengesë tjetër, por pastaj shfaqet një re e zezë, e cila e fut agjëruesin në gabim e në dyshim, aq sa ai kujton se me këtë errësirë hyri nata. Por, pasi çel agjërimin, reja largohet dhe del dielli. Kur çështja është kështu, ai ka detyrim vetëm të agjërojë kaza. Këtë e shpjegon transmetimi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për disa njerëz që agjërojnë në Muajin e Ramazanit, por afër përfundimit të diellit ata i rrethon një re e zezë, aq sa kujtojnë se hyri nata. Ata e çelin agjërimin. Më pas reja u largua dhe ata shikojnë diellin. Si duhet të veprojnë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Për atë që ka agjëruar këtë ditë, Allahu i Lartësuar thotë:

”لَمْ أَتُوا الصَّيَّامَ إِلَى اللَّيْلِ”

“...dhe plotësoni agjërimin deri në mbrëmje...” (Sure “El Bekare”, ajeti 187) Prandaj kush ha para se të hyjë nata, ka detyrim të agjërojë kaza, sepse ka ngrënë me qëllim.

Në lidhje me shprehjen “i rrethon një re e zezë, aq sa kujtuan renë për natë”, ka një tekst të veçantë, që flet për të njëjtin qëllim që ne bëme supozimin.

Kur agjëruesi e di se në qiell ka një pengesë resh ose prej faktorësh të tjerë dhe ai kujton se ka hyrë nata, për këtë person nuk është detyrim agjërimi kaza. Këtë e tregon transmetimi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për një agjërues që, duke parë qiellin të nxirë nga retë, kujton se dielli ka perënduar, prandaj ai e çel agjërimin. Por më pas retë u shpërndanë dhe pa se dielli akoma nuk kishte perënduar. A e ka plotësuar ai agjërimin e tij? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai e ka plotësuar agjërimin e tij dhe nuk ka detyrim të agjërojë kaza.”¹

7- Kur agjëruesi shpëlan gojën duke e përplasur ujin në gojë (madmadah), me qëllim që të freskohet, jo kur merr abdes, por uji i kapërcen dhe i futet në fyt, ky person ka detyrim vetëm të agjërojë kaza dhe jo shlyerjen. Këtë e tregon transmetimi i Imam

¹ Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë kundërshtime. Fjalët e tyre janë të shumta, sipas numrit të transmetimeve e të kundërtënieve që kanë vetë transmetimet. Ne kemi përmendur si argument e si sentencë për këtë çështje fjalën e autorit të librit “El Xheuàhir”. Shejkh El Hamedànij, në librin “Misbàhul Fakijh”, e ka pjesëtuar këtë agjërues në disa pjesë: e para, ai e ka çelur agjërimin, pasi ka studiuar gjendjen, ka shikuar mirë kohën dhe ka rritur në diturinë e duhur për të qenë i vendosur në veprimin që kryen. Ky person nuk ka detyrim as të agjërojë kaza e as të kryejë shlyerjen.

E dyta, ai e çel agjërimin thjesht pse pandehu se ka hyrë nata, pa u bazuar në ndonjë veprim të arsyeshëm, prandaj ky njeri, në këndvështrimin e të zakonshmes, quhet person që nuk i bëhet vonë dhe person që nuk interesohet. Pikërisht mbi këtë person është detyrim agjërimi kaza dhe shlyerja.

E treta, kur e çel agjërimin për shkak të ndonjë dukurie atmosferike, e cila ngatërron të gjithë njerëzit për hyrjen e natës. Ky person ka detyrim vetëm të agjërojë kaza dhe jo të kryejë shlyerje, madje nëse ai shikon se në qiell ka pengesë, mbi të nuk mbetet detyrim as agjërimi kaza, edhe kur nuk arrin të ketë dituri të plotë për gjendjen, pasi për të mjafton vetëm mendimi që ai formon për gjendjen reale.

Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për një burrë që shpëlan gojën nga etja, por uji i futet në fyt. Ai ka thënë: “Ai ka detyrim të agjërojë kaza, por s’ka problem, nëse uji i futet në fyt, kur merr abdes.”

8- Agjëruesi që provokon të vjella me qëllim, ka detyrim vetëm agjërimin kaza dhe jo shlyerjen. Në qoftë se vjella ishte e imponuar, mbi të nuk rëndon asnjë detyrim. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur agjëruesi vjell, ka detyrim që për këtë ditë të agjërojë kaza. Por nëse e vjella e tij ishte e imponuar, ai le të plotësojë agjërimin, sepse agjërimi i tij është i vlefshëm dhe mbi të nuk rëndon asnjë detyrim.”

9- Në studimet e mësipërme kemi parë se gruaja me menstruacione (el hàidh) dhe gruaja në periudhën e hemorragjisë së lehonisë (en nufesàë) agjërojnë kaza dhe nuk falin namaz kaza, kurse gruaja me metrarogji (mustehàdah) ka detyrim të agjërojë e të falë namaz në kohën e caktuar dhe, kur ajo nuk arrin t’i kryejë në kohën e caktuar, me fjalën e përbashkët të fukahave, kryerja kaza mbetet detyrim për atë grua.

Sëmundja

Sëmundja që lejon prishjen e agjërit është gjendja kur njeriu, me të vërtetë, është i sëmurë dhe, nëse ai agjëron në këtë gjendje, sëmundja i shtohet e i rëndohet, ose i shtohen dhimbjet, ose sëmundja zgjatet në kohë. Gjithashtu, shkak për të prishur agjërimin është edhe frika që ai ka se agjërimi mund t’i shkaktojë një sëmundje të re, megjithëse është i shëndoshë. Kurse vetëm thjesht pafuqia e dobësia, nuk janë shkaqe që lejojnë të prishet

agjërimi, derisa ato janë vetëm pandehma, në një kohë kur trupi është i shëndetshëm. Në lidhje me këtë çështje tregojnë katër argumente: Libri i Allahut, Suneti, fjala e përbashkët e fukahave dhe logjika. Allahu i Lartësuar urdhëron e thotë:

“فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ عَلَى سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِنْ أَيَّامٍ أُخَرَ”

“...dhe kush prej jush është i sëmurë, ose ai është në udhëtim, le t’i plotësojë (ditët e agjëritimit) në ditë të tjera...” (Sure “El Bekare”, ajeti 184)

Prej Sunetit kemi: “Për çdo sëmundje që e rëndon agjërimi, ka vend që agjërimi të lihet.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur agjëruesi ka frikë nga inflamacioni i syve, ai e prish agjërimin.” Kjo është ana e jashtme e frikës se mund të shafqet sëmundja, ose ajo mund të ripërtërihet.

Mbështetja për njohjen e dëmit është e bazuar në diturinë e njeriut, ose në mendimin e tij logjik, të dalë prej përvojave që ai ka kaluar, ose në fjalën e ndonjë specialisti. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për kufirin e sëmundjes, kur i sëmuri ka detyrë të prishë agjërimin. Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai është i besueshëm për detyrimin dhe i autorizuar për veprimin. Në qoftë se gjen dobësi, atëherë le të prishë agjërimin. Në qoftë se ka fuqi, le të agjërojë, sido që të jetë sëmundja.” Këtu duhet të shtohet se dëmtimi që mendohet, ligjërisht e me logjikë, është detyrë të sprapset.

Sikur mjeku t’i thotë agjëruetit: “Ty të dëmton agjërimi.”, por vetë agjërueti e di që agjërimi nuk e dëmton, ose mjeku i thotë

atij: “Agjërimi nuk të dëmton.”, por vetë i sëmuri e di që agjërimi e dëmton, ai do të bazohet në atë që di vetë dhe nuk do të bazohet në fjalën e mjekut, sepse nuk ka argument që të tregojë se fjala e mjekut është argument që duhet të ndiqet, madje edhe kur dihet se ai mendon gabim. Gjithashtu, i sëmuri i referohet fjalës së mjekut, kur mendja i thotë se duhet të dëgjohet fjala e mjekut në lidhje me dëmin, por jo në mënyrë absolute, sepse këshillimi me mendjen e bën detyrë sprapsjen e dëmit logjikisht e ligjërisht dhe jo fjala e mjekut.

Kur i sëmuri agjëron, duke qenë i bindur se agjërimi nuk e dëmton, por rezulton e kundërta, agjërimi i tij është prishur dhe ai ka detyrim të agjërojë kaza, sipas fjalës së Allahut: “وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَىٰ” “...dhe nëse jeni sëmurë...” (Sure “En Nisa” ajeti 43) dhe sipas fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse ai agjëron, kur është në udhëtim, ose kur është sëmurë, ai ka detyrim të agjërojë kaza.”

Gjykimi për këtë argument dhe për argumente të tjera të ngjashme, është i lidhur me gjendjen reale të sëmundjes dhe jo me mosdijen për sëmundjen. Për sa i përket fjalës që ka thënë Sej’id El Hakijm, në librin “El Mustemsek”, në lidhje me vlefshmërinë e agjërimin në një gjendje të tillë, në të vërtetë, agjërimi është veprim i dashur te Allahu, megjithëkëtë detyrimi për agjërim bie me urdhrin e Tij, sepse në rastin e sëmundjes e të udhëtimit, agjërimi rivalizon me një detyrim akoma më të rëndësishëm, që, në rastin konkret, është urdhri për ruajtjen e vetvetes. Në qoftë se i sëmuri agjëron, nisur nga fakti se agjërimi është veprim i favorizuar, agjërimi i tij është i vlefshëm, kurse, për sa i përket këtij shpjegimi,

duket qartë se është thjesht një teori që plotësohet realisht me një shkak.

Sido që të jetë, kur i sëmuri e prish agjërimin disa ditë në Muajin e Ramazanit dhe ai vazhdon të jetë sëmure deri në Ramazanin e dytë, siç e pamë më sipër, ai ka detyrim që për çdo ditë të bëjë shlyerjen, duke i dhënë ushqim një të varfëri dhe nuk ka detyrim të agjërojë kaza. Në qoftë se ai shërohet prej sëmundjes para fundit të vitit dhe ka mundësi të agjërojë para se të vijë Ramazani tjetër, ai ka detyrim vetëm agjërimin kaza dhe jo shlyerjen.

Udhëtimi

Është mjaft i njohur transmetimi i ardhur prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e prej Ehli Bejtit të tij: “Nuk është prej punëve të mira agjërimi gjatë udhëtimit.” Gjithashtu, është shumë i njohur edhe hadithi: “Kur të falësh namaz të shkurtuar, prish edhe agjërimin.”

Në librat e fik’hut përsëritet shprehja: “Çdo udhëtim e bën detyrim faljen e namazit të shkurtuar. Gjithashtu, udhëtimi bën detyrim edhe prishjen e agjërimin.” Prej këtij rregulli, fukahatë kanë përjashtuar vetëm katër kategori udhëtarësh:

1- Ai që udhëton me qëllim gjuetinë ose tregtinë, ai e fal namazin të plotë dhe agjëron.

2- Ai që del prej shtëpisë së vet për të udhëtuar, pasi dielli ka kapërcyer zenitin, ai do të vazhdojë të agjërojë, por namazin e

fal të shkurtuar, në qoftë se nuk e ka falur atë namaz para se të fillonte udhëtimin.

3- Ai që kthehet në shtëpinë e tij prej udhëtimit, pasi dielli ka kapërcyer zenitin, ai e fal namazin të plotë, në qoftë se nuk e ka falur namazin gjatë udhëtimit të tij, duke ditur se ai e ka prishur agjërimin.

4- Ai që është në xhaminë e Qabes, ose në xhaminë e të Dërguarit, ose në xhaminë e Kufes, ose në vendvizitën Hysenije (Kerbela), në këto katër vende, udhëtari ka të drejtën e përzgjedhjes ndërmjet faljes së namazit të shkurtuar ose të plotë, por ai duhet ta prishë agjërimin. Më sipër është folur për këtë çështje.

Gjithsesi, kushtet e shkurtimit të namazit janë të njëjtat për prishjen e agjërimin në udhëtim, përfshirë nijetin për të përshkuar tetë "ferseh" gjatësi, ose vajtje-ardhje, udhëtimi të jetë i lejuar dhe jo haram, udhëtimi për udhëtarin të mos jetë as punë e as detyrë që ai kryen, të mos banojë dhjetë ditë në një vend dhe të mos bëjë vajtje-ardhje në atë vend gjatë tridhjetë ditëve. Kur udhëtari del prej shtëpisë së tij për udhëtim, para se dielli të kapërcejë zenitin, ai e prish agjërimin dhe, kur ai del për udhëtim, pasi dielli e ka kapërcyer zenitin, ai do të vazhdojë të jetë agjërueshëm. Gjithashtu, nëse ai kthehet nga udhëtimi në shtëpinë e vet, para se dielli të kalojë zenitin dhe nuk ka marrë asgjë nga prishësit e agjërimin, ai ka detyrë të agjërojë dhe, nëse ai ka marrë prej prishësve të agjërimin, ai nuk agjëron, por do të agjërojë kaza. Në këtë gjendje është mustehab që ai të mos hajë e të mos pijë përpara njerëzve.

Autori i librit “Esh Sheràiu” dhe i librit “El Uervetul Uthkà” ka thënë: “Kur udhëtari e prish agjërimin para se të arrijë kufirin e lejimit, ai ka detyrim të agjërojë kaza dhe të kryejë edhe shlyerjen.”

Pastaj autori thotë: “Kur kjo plotësohet, në të vërtetë, plotësohet me të drejtën e atij që e di ndalimin.”, sepse ai ka prishur agjërimin farz në Muajin e Ramazanit, kurse për atë që nuk di, nuk ka asnjë detyrim, sepse ai që nuk di, është plotësisht si personi që merr diçka prej prishësve të agjërimin, pa e ditur se është detyrim të ndalohet prej atyre sendeve.

Në kapitullin “Prishja e agjërimin dhe detyrimi për shlyerjen”, në paragrafin “Paditura”, këtë çështje e kemi trajtuar duke sjellë edhe argumentet, prandaj mund të referohesh në kapitullin në fjalë.

Sej’jid El Hakijm ka cituar transmetimin shumë të dëgjuar, madje ky transmetim mund të ketë edhe fjalën e përbashkët të fukahave, se njeriu ka të drejtën e përzgjedhjes në Muajin e Ramazanit, edhe sikur udhëtimi të jetë me qëllim për të shpëtuar prej agjërimin. Është pyetur Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), babai i Imam Xhaferit (*Paqja qoftë mbi të!*), për agjëruesin banor vendas, të cilit i propozohet të udhëtojë në Muajin e Ramazanit, megjithëse kanë kaluar disa ditë prej muajit të Ramazanit. Si duhet të veprojë ky njeri? Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nuk ka problem, që ai të udhëtojë e të prishë agjërimin.”

Agjërimi kaza për të vdekurin prej më të afërmit të tij

Kur për një njeri mbetet detyrim agjërimi kaza i Ramazanit, ose agjërimë të tjera dhe ka kaluar mjaft kohë gjatë së cilës ai kishte mundësi të kryente detyrimin kaza, por ai nga shkujdesja e la pas dore detyrimin, derisa vdiq, atëherë më i afërmi i të vdekurit kryen kaza detyrimin që nuk kishte kryer i vdekuri dhe, është e barabartë, qoftë kur i vdekuri i kishte humbur ato ditë agjërimi për shkak të sëmundjes, ose për shkak të udhëtimit, ose për ndonjë shkak tjetër. Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Këtë çështje unë e gjej pa asnjë kundërshtim.” Është cituar prej Ibn Ebu Ukajlit, kur është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që vdes dhe mbi të rëndon detyrimi për të falur namaz, ose për të agjëruar kaza. Kush do ta kryejë këtë detyrim? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Detyrimin për këtë të vdekur e kryen kaza njeriu më i afërm që e trashëgon të vdekurin.” Pyetësi tha: “Nëse njeriu më i afërm që e trashëgon të vdekurin, është grua, a duhet ta kryejë ajo?” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Jo, vetëm burrat.”

Më sipër kemi thënë se qëllimi me fjalën “njeriu më i afërm”, është njeriu që e trashëgon të vdekurin. Çështjet që kanë lidhje me këtë dispozitë, ne i kemi trajtuar në kapitullin “Namazi”, në nëntitullin “Falja e namazit kaza”, paragrafi “Djali më i madh kryen detyrimin kaza për dy prindërit e vet”.

Nëse dëshiron, mund të referohesh në këtë kapitull.

* * *

VËRTETIMI I DALJES SË HËNËS SË RE

Dalja e hënës së Ramazanit dhe e muajve të tjerë vërtetohet me rrugët e mëposhtme:

Shikimi me sy

1- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur të shohësh hënën e re, agjëro dhe, kur ta shohësh atë, përsëri prishe agjërimin.” Hadithi: “Agjëroni me shikimin dhe prisheni me shikimin.”, lakohet në të gjitha gjuhët.

Fukahatë janë bashkuar në një fjalë të vetme se ai që shikon hënën e re të Ramazanit, ka detyrim të agjërojë, qoftë edhe kur të gjithë njerëzit nuk agjërojnë atë ditë. Nëse ai nuk agjëron, ka detyrim agjërimin kaza dhe shlyerjen. Gjithashtu, kur vetëm ai e shikon hënën e re të muajit Shev’vâl, ai e ka haram të agjërojë, qoftë edhe kur të gjithë njerëzit agjërojnë, sepse, nëse ai agjëron, ka bërë një punë haram, me përjashtim të rastit kur ai nuk ha e

nuk pi pa nijet për agjërime, por vetëm me nijet që të jetë bashkë me të tjerët, ose edhe për shkaqe të tjera të kësaj natyre.

Lajmi i përhapur (esh shijàu)

2- Kuptimi i fjalës “shijàu” nuk është njoftimi me të cilin vërtetohet hyrja e hënës së re që të agjërojë një grup, ose që të agjërojnë banorët e një rajoni, ose të një vendi, bazuar mbi një gjykim intuitiv që njofton, se nesër është Ramazan, ose prisheni agjërimin sipas këtij gjykimi, se nesër është muaji Sheuàl. Jo, në asnjë mënyrë nuk duhet të priset agjërimi, sepse kjo është prishje e agjërit me mendje, me pandehmë dhe jo me dituri, pasi kuptimi i fjalës “shijàu” është kur dalja e hënës vërtetohet me shikim nga të gjithë dhe jo nga një njeri ose nga disa njerëz të veçuar, domethënë hënën e re duhet ta shikojnë një numër sa më i madh njerëzish, në atë mënyrë që, sipas zakonisht, të ndalohej çdo mundësi për gënjeshtëri dhe me qëllim që njerëzit të qetësohen shpirtërisht, kur mbështeten mbi këtë njoftim.

Gjithashtu, për shkak të këtij njoftimi, nuk është kusht besueshmëria e as drejtësia e individëve që japin njoftimin.

Bazuar mbi këtë kuptim, domethënë njoftimin për daljen e hesës së re me shikim dhe jo sipas mendimit e as sipas njoftimit për prishjen e agjërit ose për agjërim, është edhe fjala e Imam Sadikut (*Paqja goftë mbi të!*): “Çelja e agjërit është dita kur agjërimin e çelin njerëzit, kurban është dita kur njerëzit bëjnë kurban dhe agjërimi është dita kur njerëzit agjërojnë.”

Është detyrë që këtë transmetim ta mbartim në kuptimet që përmbajnë thëniet e ardhura prej Ehli Bejtit për shikimin e hënës së re në përgjithësi, ose mbi lejimin ligjor. Konkretisht çështja qëndron sipas kësaj skeme: Sikur të shikosh dikë që pret kurban për fenë e të cilit ti je i sigurt, gjithashtu je i sigurt edhe në diturinë e tij e në kujdesin e tij të madh për t'u ruajtur prej mëkateve. Pra, është plotësisht sikur ti shikon një Imam të panjohur për ty, por që pas tij falin namaz një numër shumë i madh njerëzish, ndër të cilët ti njeh dikë, në të cilin ke besim. Prandaj edhe ti ujdise pas këtij Imami, sepse pe atë person që ishte lidhur pas këtij Imami dhe, sepse pas tij ishin lidhur një numër i madh njerëzish.

Plotësimi i numrit

3- Prej rrugëve për vërtetimin e daljes së hënës së re është edhe plotësimi i numrit të çdo muaji hënor, çka vërteton ditën e parë të atij muaji, i cili patjetër do të përfundojë, pasi të kalojnë tridhjetë ditë. Pastaj hyn muaji pasardhës, sepse muaji nuk është më shumë se tridhjetë ditë dhe nuk mund të jetë më pak se njëzet e nëntë ditë. Kur vërtetohet fillimi i muajit Shaban, patjetër dita e tridhjetë e një është ditë Ramazani. Kur ne dimë ditën e parë të Ramazanit, dita e tridhjetë e një e Muajit të Ramazanit, është dita e parë e muajit Shev'vâl.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në qoftë se qielli është i mbuluar me re, ju numëroni tridhjetë net dhe pastaj prisheni agjërimin.” Gjithashtu, ai ka thënë: “Kur muaji fshihet, ju plotësoni muajin Shaban tridhjetë ditë dhe agjëroni ditën e tridhjetë e një.”

Argumenti ligjor

4- Hyrja e hënës së re vërtetohet me dëshminë e dy burrave të drejtë, pasi nuk ka argument për pranimin e dëshmisë prej vetëm një burri, as për pranimin e dëshmisë prej grave të veçuara prej burrave, ose jo të ndara prej burrave, edhe pse numri i grave mund të jetë shumë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Agjëro me shikimin e hënës së re dhe çele agjërimit me hyrjen e hënës së re. Në qoftë se për këtë dëshmojnë dy burra prej të cilëve ti je i kënaqur që ata e kanë parë hënën e re, menjëherë fillo agjërimitin.”

Gjithashtu, ai ka thënë: “Mos prano dëshminë e grave për shikimin e hënës, por prano vetëm dëshminë e dy burrave të drejtë.” Transmetimet e tjera, që janë në kontradiktë me transmetimin e mësipërm, janë transmetime të deformuara dhe të lëna.

Ai që ka besim në drejtësinë e dy dëshmitarëve, ka detyrë të veprojë sipas fjalës së atyre të dyve dhe atij nuk i lejohet të kundërshtojë dëshminë e tyre, madje edhe atëherë kur dëshminë e tyre të dyve e refuzon sundimtari.

Vendimi i gjykatësit ligjor

5- Kur gjykatësi ligjor (i fesë) vendos se dita e nesërme është ditë e Muajit të Ramazanit, ose është dita e muajit Sheuàl, me fjalën e përbashkët të fukahave, për atë që e di se gjykatësi, në vendimin e tij, është bazuar në argumente mbi të cilët ligjërisht

nuk lejohet të merren për bazë, ai e ka haram të veprojë sipas vendimit të këtij gjykatësi.

Gjithashtu, me fjalën e përbashkët të fukahave, ai që e di se gjykatësi, në vendimin e tij është bazuar mbi argumente mbi të cilat ligjërisht lejohet mbështetja mbi to, ai e ka për detyrë të veprojë sipas vendimit të këtij gjykatësi ligjor, sepse ai vepron për pozitën e diturisë dhe jo për vendimin e gjykatësit. Por, kur ai nuk e di as gabimin e as drejtësinë e vendimit të gjykatësit, a lejohet apo nuk lejohet veprimi sipas vendimit të këtij gjykatësi?

Përgjigje:

Autori i librit “El Hadàik” ka thënë: “Prej fjalëve të fukahave del qartë se është detyrim për të punuar me vendimin e gjykatësit ligjor, kur kjo vërtetohet te ai dhe ai gjykon me këtë vendim. Pastaj ai citon prej një dijetari të virtytshëm, emrin e të cilit ai nuk e ka përmendur, që thotë se gjykatësi ligjor, në të vërtetë, i referohet çështjeve legale, ndarjes së konflikteve dhe dhënies së sentencave (fetvave) në lidhje me dispozitat e ligjit të fesë, kurse vendimi i tij për subjekte të jashtme, qoftë ky subjekt edhe grabitje e rrëmbim, ose ka hyrë apo jo koha për kryerjen e adhurimit, si dhe të tjera çështje të ngjashme, nuk ka asnjë argument që të tregojë se është detyrë ndjekja e tij dhe të punohet sipas fjalëve të tij.”

Më pas, autori i librit “El Hadàik” ka thënë: “Te unë çështja është objekt pezullimi dhe komplikacioni, për shkak të mungesës së një argumenti të qartë, që të tregojë se është detyrim veprimi sipas vendimit të gjykatësit në të gjitha çështjet.”

Ne besojmë se vetëm Imami i pastër prej gabimeve është detyrë të ndiqet në të gjitha fjalët e punët e tij dhe është e barabartë, qoftë kur ato janë prej tezave objekt studimi, ose të tjera çështje, kurse përfaqësuesi, ose i ngarkuari, nuk është detyrë të ndiqet në fjalët e në punët e tij. Padyshim që i ngarkuari me detyrë nuk mund të jetë përfaqësues i Imamit, gjithashtu edhe i autorizuari nuk është origjinali. Veç kësaj, nuk është domosdoshmëri që i ngarkuari me detyrë të jetë përfaqësues për një gjë të veçantë dhe për të gjitha gjërat. Ne gjithashtu besojmë se ai që pretendon se hulumtuesi i besueshëm ka të njëjtat të drejta që ka edhe Imami i pastër nga gabimet, ose ai është njëri prej të dyve dhe s'ka të tretë përveç atyre të dyve, ky pretendues është prej atyre që nuk orientohen dhe është njeri i shkujdesur, ose është person që e tërheq zjarrin për një rast të volitshëm, pasi pretendon për veten e tij atë me çka Allahu ka veçuar më të pastrin e të pastërve, Profetin (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) dhe Ehli Bejtin e tij.

I lutem Allahut të më ruajë prej këtij pretendimi dhe prej këtij pretenduesi.

Fjalët e astronomëve

6- Kur ne e kalojmë hadithin që gëzon konsensusin e të gjithë myslimanëve: "Agjëroni me shikimin dhe çeleni agjërimin me shikimin.", gjithashtu kur ne e kalojmë konsensusin e mbarë myslimanëve se i përcaktuari në këtë hadith është Muaji i Ramazanit, i cili ndryshon nga muaji para tij dhe nga muaji pas tij, domethënë ndryshon nga muaji Shaban dhe nga muaji Sheuâl, me

pakësim ose me plotësim nga 28 në 30 ditë, kur ne i kalojmë këto dy parime mbi të gjithë myslimanët e ndryshëm të të gjitha grupeve, pavarësisht nga dallimet mes tyre, për të pranuar fjalën e atij që pretendon se ka parë hënën e re dhe, kur të gjitha thëniet e këtyre pretenduesve do t'i bashkojmë në një fjalë të vetme, rezultati përfundimtar, i detyrueshëm, do të qe agjërimi prej një shtrese dhe mosagjërimi prej një shtrese tjetër, ose agjëruesi mund të jetë prej një grupi dhe ai që s'ka agjëruar mund të jetë prej një grupi tjetër, ose të dy mund të jenë prej të njëjtit grup, sipas ndjekjes ose mosndjekjes së të besueshmit. Kështu ka ndodhur në vitin 1964, kur një pjesë e banorëve të Nexhefi Eshrefit e çelën agjërimin për shkak se imituan autoritetet që kishin caktuar ditën e Xhuma, kurse pjesa tjetër e banorëve të Nexhefi Eshrefit e çelën agjërimin ditën e shtunë, ashtu siç e kishin caktuar autoritetet. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në vitin 1939, kur në Egjipt, Kurban Bajrami u festua ditën e hënë, kurse në Saudi u festua ditën e martë, kurse në Bombej u festua ditën e mërkurë, megjithëse banorët e këtyre vendeve ishin prej Ehli Sunetit. Nga këto fakte del qartë se çështja nuk ka të bëjë me kundërshtimin ndërmjet grupeve e medh'hebeve, por rezulton të jetë çështje që ka lidhje me besimin ose mosbesimin në personin që pretendon se ka parë daljen e hënës së re.

Pakujdesia ndaj kësaj të vërtete është mjaft e përhapur, prandaj në gjuhët e shumë myslimanëve lakohet pyetja: Përse myslimanët nuk e mënjanojnë këtë anarki, këtë kontradiktë, e cila, duke mos qenë kontradiktë ndërmjet grupeve, mund të mënjanohet fare lehtë nëpërmjet referimit të shkenca, të fjala e astronomëve, të cilët e dinë se kur del hëna e re? Gjithashtu, është mjaft e përhapur edhe përgjigja për këtë pyetje ndërmjet shehëve,

ose ndërmjet disave prej tyre, se ligji i fesë na urdhëron të fillojmë agjërimin dhe ta çelim agjërimin, kur të shikojmë daljen e hënës së re, duke ditur se njerëzit, me fjalën “shikim”, kanë kuptuar dhe kuptojnë, përfshirë edhe njerëzit e kohës së zbritjes së mesazhit, shikimin vizual dhe jo shikimin shkencor, çka shtron si kërkesë që ne nuk interesohemi për mënyrë tjetër konstatimi përveç shikimit vizual, sido që është e do të jetë mënyra tjetër.

Mendoj se kjo pyetje nuk është e orientuar prej bazës, gjithashtu, edhe përgjigja e ndërtuar mbi këtë pyetje, përsëri nuk është e orientuar prej bazës, sepse e ndërtuara mbi një diçka të dekompozuar, patjetër që është e dekompozuar si sendi mbi të cilin ajo është ndërtuar.

Tani për ty shpjegimi:

Të gjithë myslimanët kanë rënë në një mendim të përbashkët se është detyrim që dispozitat e fesë së Allahut të Lartësuar të zbatohen, gjithashtu, është detyrim nënshtrimi e bindja ndaj dispozitave të fesë së Allahut nëpërmjet rrugës së diturisë, prandaj nuk lejohet vërtetimi me supozim. Por ne nuk kemi gjetur rrugë që të vërtetojmë daljen e hënës së re me anë të diturisë, në një kohë, kur dimë se edhe supozimi nuk vërteton ndonjë gjë. Atëherë na mbetet të mbështetemi në supozimin e marrë në konsideratë dhe për të cilin kemi edhe tekstin e ligjit të fesë, me cilësinë e supozimit të arritur prej argumentit dhe prej fakteve të tjera. Ne gjejmë strehim te ky supozim, sepse, në mënyrë absolute, s’ka rrugë për te dituria, prandaj ndjekja e argumentit mbetet specifik, krahas mundësisë së vërtetimit me anë të rrugëve të tjera.

Kur të arrihet dituria prej fjalëve të astronomëve, për këdo që mëson për vërtetësinë e fjalës së tyre, ka detyrë të punojë sipas fjalëve të astronomëve dhe, në mënyrë absolute, nuk lejohet të

veprojë sipas dëshmisë së dy dëshmitarëve, as sipas vendimit të gjykatësit ligjor dhe as me ndonjë gjë tjetër që bie në kundërshtim me atë që ai di.

Ti mund të thuash: Fjala e Ligjvënësit: “Agjëroni me shikimin dhe çeleni agjërimin me shikimin.”, tregon se dituria që është detyrë të ndiqet për vërtetimin e daljes së hënës së re, është dituria që arrihet me anë të shikimit vizual dhe jo dituria e arritur me ndonjërin prej shkaqeve e rrugëve të lartpërmendura.

Në përgjigje ne themi: Dituria është argument, pavarësisht nga shkaku që ajo mund të ketë lindur, prandaj as ligjvënësi e as dikush tjetër s’ka të drejtë të ndajë shkaqet e lindjes së diturisë, sepse argumentimi me anë të diturisë është objektiv, jo i përfutur dhe, si i tillë, askush, kushdo qoftë ai, s’ka të drejtë ta anulojë këtë argument, ose të veprojë me këtë argument, duke e copëtuar e duke e modifikuar. Patjetër që ligjvënësi ka të drejtë të konsiderojë diturinë pjesë prej subjekteve të dispozitave të tij, ashtu siç është vendosur në bazat, por ajo që ne jemi të huaj në këtë çështje, qëndron në faktin se ligjvënësi ka vënë në konsideratë shikim viziv si mjet për të vërtetuar diturinë për daljen e hënës së re dhe jo si qëllim në vetvete, ashtu siç ndodh në të gjitha rrugët e panjohura për njohjen e dispozitave. Me një fjalë, emri i rrugës tregon vetë rrugën.

Ka mbetur vetëm një çështje, çështja e fjalës së astronomëve. Vallë a njofton apo nuk njofton dituria e arritur prej astronomëve për çdo dyshim, ashtu siç njofton shikimi viziv?

Dihet përgjigjja për këtë pyetje, në saje të asaj që kemi thënë më sipër: Çështja ndryshon sipas personave. Është plotësisht si çështja e besueshmërisë në personin që pretendon se ka parë daljen e hënës së re, ose si fjala e mjekut, kur lajmëron për

dëmtimin ose për mosdëmtimin e shëndetit. Ai që e arrin diturinë me anë të fjalëve të astronomëve, ka detyrë të ndjekë astronomët dhe, pas kësaj, atij nuk i lejohet të kapet as pas argumenteve, as pas vendimit të gjykatësit ligjor e as pas fjalëve të të tjerëve që bien në kundërshtim me diturinë e arritur prej tij, ndryshe s'ka rrugë tjetër përveç rrugëve të argumenteve të ligjit të fesë që ne i përmendëm. Sido që të jetë, ne dhe të tjerë veç nesh, kemi të drejtë të themi: Fjala e astronomëve deri tani është ndërtuar mbi "afërsisht" dhe jo mbi vërtetimin me argument. Kjo ka ardhur e vjen sipas ndryshueshmërisë mes tyre dhe spekulimeve që mund të bëhen me fjalët e tyre për caktimin e natës, kur do të dalë hëna e re, për orën kur hëna do të dalë dhe sa kohë do të qëndrojë hëna e re, prandaj, kur për dijetarët e për astronomët të vijë koha që ata do të kenë në dispozicion mjete më të përsosura dhe, kur të përdorin metoda llogaritje më ta sakta, domethënë atëherë, kur fjala e tyre të jetë unike në lidhje me daljen e hënës së re, përveç kësaj, vërtetësia e fjalës së tyre duhet të përsëritet herë pas herë pa ndërprerje dhe vetëm kur fjalët e tyre taksative të jenë të shumta si numër dhe pa ndryshim, plotësisht si ditët e javës, atëherë, në këtë gjendje, mund të mbështetemi në fjalët e astronomëve dhe t'i marrim fjalët e tyre si pikë referimi për çështjen e vërtetimit të daljes së hënës së re, në atë mënyrë që dituria të arrihet prej të gjithëve, prej fjalëve të astronomëve dhe jo kur dalja e hënës vërtetohet prej një individi e vërtetohet prej një individi tjetër, ose vërtetohet prej një shtrese e nuk vërtetohet prej një shtrese tjetër.

* * *

I'TIKAFI

Kuptimi i i'tikafit

Në fjalët e arabëve “i'tikàf” dhe “akùf” do të thotë qëndrim pranë një sendi në një vend. Thuhet për filanin “akefe” ose “iëtekefe”, kur ai qëndron në atë vend dhe nuk del prej tij, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar në fjalën e tij të nderuar:

“...ç’janë këto statuja që i adhuron?” “مَا هَذِهِ التَّمَاثِيلُ الَّتِي أَنْتُمْ لَهَا عَاكِفُونَ

(Sure “El Enbija”, ajeti 52). Në ligjin e fesë, “i'tikàf” do të thotë qëndrimi pranë një vendi të veçantë, në një vend të veçantë dhe me kushte të përcaktuara. Kushtet e iëtikafit do të shpjegohen në vijim.

I'tikafi është adhurim i pëlqyer

I'tikafi është adhurim i pëlqyer dhe i ligjësuar me Librin e Allahut, me praktikën profetike (Sunetin) dhe me fjalën e të gjithë fukahave. Prej Kur’anit Famëlartë kemi fjalën e Allahut:

“أَنْ طَهَّرَا بَيْتِي لِلطَّائِفِينَ وَالْعَاكِفِينَ وَالرُّكَّعِ السُّجُودِ”

“...ju të dy pastroni shtëpinë Time për vizitorët, për ata që qëndrojnë aty dhe për ata që falin namaz aty.” (Sure “El Bekare”, ajeti 125)

Prej Sunetit kemi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*):
 “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qëndroi në iëtikaf në Muajin e Ramazanit, në dhjetëditëshin e parë, pastaj qëndroi në iëtikaf në dhjetëditëshin e mesit dhe pastaj qëndroi në iëtikaf në dhjetëditëshin e tretë. Pastaj vazhdoi të qëndrojë në iëtikaf në këtë të fundit...”

Ka edhe transmetime të tjera që flasin për këtë çështje.

Kushtet

1, 2, 3- Besimi (imani), mendja dhe nijeti për afrim te Allahu, sepse i'tikafi është adhurim dhe adhurimi nuk është i vlefshëm pa këto tri cilësi.

4- Agjërimi, ashtu siç ka thënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “S’ka i'tikaf pa agjërim.” Bazuar mbi këtë transmetim, i'tikafi nuk është i vlefshëm në ditët e dy bajrameve, për shkak se agjërimi në këto dy festa është haram. Gjithashtu, iëtikafi nuk është i vlefshëm as kur qëndron në i'tikaf gruaja me menstruacione dhe gruaja në periudhën e hemorragjisë së lehonisë, për shkak se agjërimi në këto dy periudha është haram për këto dy kategori grash, ashtu siç është haram për ato edhe qëndrimi në xhami.

5- I'tikafi të bëhet në xhaminë kryesore, ose në xhaminë e përgjithshme dhe jo në xhaminë e lagjes, ose në vendin e caktuar në familje për faljen e namazit. Për këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "I'tikâfi bëhet në xhaminë kryesore, por më e pëlqyeshme është që të bëhet në njërën prej katër xhamive: në xhaminë e Qabes, në xhaminë e të Dërguarit të Allahut, në xhaminë e Kufes dhe në xhaminë e Basras."

6- I'tikafi të mos jetë më pak se tri ditë e dy net. Për këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "I'tikafi nuk është më pak se tri ditë."

7- Qëndrimi i pandërprerë në xhami, në kuptimin që të mos dilet prej xhamisë pa ndonjë shkak detyrues. Në lidhje për këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Personi që hyn në i'tikaf nuk del prej xhamisë, pa pasur ndonjë nevojë për shkak të së cilës duhet të dalë patjetër dhe pas daljes nuk qëndron gjëkund, por kthehet në xhami, në kuptimin që brenda mundësisë, të qëndrojë sa më pak jashtë xhamisë, kurse për probleme të tjera ai del vetëm për të përcjellë xhenazen, ose për të vizituar një të sëmurë. Pas kryerjes së detyrës, ai kthehet pa vonesë në xhami."

Çështje

1- I'tikafi është farz dhe mustehab. I'tikafi farz është ai që bëhet detyrim, kur takset (nedhr) për ndonjë bësëdhënie, ose për ndonjë betim. I'tikafi mustehab është kur njeriu vendos të bëjë një punë të mirë, i shtyrë nga qëllimi që të kryejë adhurim për t'u afruar te Allahu i Gjithëpushtetshëm. I'tikafi farz është kur kryhet

në një kohë të veçantë, si për shembull ai që e taks të kryejë i'tikaf gjatë ditëve të bardha të muajit Shaban. Kur ai e fillon i'tikafin, nuk lejohet të heqë dorë prej tij, as në ditën e parë e as në ditën e mëpasshme, kurse për i'tikafin mustehab ai ka të drejtë të heqë dorë prej tij para kalimit të dy ditëve, ditës së parë dhe ditës së dytë. Por, nëse të dy ditët kalojnë, ai ka detyrim të qëndrojë në xhami patjetër edhe ditën e tretë. Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Ai që kryen i'tikaf tri ditë, ditën e katërt e ka me dëshirë.”, domethënë, nëse ai ka dëshirë, qëndron edhe tri ditë të tjera në i'tikaf, ose, nëse dëshiron, del prej xhamisë. Nëse qëndron dy ditë pas ditës së tretë, ai nuk del prej xhamisë pa plotësuar edhe tri ditë të tjera.”

2- Nuk është detyrim që agjërimi të jetë i veçantë për iëtikafin, por është e mjaftueshme që të jetë agjërim në përgjithësi, qoftë edhe agjërim për ndonjë qëllim tjetër. Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Kushti i agjërimit për i'tikafin është si kushti i pastrimit për faljen e namazit.” Nuk vihet në konsideratë që agjërimi të jetë për i'tikafin, pasi për vlefshmërinë e i'tikafit është e mjaftueshme që i'tikafi të jetë së bashku me agjërimin, edhe në qoftë se agjërimi nuk është për i'tikafin, është e barabartë, qoftë kur agjërimi është agjërim farz, qoftë kur është agjërim mustehab. Gjithashtu, është e barabartë, kur agjërimi farz është për Ramazanin, ose në një muaj tjetër. Në lidhje me këtë çështje, nuk ka asnjë kundërshtim.

3- Për atë që hyn në i'tikaf është haram kryerja e marrëdhënieve intime me gruan. Gjithashtu, edhe për gruan që hyn në i'tikaf, është haram kryerja e marrëdhënieve intime me burrin, natën ose ditën, madje për të dy është haram edhe prekja e puthja me epsh. Në lidhje për këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja*

qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur ka hyrë në i'tikaf, ai nuk shkon te gruaja e tij as natën e as ditën.” Në qoftë se kryen marrëdhënie intime me gruan e tij natën, ose ditën, jo në Muajin e Ramazanit, mbi të rëndon detyrimi për kryerjen e shlyerjes.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka hyrë në i'tikaf dhe kryen marrëdhënie intime me gruan e tij. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “Ai ka të njëjtin detyrim që ka personi që prish me qëllim një ditë agjërimi në Muajin e Ramazanit.”, domethënë, lirim e një robi, ose agjëron dy muaj rresht, ose ushqen gjashtëdhjetë të varfër.

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka hyrë në iëtikaf dhe kryen marrëdhënie intime me gruan e vet natën, gjatë Muajit të Ramazanit. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai ka detyrim të kryejë shlyerjen.” Pyetësi tha: “Po sikur ai të kryejë ditën marrëdhënie intime me gruan?” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Ai ka detyrim të kryejë dy shlyerje, njëren shlyerje për iëtikafin dhe shlyerjen e dytë për prishjen e agjërimin në Muajin e Ramazanit.”

Për atë që hyn në i'tikaf, sipas fjalëve të autorit të librit “Esh Sheràiu”, masturbimi është haram. Autori i librit “El Xheuàhir” dhe i librit “El Medàrik” ka thënë: “Për këtë çështje unë nuk kam hasur ndonjë tekst të veçantë.”

Gjithashtu, për që atë hyn në iëtikaf është haram shit-blerja, nuhatja e parfumeve, shijimi i gjërave aromatike dhe polemikat. Në lidhje për këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai që hyn në i'tikaf, nuk nuhat parfum, nuk shijon gjëra aromatike, nuk polemizon dhe nuk ble e nuk shet.”

Fjala “polemikë”, në tekst, ka ardhur me fjalën arabe “mumàràt”, që do të thotë: polemikë e grindje për ndonjë send të

kësaj bote, ose edhe për ndonjë çështje të fesë, me dëshirën për të qenë mbi të tjerët dhe për t'u dukur. Nuk ka asnjë dallim, nëse gjërat e veprimet haram, që u përmendën, ndodhin natën apo ditën, sepse i'tikafi është natën dhe ditën. Meqenëse agjërimi është kusht për i'tikafin, vetvetiu rezulton se çdo gjë që prish agjërimin, prish edhe i'tikafin. Nga shprehjet e fukahave dhe të dijetarëve të bazave të ligjit të fesë kuptohet që i kushtëzuari nuk ekziston, kur nuk ekziston kushti për atë.

4- Kur i'tikafi priset me ndonjërin prej prishësve që u përmendën, a është detyrim apo jo përsëritja e i'tikafit për herë të dytë?

Përgjigje:

Ai shikon: Në qoftë se i'tikafi është farz, patjetër duhet të përsëritet me nijetin e kryerjes kaza, për shkak të detyrimit për bindje e përvetësim të urdhrit për kryerjen e adhurimit në kohën e vet, si dhe për shkak të urdhrit për kryerjen kaza të adhurimit të humbur. Por, kur i'tikafi është mustehab dhe priset para se të kalojnë dy ditë, mbi atë nuk ka asnjë detyrim, sepse, në bazë, nuk ka detyrim, kurse dega nuk shtohet mbi origjinën. Por në qoftë se prishja ka ndodhur, pasi kishin kaluar dy ditë, atëherë është detyrim përsëritja e i'tikafit, sepse tani ekziston vendi për detyrimin, ashtu siç u tha edhe më sipër.

* * *

ZEKATI

Kuptimi i zekatit

Nga ana gjuhësore, fjala “zekat” do të thotë rritje. Në këtë kuptim është edhe fjala e arabëve “u rrit bimësia”, domethënë u rrit e mirë. Gjithashtu, në këtë kuptim është edhe fjala e Allahut të Lartësuar:

- “أَفْتَلْتُ نَفْسًا زَكِيَّةً بِغَيْرِ نَفْسٍ” -

“...si vrave një njeri të pastër pa vrarë ai asnjeri...” (Sure “El Kehf”, ajeti 74)

Në ligjin e fesë, zekat është emri për sadakanë e detyrueshme, që jepet për pasurinë, pasi te Allahu i Plotpushtetshëm, me këtë dhënie, pastrohet pasuria dhe dhënësi bëhet prej të pastruarve. Për këtë kuptim tregon ajeti i nderuar i Kur’anit:

“خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَدَقَةً تُطَهِّرُهُمْ وَتُزَكِّيهِمْ بِهَا”

- “Merr prej pasurisë së tyre sadakanë, që me atë t’i pastrosh ata dhe t’i shtosh (mirësitë).” (Sure “Et Teubeh”, ajeti 103)

Detyrimi

Zekati është detyrim dhe është prej domosdoshmërive të fesë, plotësisht ashtu siç është edhe namazi. Prandaj kush e mohon detyrimin për dhënien e zekatit, ai del menjëherë prej Islamit. Këtu qëndron edhe urtësia e të Lartit, që e përmend zekatin të shoqëruar me namazin, në shumë ajete të Kur'anit Famëlartë, si për shembull në ajetet vijuese:

“وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ”

“Falni namazin dhe jepni zekatin...” (“Sure El Bekare”, ajeti 43)

“فَإِنْ تَابُوا وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ فَخَلُّوا سَبِيلَهُمْ”

“...nëse ata pendohen, falin namazin dhe japin zekatin, atëherë, atyre u lëshoni rrugë...” (“Sure Et Teubeh”, ajeti 5)

“فَإِنْ تَابُوا وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ فَخَلُّوا سَبِيلَهُمْ فِي الدِّينِ”

“Nëse ata pendohen, falin namazin dhe japin zekatin, atëherë ata janë vëllezërit tuaj në fe...” (“Sure Et Teubeh”, ajeti 11)

“وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ خُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ”

“Ata nuk u urdhëruan për gjë tjetër përveç të adhuronin Allahun me sinqeritet të plotë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë dhe të falin namazin e të japin zekatin...” (“Sure El Bej’jineh”, ajeti 5)

“قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ. الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ. وَالَّذِينَ هُمْ عَنِ اللَّغْوِ مُعْرِضُونَ. وَالَّذِينَ هُمْ لِلزَّكَاةِ فَاعِلُونَ”

“Me siguri që kanë shpëtuar besimtarët: ata që janë të përlulur e të përkushtuar në faljen e namazit. Ata që i shmangen kotësive (në fjalë e në punë). Ata që japin zekatin e japin rregullisht.”
 (“Sure El Muminùn”, ajetet 1-4)

“قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى. وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى”

“Ka shpëtuar ai që është pastruar; që përmend emrin e Zotit të tij dhe fal namaz...” (“Sure El A'la”, ajet 14-15), si dhe në shumë ajete të tjera.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Allahu i Gjithëpushtetshëm ka bërë të drejtë për të varfrit në pasurinë e të pasurve, aq sa ata kanë mundësi dhe, nëse ata nuk do të kishin mundësi, me siguri që Ai do t’ua shtonte atyre. Të pasurit nuk jepnin para se Allahu i Lartësuar të bënte detyrim dhënien, por të pasurit, para këtij detyrimi, i kishin mohuar të varfërve të drejtën që u takonte dhe nuk jepnin prej asaj pasurie që Allahu e ka bërë detyrim për ata të japin. Sikur njerëzit të kishin kryer detyrimet e tyre, me siguri do të jetonin në mirësi.”

Ky transmetim tregon qartë se të varfrit janë prej tokës dhe nuk janë prej qiellit, janë të varfër për shkak të padrejtësisë që njerëzit i bëjnë njëri-tjetrit dhe jo prej Allahut të Lartësuar dhe prej urtësisë së Tij tepër të madhe.

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Allahu i Lartësuar nuk e pyet robin

për namazin, pasi ai ka falur namazin farz, as për sadakanë, pasi ai dhënë zekatin dhe as për agjërimin, pasi ai ka agjëruar në Muajin e Ramazanit.”

Në fillim për zekatin do të flitet se kush e ka detyrim të japë zekat, së dyti, për llojet e pasurive për të cilat jepet zekati dhe së treti, kush meriton të marrë zekat.

Kush ka detyrim të japë zekat?

Dhënia e zekatit për atë që ka detyrim të japë zekat, bëhet obligim, kur plotësohen kushtet vijuese:

1- Mosha, domethënë, kur njeriu arrin moshën në të cilën kupton dhe nuk është detyrim për atë që nuk ka arritur akoma këtë moshë. Junes bin Jakubi tregon: I shkrova Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): ‘Kam vëllezër të vegjël. Kur bëhet detyrim për ata që të japin zekat për pasurinë e tyre?’ Ai tha: “Kur për ata të bëhet detyrim falja e namazit, atëherë bëhet detyrim për ta edhe dhënia e zekatit.”

Në vijim Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Në pasurinë e jetimit s’jepet zekat, gjithashtu, jetimi s’ka detyrim të falë as namaz, nuk jepet zekat për të gjitha llojet e prodhimeve të tokës së jetimit, drithëra, hurma e të mbjella të tjera. Kur jetimi të arrijë moshën, ai nuk ka detyrim të japë zekat për kohën e kaluar, ashtu siç nuk ka detyrim të japë zekat për të ardhmen, derisa të arrijë moshën kur ai kupton. Vetëm atëherë kur arrin moshën në të cilën ai kupton, ai ka detyrim të japë vetëm një zekat. Më pas ai ka të njëjtat detyrime që kanë njerëzit e tjerë.”

Fukahatë më të dëgjuar kanë punuar me këtë transmetim e me transmetime të tjera, që shërbejnë si argument për atë që pohon detyrimin për dhënien e zekatit prej pasurive të atyre që nuk kanë arritur moshën, përveç parave flori e argjend. Padyshim që për kujdestarin e jetimit, gjyshi, ose kujdestari ligjor, është mustehab të japë zekat për të pastruar pasuritë e jetimit.”

2- Mendja. Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se dispozita për të çendurin është e njëjtë me dispozitën për fëmijën.” Për fëmijën nuk është detyrim të jepet zekat. Pastaj tha: “Kjo çështje është me problem, pasi për këtë nuk ka argument mbi të cilin mund të mbështetet për të arritur në këtë rrafshim, përveç atyre burimeve, te të cilat fakijhu (juristi) nuk duhet të gjejë strehë.”¹

3- Pasuria të jetë pronë e plotë e atij që e ka, në atë mënyrë që ai ka mundësi të veprojë me atë pasuri. Nuk ka zekat për pasurinë e dhuruar, derisa ajo të jetë në dorën e personit që i është dhuruar dhe nuk ka zekat për pasurinë e lënë me testament, as për borxhin, as për pasurinë e grabitur, as për pasurinë e lënë peng, as për pasurinë e ngurtësuar dhe as për pasurinë që nuk është prezent, pasi zekati për këto lloje pasurish bëhet detyrim

¹ Nuk ka vlerë të nxirret argument për të mohuar zekatin për pasurinë e fëmijës dhe të të çmendurit, bazuar në hadithin: “Lapsi është ngritur për fëmijën, derisa të dallojë dhe për të çmendurin, derisa të ndërgjegjësohet.” Ky hadith, në të vërtetë, mohon ndëshkimin dhe dispozitën obliguese, por nuk mohon dispozitën pozitive, që është vërtetimi i dhënies së zekatit për pasurinë e të çmendurit dhe të fëmijës. Dobia e këtij vërtetimi është që ne të konsiderojmë fillimin e vitit të plotë hënor, për të cilin do të flitet më poshtë, kur pasuria arrin shumën e “nisàbit” dhe jo që nga koha kur fëmija arrin moshën e dallimit dhe as kur i çmenduri ndërgjegjësohet.

vetëm, pasi ato të jenë në dorë të pronarit dhe ai të ketë mundësi të plotë për të vepruar me atë pasuri.

Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “S’ka zekat për borxhin e as për pasurinë që nuk e ke në dispozicion, derisa ajo të bjerë në dorën tënde.”

Zurara e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që nuk e ka pasurinë pranë vetes, kur ai s’ka fuqi e mundësi ta marrë atë pasuri. Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Për këtë pasuri nuk jepet zekat, derisa ajo të dalë dhe, pasi të dalë, ai jep zekat për atë pasuri vetëm për një vit.”

Nuk ka dallim për mosvarjen e zekatit për borxhin, mes atij që ka fuqi e mundësi ta marrë borxhin, kur të dëshirojë dhe mes atij që nuk e ka këtë fuqi e mundësi. Kjo është thënia më në zë në mesin e fukahave të mëvonshëm, bazuar në dëshminë e autorit të librit “El Hadàik”.

Kur një njeri i jep kredi një tjetri në shumën e “nisàbit”, si për shembull, i jep njëzet dinarë, a është detyrim që kredituesi të japë zekat për kredinë e dhënë, pasi në fakt ai është pronari i pasurisë, apo detyrimi për dhënien e zekatit të kësaj shume është për kredimarrësin që e ka në dorë atë shumë?

Përgjigje:

Kjo çështje shikohet: Në qoftë se kredimarrësi vepron me këtë shumë, para se të kalojë një vit i plotë hënor, mbi atë nuk rëndon asnjë detyrim. Por në qoftë se ai e mban këtë shumë dhe

nuk vepron me atë si total, ose me një pjesë të saj, derisa kalon viti i plotë hënor, detyrimi për dhënien e zekatit të kësaj shume i takon kredimarrësit, për shkak se shuma është në dorën e tij për të vepruar me të dhe është ai që ka mundësi të përfitojë prej kësaj shume, kur të dëshirojë.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që krediton me një shumë një tjetër. Mbi cilin prej këtyre të dyve mbetet detyrimi për dhënien e zekatit për shumën e kredituar? A mbetet detyrimi mbi kredituesin apo mbi kredimarrësin? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) u përgjigj: “Jo, detyrimi për dhënien e zekatit për këtë shumë mbetet mbi kredimarrësin, në qoftë se shuma është vënë te ai me afat kohor për një vit të plotë hënor.”

Jomyslimani

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se jomyslimani është i obliguar me degët, ashtu siç është i obliguar edhe me bazat, ku ndër më të rëndësishmet, është dhënia e zekatit. Allahu i Lartësuar thotë:

“وَوَيْلٌ لِّلْمُشْرِكِينَ الَّذِينَ لَا يُؤْتُونَ الزَّكَاةَ”

“...mjerim i madh për idhujtarët, të cilët nuk japin zekatin...”
 (“Sure Fus’silet”, ajetet 6-7)

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët që adhurimi i jomyslimanit, me të gjitha pjesët e tij, nuk është i vlefshëm, sepse nijeti për afrimin te Allahu është kusht për vlefshmërinë e adhurimit dhe Allahu i Gjithëpushtetshëm pranon

vetëm prej atij që ka besuar te Ai, te të gjitha librat e Tij, te të gjithë të dërguarit e Tij dhe që nuk bën asnjë dallim as mes librave të Tij e as mes të dërguarve të Tij.

Në mënyrë absolute, s'ka kontradiktë mes obligimit për adhurim dhe mes pavlefshmërisë së adhurimit prej jomyslimanit, veçse me këtë besim, sepse besimi është kusht për ekzistencën e obligimit dhe nuk është kusht për obligimin për kryerjen e adhurimit, si parathënie për ekzistencën e detyrimit nga jashtë, pasi është e mundur që edhe jomyslimani të besojë, të falë namaz dhe të japë zekat. Por, kur ai vazhdon të këmbëngulë në mohimin, në të vërtetë ai kundërshton me vullnetin e tij dhe me përzgjedhjen e tij të keqe, prandaj është e drejtë ndëshkimi e dënimi i tij.

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët, ashtu siç ka thënë autori i librit “Misbàhul Fakijh”, se kur jomyslimani përqafton Islamin, për atë bie detyrimi për dhënien e zekatit dhe për faljen e namazit për kohën para se ai të përqafojë Islamin, duke punuar sipas fjalës së hadithit: “Islami i shlyen ato që ishin para tij.”

Shejkh El Hamedànij, në librin “Misbàhul Fakijh” dhe Sej'jid El Hakijm, në librin “El Mustemsek”, kanë thënë: “Detyrimi për dhënien e zekatit (për kohën, kur ai nuk ka përqaftuar Islamin) bie për mohuesin thjesht me pranimin e Islamit prej tij.”, plotësisht ashtu si bie edhe detyrimi për faljen e namazit.

Në lidhje me këtë çështje fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët. Veç kësaj, kjo çështje është e njohur në mënyrë taksative prej jetëshkrimit të Profetit (Paqja e bekkimi i Allahut

qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe prej familjes së tij. Nuk njoftohet që Profeti (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e familja e tij të kenë bërë detyrim ndonjë gjë prej këtyre detyrimeve për atë që përqafonte Islamin.

Pasuritë për të cilat është detyrim dhënia e zekatit

Dy imamët, Imam Bakiri dhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi ata të dy!*) kanë thënë: “Allahu ka bërë detyrim faljen e namazit së bashku me dhënien e zekatit për pasuritë.” I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me praktikën e tij, e ka ligjëruar dhënien e zekatit për nëntë tituj pasurish dhe ka falur për titujt e pasurive të tjera. Nëntë titujt e pasurive janë: floriri, argjendi, devetë, lopët, dhentë, gruri, elbi, hurma dhe rrushi i thatë (stafidhet), kurse pasuritë e tjera i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ka falur.

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Përveç këtyre katër kategorive s’kanë zekat prodhimet e tjera që mbijnë nga toka, si: orizi, misri, qiqrat, adesi, të gjitha kokrrat e frutat, edhe nëse çmimi i këtyre prodhimeve është i lartë, përveçse kur ato bëhen mall që shiten me flori e me argjend, të cilat ti i depoziton dhe pastaj shumat e realizuara nga shitja qëndrojnë te ti një vit të plotë hënor.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për zekatin. Ai është përgjigjur: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ka vënë zekatin për nëntë tituj

mallrash dhe ka falur për mallrat e tjera: grurë, elb, hurmë dhe rrush të thatë, floriri, argjendi, devetë, lopët e dhentë.”

Pyetësi tha: “Po misri?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) u zemërua dhe tha: “Pasha Allahun! Në kohën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte susam, misër, mel dhe të tjera.”

Pyetësi foli: “Thonë se në kohën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk kishte të tjera përveç këtyre nëntë llojeve.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) u zemërua dhe tha: “Gënjejnë, a mund të bëhej fjalë për gjëra që nuk ishin? Jo, pasha Allahun, unë nuk di të ketë zekat përveçse për këto që u thanë. Prandaj kush të dëshirojë, le të besojë dhe kush të dëshirojë, le të mohojë.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Zekati është detyrim për një lloj të veçantë prej kafshëve shtëpiake dhe prej të mbjellave. Gjithashtu, është detyrim për paratë, të cilat përfshihen në nëntë titujt e pasurive të përmendura në fjalët e dy imamëve. Prej kafshëve shtëpiake janë: devetë, lopët e dhentë, kurse prej të mbjellave janë: gruri, elbi, hurma e rrushi i thatë dhe prej parave janë, monedhat prej floriri dhe monedhat prej argjendi. Për titujt e tjerë të pasurive, dhënia e zekatit është mustehab dhe nuk është detyrim. Këtë dispozitë fukahatë e kanë nxjerrë prej transmetimeve që ne

përmendëm më sipër dhe prej transmetimeve të tjera që kanë ardhur në këtë kuptim.

Pra, përveç këtyre nëntë tituj mallrash, zekati për mallrat e tjerë është mustehab dhe jo farz, që do të thotë: është mustehab të jepet zekat për çdo bereqet që matet e peshohet, përveç grurit e elbit, si qiqrat, orizi e thjerza, frutat (mollët e pjeshkët, etj), përfshirë edhe zarzavatet e bishtajoret. Gjithashtu, është mustehab të jepet zekat për mallrat e tregtisë. Jepet zekat për kuajt femra dhe jo për kuajt meshkuj, nuk jepet zekat as për mushkat e as për gomarët. Gjithashtu, është mustehab të jepet zekat për tokat bujqësore, të cilat shfrytëzohen dhe jepen me qera, si kopshtet, dyqanet dhe objektet e përgatitura për t'u dhënë me qera, sepse të gjitha këto hyjnë në mallrat e tregtisë, ashtu siç është shprehur edhe autori i librit "El Xheuàhir".

Argumenti për qenien mustehab të zekatit për këto mallra, gjendet në transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*) dhe tregojnë qartë se dhënia e zekatit për këto lloje sendesh është detyrim. Por fukahatë e kanë futur këtë detyrim në kategorinë e detyrimit mustehab, veprim i pëlqyer dhe kanë thënë: Qëllimi për vërtetimin e zekatit për këto sende është në shkallën mustehab, veprim i pëlqyer dhe jo në gradën e farzit, detyrim i domosdoshëm, duke bashkuar këto transmetime me transmetimet që theksojnë detyrimin për dhënien e zekatit për nëntë titujt e pasurive të lartpërmendura dhe që e mohojnë për sendet e tjera.

Fukahatë kanë rënë në pajtim ndërmjet tyre në lidhje me thënien shumë të njohur: Kur vijnë dy argumente dhe njëri prej të cilëve vërteton detyrimin e domosdoshëm (farz), kurse transmetimi tjetër e mohon këtë detyrim, atëherë transmetimi i dytë duhet të mbartet në transmetimin që e bën detyrim dhënien e zekatit, ose më saktë, transmetimin e dytë e kanë lënë në kuptimin e tij të jashtëm, duke e mbartur në detyrimin mustehab, kështu që kjo pajtueshmëri midis fukahave është bërë një rregull i përgjithshëm për të gjithë kapituajt e fik'hut, ashtu siç ka thënë autori i librit "El Hadàik", në fillim të vëllimit të pestë, kapitulli "Zekati", ku mbartja e kuptimit ngjason me bashkimin tradicional, siç është mbartja e të përgjithshmes mbi të veçantën dhe e absolutes mbi të kushtëzuarën, por jo bashkimi ligjor, i cili ka nevojë për argument të tretë, që të ndajë e të bëjë diferencimin mes burimeve, çka mundëson të specifikohet argumenti vërtetues në njërin burim dhe argumenti mohues në burimin tjetër. Gjithashtu, kur ka ardhur argumenti që bën haram një send dhe një argument tjetër e mohon qenien e atij sendi haram, atëherë mbetet të vërtetohet qenia e sendit haram ashtu siç është, kurse argumentin që e mohonte qenien haram të sendit e kanë mbartur për bërjen e sendit kerahet.

Aty ku ka kushte të veçanta në njërin prej tri llojeve të kafshëve shtëpiake, ose në njërin prej katër llojeve të të mbjellave, ose në njërin prej dy llojeve të monedhave, përveç kushteve që ne kemi përmendur në lidhje me titujt e pasurive për të cilat është detyrim dhënia e zekatit, del si domosdoshmëri të shpjegojmë çdo lloj në një kapitull të pavarur.

* * *

ZEKATI PËR KAFSHËT SHTËPIAKE

Devetë

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në më pak se pesë kokë deve, s’ka detyrim dhe, kur janë pesë kokë, për ato jepet zekat një dele, derisa të bëhen dhjetë kokë deve. Kur bëhen dhjetë kokë, atëherë jepet zekat dy dele dhe, kur numri i deveve arrin pesëmbëdhjetë kokë, për ato jepet zekat tri dele; kur bëhen njëzet kokë deve, për ato jepet zekat katër dele; kur numri i deveve arrin në njëzet e pesë kokë, për ato jepet zekat pesë dele dhe, kur shtohet edhe vetëm një deve e vetme mbi njëzet e pesë kokë deri në tridhjetë e pesë kokë deve, për ato jepet zekat një deve femër që ka hyrë në vitin e dytë, domethënë nëna e secilës të jetë mbarsur përsëri (ibnetu mekhàd).

Në qoftë se nuk ka nga kjo lloj deveje, atëherë në vend të saj jep një deve mashkull, nëna e të cilit ka lindur dhe në më të shumtën e kohës është me qumësht (ibnu lebùn). Kur numri i deveve shtohet edhe një deve më shumë se tridhjetë e pesë kokë deri në dyzet e pesë kokë, jepet zekat një deve femër që ka hyrë në vitin e tretë të jetës, domethënë nëna e së cilës ka lindur përsëri dhe në më të shumtën e kohës është me qumësht (ibnetu lebùn).

Kur numri i deveve shtohet edhe një deve më shumë se dyzet e pesë kokë deri në gjashtëdhjetë kokë, jepet zekat një deve femër që ka hyrë në vitin e katërt të jetës dhe që përdoret për mbartje ngarkesash. Kur shtohet edhe një deve më shumë, deri në shtatëdhjetë e pesë kokë, jepet zekat një deve femër që ka hyrë në vitin e pestë të jetës.

Në qoftë se shtohet edhe një deve më shumë deri në nëntëdhjetë kokë, jepen zekat dy deve femra, që kanë hyrë në vitin e tretë të jetës. Në qoftë se shtohet edhe një deve më shumë deri njëqind e njëzet kokë, për këtë numër kokësh jepen zekat dy deve femra, që kanë hyrë në vitin e katërt të jetës. Në qoftë se shtohet edhe një kokë mbi njëqind e njëzet krerë deve, për çdo pesëdhjetë kokë jepet zekat një deve femër, që ka hyrë në vitin e katërt të jetës dhe në çdo dyzet kokë jepet një deve femër që ka hyrë në vitin e dytë të jetës.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: Nisabi për devetë është dymbëdhjetë kategori:

1- Për pesë deve, jepet një dele dhe për më pak se pesë, nuk jepet zekat.

2- Për dhjetë deve jepen zekat dy dele dhe nuk jepet më shumë, derisa të arrijë numri njëzet deve.

3- Kur bëhen pesëmbëdhjetë deve, për këtë numër devesh jepen zekat tri dele dhe nuk jepet më shumë, derisa numri i krerëve të arrijë njëzet deve.

4- Për njëzet deve jepen zekat katër dele.

5- Për njëzet e pesë deve jepen zekat pesë dele. Këto janë nisabet për devetë, domethënë për çdo pesë kokë deve jepet zekat një dele, ashtu siç e pamë edhe më sipër.

6- Kur numri i deveve arrin njëzet e gjashtë krerë, për këtë numër devesh jepet zekat një deve femër, që ka hyrë në vitin e dytë të jetës.

7- Kur numri i deveve arrin tridhjetë e gjashtë, jepet zekat një deve femër që ka hyrë në vitin e tretë të jetës.

8- Në qoftë se numri i deveve arrin në dyzet e gjashtë krerë, për këtë numër devesh jepet zekat një deve femër, që ka hyrë në vitin e katërt të jetës.

9- Kur numri i krerëve arin gjashtëdhjetë e një deve, për këtë numër krerësh jepet zekat një deve femër, që ka hyrë në vitin e pestë të jetës.

10- Në qoftë se numri i krerëve të deveve arrin shtatëdhjetë e gjashtë, për këtë numër krerësh jepen zekat dy deve femra, që kanë hyrë në vitin e dytë të jetës.

11- Kur numri i krerëve të deveve arrin nëntëdhjetë e një, për këtë numër krerësh jepen zekat dy deve femra, që kanë hyrë në vitin e katërt të jetës.

12- Kur numri i krerëve bëhet njëqind e njëzet e një deve, për çdo pesëdhjetë deve jepet zekat një deve femër, që ka hyrë në vitin e katërt të jetës, ose për çdo dyzet deve jepet zekat një deve femër, që ka hyrë në vitin e dytë të jetës. Kuptimi për të dhënë

zekat një deve femër, që ka hyrë në vitin e katër të jetës për çdo pesëdhjetë kokë deve dhe për të dhënë një deve femër që ka hyrë në vitin e dytë të jetës për çdo dyzet kokë deve, do të thotë që dhënësi i zekatit zgjedh numrin që është më në favor të të varfërve.

Në qoftë se janë vetëm njëqind e njëzet e një kokë deve, ai i numëron ato me dyzet kokë dhe kështu jep zekat për këtë numër tri deve femra, që kanë hyrë në vitin e dytë të jetës; në qoftë se numri i deveve arrin njëqind e pesëdhjetë kokë, ai i numëron me pesëdhjetë deve dhe, për këtë numër devesh, ai jep zekat tri deve femra, që kanë hyrë në vitin e katërt të jetës dhe që natyrisht janë më të mëdha se devetë që kanë hyrë në vitin e dytë të jetës. Kur numri për dy llojet e deveve që jepen zekat, në raport me të varfrit është i barabartë, si për shembull, kur numri i deveve arrin në treqind krerë, dhënësi i zekatit bën përzgjedhjen të bëjë numrin me dyzet kokë dhe kështu jep zekat pesë deve femra, që kanë hyrë në vitin e dytë të jetës, ose ai e bën numërimin me pesëdhjetë kokë dhe jep zekat katër deve femra, që kanë hyrë në vitin e katërt të jetës. Ky rregull zbatohet, kur çmimi i pesë deveve, sipas numërimit të parë, është i barabartë me çmimin e katër deve, sipas numërimit të dytë. Pra, ai përzgjedh gjithmonë atë numër që anon më mirë për të varfrit.

Lopët

Imam Bakri dhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi ata të dy!*) kanë thënë: “Në tridhjetë lopë jepet një lopë femër, që ka hyrë në vitin e dytë të jetës (tebij`e haulij) dhe në më pak se tridhjetë lopë,

nuk jepet zekat. Në dyzet lopë, jepet zekat një lopë femër, që ka hyrë në vitin e tretë të jetës (musin'neh). Ndërmjet tridhjetë krerëve e dyzet krerëve nuk ka zekat, derisa të bëhen dyzet krerë. Kur bëhen dyzet krerë, atëherë jepet zekat, ashtu siç u tha më sipër, jepet një lopë, që ka hyrë në vitin e tretë të jetës.

Gjithashtu, ndërmjet dyzet krerëve deri në gjashtëdhjetë krerë lopë nuk ka zekat, por, kur numri i lopëve bëhet gjashtëdhjetë krerë deri në shtatëdhjetë krerë, zekati për këtë numër krerësh është dy lopë, që kanë hyrë në vitin e dytë të jetës; kur numri i lopëve arrin shtatëdhjetë deri në tetëdhjetë krerë, për këtë numër lopësh zekati është një mëshqerrë, që ka hyrë në vitin e dytë të jetës dhe një lopë që ka hyrë në vitin e tretë të jetës; kur numri i lopëve arrin tetëdhjetë krerë deri në nëntëdhjetë krerë, për çdo dyzet lopë zekati është një lopë që ka hyrë në vitin e tretë të jetës dhe, kur numri i lopëve arrin në nëntëdhjetë kokë, zekati për këtë numër krerësh është tri mëshqerra, që kanë mbushur dy vjeç dhe, kur numri i lopëve arrin njëqind e njëzet kokë, për çdo dyzet lopë jepet një lopë, që ka hyrë në vitin e tretë të jetës."

Fukahatë

Ky transmetim ka konsensusin e të gjithë fukahave për të punuar me të dhe, në fakt, është shumë më i qartë se thëniet e vetë fukahave. Dhe tani vetëm një shembull prej këtij transmetimi: "Për lopët ka dy nisabe: tridhjetë, për të cilat zekati është një mëshqerrë, që ka hyrë në vitin e dytë, ose një muzat, që ka hyrë në vitin e dytë. Gjithashtu, për këtë numër krerësh, zekati është një

lopë, që ka hyrë në vitin e tretë të jetës. Kështu ka qenë gjithmonë.”

Për atë që dëshiron më shumë shpjegime, ne themi: Për tridhjetë lopë jepet zekat vetëm një mëshqerrë ose vetëm një muzat, që ka hyrë në vitin e dytë të jetës dhe për më pak se tridhjetë kokë nuk ka zekat, madje edhe sikur të supozohet se dikush ka tridhjetë lopë pa një çerek, ose pa një kirat (masë peshe që ka ndryshuar sipas kohëve). Mbi këtë njeri nuk është detyrim të japë zekat për këtë numër lopësh, kurse për çdo dyzet krerë lopë, jepet zekat një lopë, që ka hyrë në vitin e tretë të jetës. Për gjashtëdhjetë krerë lopë, zekati është dy mëshqerra, që kanë hyrë në vitin e dytë të jetës; për shtatëdhjetë kokë lopë, zekati ndahet: për dyzet kokë jepet një lopë, që ka hyrë në vitin e tretë të jetës dhe për tridhjetë lopët e tjera jepet zekat një mëshqerrë, që ka hyrë në vitin e dytë të jetës, kështu së bashku plotësojnë numrin shtatëdhjetë kokë; për tetëdhjetë krerë, për çdo dyzet lopë, zekati është një lopë, që ka hyrë në vitin e tretë të jetës; për nëntëdhjetë lopë, zekati është tri mëshqerra, që kanë hyrë në vitin e dytë të jetës, për çdo tridhjetë krerë një mëshqerrë, që ka hyrë në vitin e dytë të jetës; për njëqind krerë, zekati është një lopë, që ka hyrë në vitin e tretë të jetës; për çdo dyzet krerë dhe për gjashtëdhjetë krerë jepen zekat dy mëshqerra, që kanë hyrë në vitin e dytë të jetës; për njëqind e dhjetë krerë, zekati është dy lopë, që kanë hyrë në vitin e tretë të jetës; për njëqind e njëzet krerë lopë, pronari ka të drejtë të përzgjedhë të japë zekat mes tri lopëve, që kanë hyrë në vitin e tretë të jetës, për çdo dyzet kokë një lopë, ose katër mëshqerra, që kanë hyrë në vitin e dytë të jetës, për çdo tridhjetë kokë. Në mes dy detyrimeve nuk ka detyrim për zekat.

Buallica është si lopa dhe përfshihet në të njëjtën dispozitë, sepse është prej të njëjtit lloj. Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur, nëse ka zekat për buallicat. Ai është përgjigjur: “Njëlloj si për lopët.”

Dhentë

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Për çdo dyzet kokë dele, zekati është një dele. Për më pak se dyzet kokë dele, nuk ka zekat dhe, pas dyzet kokëve, përsëri nuk ka zekat, derisa të bëhen njëqind e njëzet kokë dele. Atëherë zekati është dy dele. Mbi këtë numër nuk jepet zekat, derisa numri i deleve të arrijë në dyqind kokë. Atëherë për këtë numër krerësh, zekati përsëri është dy dele, por, nëse numri i krerëve kalon edhe një dele më shumë se dyqind krerë, atëherë zekati për këtë numër krerësh është tri dele, derisa numri i krerëve të behet treqind kokë. Kur kalon më shumë edhe një kokë të vetme, atëherë zekati është katër dele, derisa numri i krerëve të arrijë në katërqind. Kur numri arrin në katërqind dele, zekati për këtë numër delelesh është një dele për çdo njëqind krerë dele, domethënë bie rregulli i parë, kur shtohet një dele e vetme mbi njëqind krerët.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: për dhentë ka pesë nisabe:

- 1- Për dyzet krerë, zekati është një dele.
- 2- Për njëqind e njëzet e një kokë dhen, zekati është dy dele.

3- Për dyqind e një kokë dhen, zekati është tri dele.

4- Për treqind e një kokë, zekati është katër dele.

5- Për pesëqind kokë e më shumë, zekati është një dele për çdo njëqind krerë. Për numrin që është mes dy nisabeve, nuk ka zekat.

Dispozita për dhitë është e njëjtë me dispozitën për delet, sepse janë të dyja nga e njëjta specie, por ka një veçanti, se delja që ka hyrë në vitin e dytë të jetës është e barabartë me dhinë, që ka plotësuar dy vjet dhe ka hyrë në vitin e tretë të jetës. Kështu, kush ka pesë deve dhe dëshiron të japë zekatin për këto pesë deve, mjafton të japë një dele, që ka hyrë në vitin e dytë të jetës, por, nëse zekatin do ta shlyejë me dhi, patjetër duhet të japë një dhi, që ka mbushur dy vjet dhe ka hyrë në vitin e tretë të jetës.

Nuk është kusht që dhënësi i zekatit të japë zekatin me llojin e kafshëve shtëpiake që ka, por ai ka të drejtë të përzgjedhë të japë zekatin ose me kafshët që disponon, ose kafshën e ble prej dikujt tjetër, pastaj kafshën e blerë e llogarit për masën e zekatit që ka detyrim ta japë.

Gjithashtu, ai ka të drejtë që zekatin për kafshët shtëpiake ta japë për të varfrit në para, me kusht që të mos japë më pak se mesatarja, deri edhe vlerën më të ulët të çmimit. Por nëse ai jep më shumë, padyshim që për të është shumë më mirë. Për nxjerrjen e të drejtës së përzgjedhjes, fukahatë janë bazuar në transmetimin që tregon për pyetjen që i bëri Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) një burrë: “A lejohet të jap zekat tjetër gjë, në vend të asaj që kam?” Ai iu përgjigj: “Jep atë që ke më të lehtë.”

Një tjetër i tha Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Unë i jap zekat familjeve të myslimanëve, duke blerë për ta rroba dhe ushqime, pasi mendoj se kjo është më e mirë për ta.” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “S’ka problem.”

Kushte të tjera në lidhje me kafshët shtëpiake

Zekati nuk është detyrim për tri llojet e kafshëve shtëpiake, ngaqë numri i krerëve arrin numrin e duhur për plotësimin e nisabit, ashtu siç u përmend më sipër, por patjetër duhet të plotësohen edhe kushte të tjera, të cilat përveç kushtit të nisabit, duhet të plotësohen edhe tri kushte të tjera, që janë:

I pari: çdo kokë që llogaritet në numrin e krerëve që plotësojnë nisabin, të ushqehet në kullotë natyrale dhe jo të ushqehet në stallë, sepse, kur për këtë kafshë me të drejtë thuhet se është e ushqyer në stallë, me tekst e me fjalën e përbashkët të fukahave, kjo kafshë nuk ka lidhje me zekatin. Si argument për këtë, kemi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Për kafshën që ushqehet në stallë, nuk ka asgjë, sepse, në të vërtetë, zekati jepet vetëm për kafshët që burri i lëshon të kullosin jashtë në kullotë gjatë gjithë vitit, kurse për kafshët e tjera, që nuk kullosin jashtë, për ato nuk jepet zekat.”

E dyta: Të mos jetë kafshë pune, domethënë kur ajo përdoret për hipje, ose për të lëruar tokën, ose për ngarkesë, me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, detyrimi për dhënien e zekatit për këto lloje, bie. Si argument për këtë rënie të detyrimit për dhënien e zekatit për këto lloje kafshësh, kemi fjalën

e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Për kafshët e punës s’ka asgjë.”

Për sa u përket transmetimeve të tjera, që bien në kundërshtim me këtë transmetim, ato janë transmetime të stisura dhe të lëna.

E treta: Sipas thënies më në zë, duhet të kalojë një vit i plotë hënor, duke filluar nga dita që kafsha nuk ka më nevojë për qumështin e nënës së saj, por ushqehet vetë në kullotë.

Në mënyrë të përmbledhur, këto ishin kushtet në lidhje me zekatin për kafshët shtëpiake, që ishin: arritja e nisabit, kullota në fushë, të mos jenë kafshë pune dhe të kalojë një vit i plotë hënor që ato jenë në pronësi të pronarit. Përveç këtyre kushteve, s’ka kushte të tjera. Kur prishet qoftë edhe vetëm njëri prej këtyre kushteve, qoftë edhe për një individ prej individëve të nisabit gjatë vitit të plotë hënor, është prishur viti dhe për këtë numër krerësh s’ka zekat.

Le ta ilustrojmë me një shembull: Kur numri i duhur për nisabin është i mangët, ose pronari ka ndërruar disa prej kafshëve, ose i ka përdorur ato për hipje, ose për të lëruar tokën, ose për kafshë ngarkese, ose për disa muaj, ose për disa javë i ka ushqyer ato në stallë, prej këtyre kafshëve bie emri si kafshë që kullosin në kullotë.

Kur bashkohen dy ose më shumë tufa kafshësh dhe së bashku arrijnë numrin e nisabit, për këto kafshë nuk ka zekat, përveçse kur secila tufë, në veçanti, arrin numrin e duhur të nisabit. Madje me fjalën e përbashkët të fukahave, edhe atëherë kur për to është e përbashkët kullota, vendi ku pinë ujë, shtrunga

dhe demi ose dashi. Kur njeriu disponon kafshë të llojeve të ndryshme, të cilat së bashku arrijnë numrin e duhur për nisabin, patjetër që nisabi duhet të plotësohet për çdo lloj kafshësh në veçanti. Me fjalë të tjera, kur pronari ka në pronësi një numër të unifikuar kafshësh për të formuar nisabin, madje edhe kur për atë formohen disa nisabe, por jo për formimin e nisabit, kur pronarët janë disa. Pikërisht këtë shpjegon komenti i fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nuk ka bashkim ndërmjet llojeve të ndryshme dhe nuk ka ndarje në atë që është e bashkuar.”

* * *

ZEKATI PËR DY LLOJET E MONEDHAVE

(floriri dhe argjendi)

Floriri

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në çdo njëzet dinarë prej floriri, zekati është një gjysmë dinari dhe, nëse janë më pak se njëzet dinarë, atëherë nuk ke detyrim të japësh zekat.”

Imam Bakri dhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi ata të dy!*) kanë thënë: “Për më pak se njëzet “mithkal” prej floriri, s’ka zekat dhe, kur plotësohen njëzet mithkal, zekati për këtë shumë është një gjysmë mithkali, deri në njëzet e katër mithkal, atëherë për këtë shumë jepet tre të pestat e dinarit, deri në njëzet e tetë mithkal dhe, mbi këtë bëhet llogaritja sa herë që shtohen katër.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se transmetimet prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*), në lidhje me monedhat prej floriri, herë kanë ardhur me dinarë dhe herë kanë ardhur me mithkal. Kjo nxjerr në dritë se në kohën e tyre dinari peshohej me mithkal

dhe, ashtu siç kanë thënë disa prej fukahave të asaj kohe: Dinari është i barabartë me një gjysmë lire osmane prej floriri.

Sido që të jetë, për monedhat prej floriri ka dy nisabe: njëzet dinarë, për të cilat zekati është një gjysmë dinari, domethënë sipas llogarisë dy e gjysmë për qind, kurse për më pak se njëzet dinarë, nuk jepet zekat, qoftë edhe kur mbi këtë shumë kalon një vit i plotë hënor. Nisabi i dytë është: njëzet e katër dinarë, që do të thotë se nuk ka zekat për më pak se katër, pas të njëzetave dhe, kur arrijnë në njëzet e katër, atëherë zekati për këtë shumë llogaritet mbi dy e gjysmë për qind, që i bie tre të pestat e dinarit. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur shtohet mbi njëzet e katër, mbi të shtuarën s’ka zekat, derisa totali të arrijë njëzet e tetë dhe, kur arrin në këtë shumë, zekati jepet sipas llogaritjes së lartpërmendur.” Kjo është rruga e llogaritjes për çdo shtim prej katër.

Argjendi

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në më pak se dyqind dirhem, s’ka zekat, as për më shumë se dyqind, derisa shtesa të bëhet dyzet, atëherë për shtesën zekati është një dirhem.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se për monedhat prej argjendi ka dy nisabe. Nisabi i parë: dyqind dirhemë.¹ Për këtë shumë, zekati është pesë dirhem, domethënë llogaritja bëhet mbi dy e gjysmë për qind. Në më pak se dyqind dirhem, s'ka zekat.

Nisabi i dytë: dyzet dirhemë, që do të thotë se në më pak se dyzet dirhemë, pas dyqind dirhemëve, s'ka zekat dhe, kur dirhemët arrijnë në dyqind e dyzet, atëherë zekati për këtë shumë duhet të llogaritet mbi bazën e dy e gjysmë për qind. Kështu vazhdon llogaritja për çdo shtesë me dyzetë. Pas dyzetë, gjithnjë llogaritja për dhënien e zekatit bëhet ashtu siç u tha më sipër.

Kushtet

Për arritjen e nisabit për dy llojet e monedhave, monedhave prej floriri dhe monedhave prej argjendi, patjetër duhet të shtojmë edhe dy kushte të tjera:

¹ Sej'jid Sàbik, në vëllimin e tretë të librit "Fik'hu Sun'neh", thotë: "Dyqind dirhemë janë të barabartë me 500.5 kërsh egjiptianë. Muham'med Muham'med Ismàijl, në librin "El ibàdàtu fil Islàm", thotë: "Dirhemi është i barabartë me tre gram e diçka më shumë. Bazuar mbi këtë llogaritje, kur ne i referohemi fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Në dyqind dirhemë zekati është pesë dirhemë.", si dhe fjalës tjetër të tij: "Në njëzet dinarë, zekati është gjysmë dinar.", rezultati do të ishte: dhjetë dirhemë janë baraz me një dinar. Kjo është kur marrim në konsideratë se njëzet dinarë është nisabi i parë për monedhat prej floriri dhe, për dyqind dirhemë është nisabi i parë për monedhat prej argjendi. Prandaj ajo që i bashkon dy thëniet është e njëjtë, për faktin se monedha e prerë jep të njëjtin rezultat dhe qëllimi është i njëjtë.

Kushti i parë: Floriri e argjendi të jenë prerje monedhash, ashtu siç tregon vetë fjala për këto dy lloje monedhash dhe nuk është detyrim të jepet zekat për floririn e për argjendin kallëpe e shufra, as për vathët e unazat e as për floririn e argjendin e përdorur për zbukurimin e shpatave e të librave të Kur'anit, apo të objekteve të tjera. Transmetohet se dikush e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*): “Te unë mblidhen aq sa bëjnë një vlerë të madhe dhe qëndrojnë te unë afërsisht një vit të plotë hënor. A të jap zekat për këtë pasuri?” Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “Për çdo lloj pasurie që nuk ka mbushur vitin e plotë hënor, që kur ajo pasuri është në dorën tënde, ti nuk ke detyrim të japësh zekat, gjithashtu, nuk ke detyrim të japësh zekat për mineralet që janë “rikàz”.”

Pyetësi tha: “Ç’do të thotë “rikàz”?”

Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Rikàz është i heshturi në tokë që gdhendet, të cilin, kur ti dëshiron, e pastron me anë të shkrirjes, por nuk ka zekat për floririn e për argjendin e pastruar me anë të shkrirjes, kurse i heshturi në tokë është pasuria në monedha floriri e argjendi të groposura.”

Kushti i dytë: Për monedhat prej floriri e për monedhat prej argjendi, që plotësojnë shumën e nisabit, duhet të kalojë një vit i plotë hënor, pa u pakësuar aspak, pa ndërruar asgjë prej tyre dhe pa i shndërruar në lingota e shufra. Veç kësaj, dihet që viti plotësohet kur hyn muaji i dymbëdhjetë i vitit. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka dyqind dirhemë pa një dirhem dhe kjo shumë ka qëndruar në dorën e tij njëmbëdhjetë muaj. Në muajin e dymbëdhjetë ai mblodhi edhe një dirhem dhe kështu te ai u plotësuan plot dyqind dirhemë. A ka detyrim ky

njeri të japë zekat për këtë shumë në këto kushte? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Jo, derisa mbi të gjithë shumën prej dyqind dirhemësh, të kalojë një vit i plotë hënor.”

Çështje

1- Kur ai ka monedha prej floriri dhe monedha prej argjendi, por asnjëra prej dy llojeve në vetvete nuk e plotëson shumën e nisabit, por kur ai i bashkon dy llojet e monedhave njëra me tjetrën, si total arrihet shuma e nisabit, ai nuk imponohet për bashkimin mes dy llojeve, por merr në konsideratë secilin lloj në veçanti.

2- Për nisabin merret në konsideratë që të jetë i pastër nga mashtrimet dhe jo vetëm të thuhet emri monedhë prej floriri, ose monedhë prej argjendi, sepse, kur një person ka monedha prej floriri e monedha prej argjendi dhe secila prej dy llojeve të monedhave arrin shumën e nisabit, ose edhe më shumë, por ato janë për përzieria edhe me metal tjetër, përveç floririt e argjendit, në këtë gjendje, vlerësimi bëhet duke marrë në konsideratë vetëm floririn e argjendin e pastër. Nëse floriri e argjendi i pastër arrijnë shumën e nisabit, atëherë bëhet detyrim zekati, ndryshe jo.

3- Kur burri dyshon, nëse monedhat që ai disponon e arrijnë apo nuk e arrijnë shumën e nisabit, në këtë rast, është në fuqi baza e mospërgjegjësisë dhe nuk është detyrë të bëhet studim, sepse në një gjendje të këtillë, studimi është prej punëve me dyshim konkret dhe nuk është studim obligues. Natyrisht kur dihet që shuma e nisabit është arritur, por zekathënësi ka dyshim në cilësinë e në peshën e dy llojeve të monedhave, atëherë,

nëse është e mundur, studimi është detyrë, ndryshe është detyrim veprimi me rezervë, sepse dituria për veprim me garanci bën të detyrueshme studimin për shkarkimin e detyrimit, derisa të arrihet dituria e saktë që mundëson daljen prej besëdhenies për plotësimin e obligimit.

4- Fukahatë e këtij shekulli, të gjithë, ose më të dëgjuarit prej tyre, kanë thënë se, kur pasuritë janë të llojit letër, ashtu siç janë në ditët e sotme, për to nuk ka zekat, duke u bazuar në marrjen e fjalëve të tekstit germë për germë, ashtu siç janë shqiptuar dy llojet e monedhave prej floriri e prej argjendi. Por ne jemi në kundërshtim me fjalën e atyre fukahave dhe ne përgjithësojmë çdo gjë që vërtetohet emërtimi pasuri dhe “para”, Duhet të theksohet se në leksikonin e Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*), emri për dy llojet e monedhave është mjet dhe nuk është qëllim në vetvete, sepse në atë kohë, ato ishin monedhat e vetme në përdorim, prandaj analogjia me llojet e tjera të monedhave nuk është haram, sepse analogjia merret në kuptimin e saj të vërtetë, kur shpjegimi i nxjerrë të jetë nga mundësia dhe jo nga dituria, sepse mundësia nuk shërben si argument për të nxjerrë të vërtetën.

Veç kësaj, ne e dimë fare mirë se pengesa për zekatin në dy llojet e monedhave gjendet te vetë paratë letër dhe jo në mundësinë, prandaj është si pengesa e ardhur në tekstet, madje është edhe më e fuqishme. Atëherë kjo çështje duhet të merret nga ana e përzgjedhjes së njohur dhe jo nga ana e mundësisë për qenien haram të veprimit sipas këtij rregulli.

* * *

ZEKATI I PRODHIMEVE KOKRRA

Më sipër thamë se zekati është detyrim të jepet për grurin, elbin, hurmat dhe rrushin e thatë. Gjithashtu, zekati është mustehab të jepet edhe për gjithçka që mbin prej tokës, me përjashtim të zarzavateve e bishtajoreve të thata. U tha se zekati për katër kategoritë e prodhimeve të lartpërmendura, është detyrim, kur për ato ekzistojnë dy faktorë, arritja e nisabit dhe prona.

Nisabi

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Për prodhimet që mbijnë prej tokës: grurë, elb, hurma e rrush i thatë, zekati për këto prodhime jepet, kur ato arrijnë në pesë “usek”. Një usek është i barabartë me gjashtëdhjetë “saun”, që bëjnë treqind saë. Për këtë sasi jepet zekat një e dhjeta. Për bimët që janë rritur me ujitje artificiale, domethënë me vaditje me kova e me pompa, etj, zekati është gjysma e një të dhjetës. Për bimët që janë vaditur nga shiu e me vaditje me ujë të rrjedhshëm, ose kur bimët e pemët janë vaditur

vetëm prej shiut, për këto zekati është i plotë, një e dhjeta. Për më pak se treqind saë nuk jepet zekat, gjithashtu, përveç katër llojeve të prodhimeve të lartpërmendura, për prodhimet e tjera të tokës, nuk jepet zekat.

Llogaritur në kilogram, nisabi i plotë për katër prodhimet e tokës është afërsisht nëntëqind e dhjetë kilogram. Për më pak se kjo sasi, nuk jepet zekat, kurse për më shumë se nisabi, patjetër që jepet zekat.

Prona

Fukahatë kanë thënë: “Njeriu e ka detyrim të japë zekatin për këto katër prodhime, kur ato arrijnë masën e nisabit dhe, në të njëjtën kohë, këto prodhime duhet të jenë në pronësi të zekatdhënësit dhe pastaj ato kanë lidhje me zekatin, qoftë zekatdhënësi bujku që ka punuar tokën e ka hedhur farën, qoftë ai që ka mbjellë pemën. Gjithashtu, ai ka detyrim të japë zekatin edhe kur të mbjellat kanë kaluar në pronësi të tij para se të lidhin kokërr, ose pema para se të mbushet me fruta. Për sa i përket atij që i ble të mbjellat, ose ato i dhurohen atij, pasi prodhimi është bërë i dukshëm, në atë mënyrë që ky prodhim është në pronësi të një tjetri dhe jo në pronësi të tij, mbi këtë person nuk është detyrim të japë zekat për këto prodhime. Gjithashtu, me konsensusin e fukahave, nuk është detyrim të japë zekat personi që ble rrush dhe e vë në diell të thahet, derisa ai bëhet rrush i thatë.”

Fukahatë më të përmendur janë shprehur se zekati për grurin, elbin, hurmat e rrushin e thatë, është i varur nga koha, kur

në këto të mbjella fillon të duket prodhimi, domethënë kur kokrrat forcohen e lidhen në kallinjtë e grurit e të elbit, ose kur fruta e hurmës skuqet e zverdhet në pemën e hurmës, si dhe kur te hardhitë formohet i plotë bistaku i rrushit, duke ditur se zekati për rrushin e thatë jepet vetëm, pasi rrushi të thahet deri në fund.

Ajo që ne konstatojmë nga ky shpjegim, është fakti se zekati nuk ka asnjë lidhje me të lashtat e drufrutorët, derisa kokrra e tyre të marrë emrin grurë, elb, hurmë ose stafidhe, sepse pikërisht këto emërtime kanë ardhur si argumente në dispozitat e ligjit të fesë në lidhje me zekatin për këto prodhime. Dihet se emërtimet në dispozitat e ligjit të fesë janë vënë në kuadrin e titujve të subjekteve të këtyre prodhimeve, janë ose kur nuk janë ato. Sido që të jetë, nisabi konsiderohet vetëm kur ato kanë arritur stadin e tharjes dhe jo para tharjes. Sikur të supozohet që njëri prej këtyre llojeve ka arritur masën e nisabit, duke qenë akoma i butë, në të vërtetë, nisabi për këtë lloj nuk është arritur dhe me konsensusin e fukahave, për prodhimin e këtij lloji, në këtë stad, nuk ka zekat.

Togfjalëshi “fryt i arrirë” bëhet i qartë mes dy thënieve: Kur pronari i frytit të hardhisë vepron me atë, para se rrushi të bëhet stafidhe dhe frytin e hurmës, pasa se ajo të bëhet hurmë, ose para se të vijë koha e korrjes së të lashtave. Sipas fjalës më në zë, rezulton se pronari i këtyre prodhimeve është garantues për të varfrit që meritojnë të marrin zekatin. Fjala e dytë tregon se ai nuk mund të jetë garantues për prodhimin që do të marrë.

Sasia e zekatit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Për prodhimet që vaditen në mënyrë artificiale, me litar, me kovë e me pompë, zekati për këto lloje prodhimesh është gjysma e një të dhjetës, kurse për prodhimet që vaditen me ujin e lumit, me ujin e burimit, ose me ujë shiu, ose me ujë të rrjedhshëm, zekati për këto lloje prodhimesh është një e dhjeta e plotë.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Sasia e detyrimit për dhënien e zekatit ndryshon sipas ndryshimit të mënyrës së vaditjes. Për prodhimet që i vadit natyra, zekati është një e dhjeta e prodhimit të marrë; për prodhimet që vaditen me mjete, zekati për to është gjysma e një të dhjetës. Kur prodhimet herë vaditen me mjete dhe herë i vadit qielli, atëherë çështja shikohet: Në qoftë se në shumicën e herëve nuk është nevoja të përdoret vaditja me mjete, atëherë zekati është një e dhjeta e prodhimit. Në qoftë se në shumicën e herëve për vaditje janë përdorur mjetet, zekati është gjysma e një të dhjetës. Kur dy mënyrat e vaditjes janë të barabarta, atëherë zekati është tre të katërtat e dhjetës, domethënë gjysma e një të dhjetës për njërën mënyrë vaditje pa mjete dhe një e katërta e dhjetës, për mënyrën e vaditjes me mjete, por gjithnjë mbetet dyshimi se cila prej dy mënyrave të vaditjes ka qenë dominuese: ka qenë mënyra e vaditjes me mjete, apo mënyra e vaditjes natyrale.

Në këto raste, do të kufizohemi të vendosim për sasinë më të vërtetuar, për sasinë më të paktë të detyrimit, domethënë

gjysma e një të dhjetës së prodhimit, sepse kjo sasi, në të gjitha gjendjet, mbetet detyrim.

Ushqimi dhe pjesa e pushtetit

Në të vërtetë, zekati jepet vetëm pas pastrimit të të lashtave dhe pas tharjes së frutave, sepse vetëm atëherë mund të disiplinohet matja e peshimi. Përveç kësaj, llogaritja për dhënien e zekatit bëhet vetëm, pasi është ndarë pjesa e pushtetit, si dhe pjesa e plotë për ushqimin e për shpenzimet, domethënë që pronari nuk jep zekat për këto pjesë prej mallit të tij, sepse zekati llogaritet në totalin e prodhimit të marrë.

Në lidhje me këtë çështje, nuk është nevoja as për studime të gjata, as për çka është thënë e thuhet e as për të nxirë sa më shumë faqe, ashtu siç kanë vepruar jo pak vetë, sepse fjala reduktohet në: A duhet të merret në konsideratë nisabi, pas heqjes së pjesës për plotësimin e nevojave dhe pas heqjes së pjesës që merr pushteti, në qoftë se pjesa e mbetur pas ndarjes së dy pjesëve të lartpërmendura, rezulton më pak se sasia e nisabit, a mbetet mbi këtë person detyrimi për të dhënë zekatin e këtij prodhimi? Apo nisabi të konsiderohet i plotësuar para ndarjes së dy pjesëve? Apo kur nisabi plotësohet për totalin, detyrimi për dhënien e zekatit mbetet edhe për pjesën e mbetur, qoftë edhe kur nisabi pas ndarjes së dy pjesëve pakësohet, apo si total vazhdon të mbetet nisab?

Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Thënia më e përhapur ndër fukahatë është: Nisabi duhet vënë në konsideratë pas heqjes së sasisë për nevojat dhe, kur pjesa e mbetur nuk e

arrin masën e nisabit, për këtë sasi të mbetur nuk jepet zekat, edhe kur si total prodhimi ishte në masën e nisabit.

Shejkh El Hemedànij, në librin “Misbàhul Fakijh”, ka thënë: “Kjo është çështja më e dyshimtë, për shkak se në orgjinë qëndron mosmbajtja e përgjegjësisë për kryerjen e detyrimit për dhënien e zekatit për atë pjesë që pakësohet pas heqjes së pjesës për nevojat e të pjesës së pushtetit.”

A është zekati e drejtë e njeriut, apo është ortakëri në pasuritë konkrete?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Allahu i Lartësuar i ka bërë të pasurit e të varfrit ortakë në pasuritë dhe për këtë ata nuk kanë të drejtë të shpenzojnë gjatë përveçse për ortakët e tyre.”

Babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për zekatin që është detyrim të jepet në ato vende ku unë s’ka mundësi të jepet aty. Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha pyetësit: “Ndaje veç pjesën e zekatit dhe, nëse me këtë pjesë ti bën tregti, përsëri je ti garantuesi për këtë pjesë, sepse për këtë pjesë ka edhe fitim. Në qoftë se ti e merr në dorë këtë pjesë në kohën kur e veçove, pa e përdorur për tregti, atëherë mbi ty nuk mbetet asnjë detyrim. Në qoftë se nuk e veçon këtë pjesë dhe me të bën tregti në totalin e pasurisë që ke, ajo ka pjesën e vet të fitimit, prandaj edhe kjo pjesë e fitimit nuk mund të humbet.”

Fukahatë

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse i varfëri është ortak me të pasurin, në një sasi të caktuar dhe ka prej saj të njëjtën pjesë që ka edhe i pasuri, ose nëse i varfëri është proanr i të drejtës në pasurinë konkrete, pa zotëruar asgjë prej saj, ashtu siç është pronar i mallit të lënë peng, e drejta e të cilit varet me të drejtën e tij në mallin e lënë peng, pa qenë realisht zotërues i atij malli.

Gjithashtu, fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse i pasuri është përgjegjës për zekatin ndaj të varfrit, ashtu siç është përgjegjës pronari i mallit për zotëruesin e mallit peng.

Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Fukahatë më të dëgjuar pohojnë... (citon thëniet e fukahave më të dëgjuar)

Më pas thekson rezultatet e arritura në hulumtimet e tij: “Zekati është i lidhur me pasurinë konkrete, prandaj i varfëri është ortak me të pasurin në pasurinë konkrete. Ai zotëron në atë pasuri të njëjtën masë e sasi që zotëron edhe i pasuri.”

Këtë thënie fukahatë e kanë kanë argumentuar prej dy transmetimeve të mësipërme, të ardhura prej dy Imamëve (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*)

Ne jemi në anën e shejkh El Hemedànij, autor i librit “Misbàhul Fakijh”, i cili e mohon ortakërinë e të varfërve në pasuritë konkrete të të pasurve, duke vërtetuar të drejtën e të varfërve në pasurinë e të pasurve, plotësisht ashtu siç është e drejta e borxhlinjve të të vdekurit në trashëgiminë e lënë prej tij. Ne arritëm të jemi me mendimin e këtij shehu të nderuar, pasi studiuam dhe u bindëm prej argumenteve që ai sjell dhe prej të

cilave ka nxjerrë mendimin e vet. Argumentet e këtij shehu mund të përmbliidhen si më poshtë:

E para: Sikur i varfëri të ishte realisht ortak me të pasurin, në pasurinë konkrete të tij, nuk mund të ishte e lejuar për të pasurin që ai të vepronte me këtë pasuri pa lejen e të varfrit, ashtu siç është çështja ndërmjet dy ortakëve. Gjithashtu, për të pasurin nuk mund të ishte e lejuar që ai të jepte zekatin prej një pasurie tjetër konkrete, pa qenë i kënaqur me këtë vendim edhe i varfëri. Gjithashtu, ortakëria mes të dyve do të ishte edhe në rritjen e nënprodukteve, si në qumështin e në leshin, sepse nënproduktet ndjekin origjinën nga dalin. Askush nuk ka thënë ndonjë fjalë kundër këtij pohimi dhe, kush pretendon diçka në këtë pasuri, pretendimi i tij është i mohuar me tekst e me praktikën e prerë të Imamëve.

E dyta: Gjuha e transmetimeve të ardhura prej Ehli Bejtit, në lidhje me zekatin farz, është plotësisht si gjuha e transmetimeve të ardhura në lidhje me zekatin mustehab, duke ditur se në zekatin mustehab nuk ka ortakëri të vërtetë. Atëherë, qëllimi me këtë ortakëri qëndron në atë që Allahu i Gjithëpushtetshëm të drejtën e të varfërve në pasuritë e të pasurve e ka bërë si e drejta e borxhlinjve të vdekuri, që është e lidhur me trashëgiminë e tij, në atë mënyrë që, kur të pasurit nuk e kryejnë këtë të drejtë, atëherë është gjykatësi ligjor, ose tagrambledhësi i emëruar prej gjykatësit ligjor, ose vetë myslimanët duhet të heqin dorë prej kësaj të drejte, duke shpresuar depozitim të shpërblimit të Allahut i Lartësuar, ose vetë i varfëri heq dorë prej kësaj të drejte. Por kur mungojnë të gjithë faktorët e sipërpërmendur, atëherë i varfëri do të kishte të drejtë ta merrte me forcë këtë të drejtë prej të pasurve. Thënia se i varfëri është

ortak në pasurinë konkrete të të pasurit është një gjë dhe realiteti është një gjë tjetër.

Mallrat e tregtisë

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për mallrat që tregton një burrë. A jep zekat për këto mallra? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Kur ato të mbushin një vit hënor në dorën e tij, le të japë zekatin për ato mallra.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Çdo mall me të cilin ti punon, ke detyrim që për atë mall të japësh zekat, me kusht që të ketë kaluar një vit hënor që malli është në dorën tënde.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Çdo mall, me të cilin punohet me qëllim fitimi dhe tregtimi, është mustehab që për atë mall të jepet zekat dhe, është e barabartë, qoftë kur tregtohen kafshë, qoftë kur tregtohen drithëra, metale, tekstile, zarzavate, apo bishtajore të thata, ose mallra të tjerë.

Zekati për mallrat që tregtohen, është mustehab vetëm me disa kushte dhe, kur mungon ndonjëri prej kushteve, atëherë nuk ka më dhënie zekati mustehab.

Kushtet janë: qëllimi të jetë për tregtim e për fitim, vlera e realizuar prej tregtisë të arrijë shumën e nisabit në njërën prej dy

llojeve të monedhave (monedhave prej floriri dhe monedhave prej argjendi), mbi fitimin të kalojë një vit i plotë hënor, që është në dorën e zotëruesit, qëllimi i fitimit me mallin e dhënë të jetë i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit hënor, fitimi të mos shitet më pak se kapitali, nga kapitali të mos mungojë as edhe një grosh i vetëm gjatë gjithë ditëve të vitit hënor. Sikur të supozohet se kapitali u pakësua dhe pastaj u plotësua përsëri, numërimi i fillimit të vitit do të fillojë që nga ky çast.

Gjithashtu, është mustehab të jepet zekat për çdo prodhim të tokës që matet e peshohet, me përjashtim të katër llojeve të prodhimeve kokrra të lartpërmendura. Gjithashtu, jepet zekat për kuajt femra, me kusht që ato të ushqehen në kullotë dhe jo të ushqehen në stallë, edhe nëse ato përdoren për hipje e për punë të tjera. Është mustehab të jepet zekat për të ardhurat e realizuara prej pasurive të ngurtësuara të përgatitura për investime, siç janë dyqani, kopshti etj, për të cilat është folur më sipër.

* * *

ATA QË KANË TË DREJTË TË MARRIN

ZEKAT

Në fillim të kapitullit “Zekati” kemi shpjeguar se kush ka detyrim të japë zekat, për çfarë lloje pasurish jepet zekati dhe cilët kanë të drejtë të marrin zekat. Deri tani kemi trajtuar vetëm dy çështjet e para dhe tani na mbetet të trajtojmë edhe çështjen e tretë.

Ata që kanë të drejtë të marrin zekat

Allahu i Lartësuar urdhëron e thotë në Librin e Tij të nderuar:

”إِنَّمَا الصَّدَقَاتُ لِلْفُقَرَاءِ وَالْمَسْكِينِ وَالْعَامِلِينَ عَلَيْهَا وَالْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ وَفِي الرِّقَابِ وَالْغَارِمِينَ وَفِي سَبِيلِ اللَّهِ
وَابْنِ السَّبِيلِ ۚ فَرِيضَةٌ مِّنَ اللَّهِ ۚ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ“

“Zekati u takon të varfërve, atyre që s’kanë asgjë (të mjeruarve), mbledhësve të zekatit, atyre që u duhen përfituar zemrat, për lirimin e robërve, të zhyturit në borxhe, ai që lufton në rrugën e Allahut dhe ai që ka mbetur në rrugë, kjo është detyrim prej

Allahut dhe vetëm Ai punon sipas urtësisë së Tij. ("Sure Et Teubeh", ajeti 60)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Të varfër janë ata që nuk shtrijnë dorën të lypin, megjithëse kanë në ngarkim të ushqejnë njerëzit e familjes." Argumenti për ata që nuk lypin është fjala e lartë e Allahut:

“لِلْفُقَرَاءِ الَّذِينَ أَحْصَرُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ لَا يَسْتَطِيعُونَ ضَرْبًا فِي الْأَرْضِ يَحْسَبُهُمُ الْجَاهِلُ أَغْنِيَاءَ مِنَ التَّعَفُّفِ عَنْهُمْ
بِسَيِّئَاتِهِمْ لَا يَسْأَلُونَ النَّاسَ إِحْفَافًا...”

"Për të varfrit që nuk kanë mundësi të lëvizin nëpër tokë, nga që janë të angazhuar në rrugën e Allahut, por ata kanë turp të lypin, prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre, mendon se ata janë të pasur, megjithëse ata njihen nga pamja e tyre e jashtme..."
("Sure El Bekare", ajeti 273)

Në termat e ajetit: "ata që s'kanë asgjë" (el mesàkijn), hyjnë burra, gra e fëmijë; "mbledhësit e zekatit", janë punonjësit që mbledhin dhe e ruajnë zekatin për t'ia dorëzuar personit të autorizuar për ndarjen e zekatit;

"atyre që i duhen përfituar zemrat", janë ata që kanë pranuar se Allahu është Një e i Vetëm dhe që kanë hequr dorë nga adhurimi i idhujve, por në zemrat e tyre akoma nuk është rrënjësuar mirë se Muhamedi (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është i Dërguari i Allahut dhe për këtë shkak është caktuar pjesë prej zekatit edhe për këtë kategori, me qëllim që ata të mësohen dhe të nxiten për të mësuar fenë;

"për lirim të robërve", përveç robërve hyjnë edhe personat që kanë detyrim të bëjnë shlyerje (kef'fàret) për vrasje gabimisht,

ose kur burri i thotë gruas të kam në vend të nënës (edh dhihàr), ose për thyerjen e betimit, ose për gjahun e vrarë në zonën e xhamisë së Mekës. Kur këta persona nuk kanë me se të bëjnë shlyerjen, sepse janë besimtarë, Allahu, edhe për këta, ka bërë pjesë në zekatin, me qëllim që me zekatin që marrin, të kryejnë shlyerjen;

“të zhyturit në borxhe”, janë ata që kanë marrë borxhe dhe i kanë shpenzuar pa asnjë shpërdorim, në bindje të urdhrave të Allahut. Prandaj është detyrë e Imamit që të lajë borxhet për këtë kategori njerëzish prej pasurive të grumbulluar prej zekatit;

“atij që lufton në rrugën e Allahut”, janë ata që kanë dalë të luftojnë në rrugën e Allahut, por nuk kanë pasuri që të përballojnë shpenzimet për luftën, ose janë prej atyre që nuk kanë para që të plotësojnë detyrimin për të shkuar në Haxh, ose nuk kanë për të kryer punë të mira. Prandaj Imami ka detyrë t’i japë prej pasurive të zekatit edhe kësaj kategorie njerëzish, me qëllim që edhe ata të kenë mundësi të kryejnë Haxh e të dalin për të luftuar në rrugën e Allahut;

“atij që ka mbetur në rrugë”, janë ata që ndërmarrin udhëtime në bindje të urdhrit të Allahut, por ata ndalohen në rrugë e mbesin pa asnjë pasuri. Prandaj Imami ka detyrë që këtë kategori ta rikthejë në vendin e tij me shpenzimet e marra prej pasurive të zekatit.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Ata që meritojnë të marrin zekat, janë tetë kategori: 1) të varfrit; 2) ata që s’kanë asgjë (të mjeruarit); 3) mbledhësit e zekatit; 4) atyre që u duhen fituar zemrat; 5) për lirim e robërve; 6) të zhyturit në borxhe; 7) luftëtarët në rrugën e Allahut dhe 8) ata që kanë mbetur në rrugë.

Të varfrit e të mjeruarit

Një grup fukahash kanë thënë se fjala i varfër dhe fjala i mjeruar, të marra së bashku, secila shpreh një kuptim. Edhe kur i marrin të veçuara, përsëri shprehin të njëjtin kuptim. Prandaj fukahatë kanë thënë se diferenca, kur i marrin të dy kategoritë së bashku qëndron në faktin se i varfëri nuk lyp, kurse i mjeruari lyp. Sido që të jetë, nuk ka kuptim të kapemi pas fjalëve, kur e dimë se qoftë i varfëri, qoftë i mjeruari kanë të drejtë të marrin zekat, sepse kanë nevojë të marrin.

I varfëri ose i mjeruari, të cilit në ligjin e fesë lejohet t’i jepet prej zekatit, është ai që nuk përballon nevojat për ushqim për vete e për njerëzit e familjes që ka në ngarkim, kurse i pasuri, në ligjin e fesë, është ai që konkretisht ka mjaftueshëm ushqim për vete e për familjen e tij, ose e ka në saje të fuqisë së tij, domethënë që ai ka një punë me të cilën përballon nevojat ditë për ditë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Zekati është haram për atë që ka ushqim për një vit, por atij mund t’i jepet sadakaja e fitrit, edhe pse disponon ushqimin për një vit.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) nëse duhet të pranojë zekatin ai që ka ushqimin për një ditë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “E merr, ai merr zekat, edhe kur ka ushqim për një muaj, madje merr prej zekatit, aq sa i mjafton për ushqimin e një viti, sepse, në të vërtetë, zekati është një herë të çdo kryeviti.”

Pasurimi i të varfrit

Autori i librit “El Hadàik” dhe i librit “El Xheuàhir” kanë cituar prej fukahave më të dëgjuar se lejohet t’i jepet të varfrit prej zekatit, aq sa e bën të varfrin të pasur dhe që i mjafton për disa vite dhe jo vetëm për një vit, me kusht që kjo shumë t’i jepet njëherësh dhe jo pjesë-pjesë, sepse duke ia dhënë me pjesë, në fakt, atij i jepet ushqim vetëm për një vit. Në këndvështrimin e ligjit të fesë, me mënyrën e dhënies njëherësh, i varfëri pasurohet, prandaj ndalohet t’i jepet atij zekat për herë të dytë. Ata që janë shprehur për dhënien e zekatit sipas kësaj mënyre, i kanë nxjerrë argumentet prej transmetimeve të ardhura prej Ehli Bejt (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!).

Por unë nuk e di, nëse ato transmetime janë të sakta, apo ato janë të vëna në gojën e përcjellësve të besueshëm prej dikujt që ka dashur të tërheqë zjarrin në vatrën e vet, apo që pasuritë e zekatit të jenë thesar për llogari të ndonjë tjetri. Ajo që unë e di shumë mirë dhe për të cilën jam thellësisht i vetëdijshëm, është fakti se çështja e pjesëtimit të dhënies së njëhershme në disa dhënie, ka vend që duhet shikuar, sepse, pengesa për moslejimin e dhënies pjesë-pjesë, në të vërtetë, është dhënie më shumë se

nevojat për një vit. Por kjo pengesë, në vetvete, gjendet në dhënien më shumë se plotësimi i nevojave të lartpërmendura, atëherë diferenca duhet të gjykohet. Gjithashtu, unë e di mirë dhe jam plotësisht i vetëdijshëm se qëllimi i parë e i fundit i dhënies së zekatit, është që i varfëri të plotësojë nevojat për ushqim, pije, veshje e banesë.

Unë e di mirë se Ehli Bejti (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*) ka thënë: “Sikur zekati të ndahej ashtu siç duhet ndarë, nuk do të gjendej asnjë i varfër, por dihet se bërja e të varfrit të pasur do të shtonte numrin e të pasurve, kurse të varfrit do t’i bënte edhe më të varfër.”

Për të gjitha këto, ne mendojmë që të varfrit të mos i jepet më shumë nga sa atij i mjafton për plotësimin e nevojave vetëm për vit, qoftë edhe kur si pikë referimi për dhënien më shumë është një i madh, ose vetë më i madhi ndër të mëdhenjtë ai që e ka thënë këtë fjalë.

Ai që pretendon, se është i varfër

Kushdo që pretendon, se është i varfër, atij i jepet zekat, kur dihet se ai nuk gënjen. Atij i jepet prej zekatit aq sa plotëson nevojat e veta. Autori i librit “El Xheuàhir” ka shtuar: “Nuk ka asnjë kundërshtim që mund të atakojë atë.” Gjithashtu, në librin “El Medàrik” thotë: “Kjo është e njohur prej medh’hebit të fukahave.”

Prej biografisë së dijetarëve të fesë, të mëparshëm e të mëvonshëm, mësohet se ata i jepnin zekat atij që e lypte zekatin,

edhe kur ata e dinin se ai gënjente. Hadithi i njohur: “Pretenduesi ka detyrë të sjellë argumente dhe ai që mohon, ka detyrë të betohet.”, nuk e përfshin çështjen që po trajtojmë, sepse hadithi është specifik për çështjet me karakter konfliktesh e grindjesh.

Nuk është detyrim që i varfëri të njoftohet për zukatin, as kur atij i jepet e as pas dhënies. Ebu Besijri tregon: “I thashë Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*), babait të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Njëri prej shokëve tanë ka turp të marrë zekat, prandaj a t’ia jap atij zekatin dhe të mos i them se kjo që të jap është zekat?” Ai m’u përgjigj: “Jepi atij dhe mos i thuaj se është zekat, as mos e poshtëro besimtarin.”

Shumica e fukahave janë shprehur se atij që ka fuqi të fitojë, nuk i jepet zekat, sepse ai hyn në dispozitën e të pasurit. Transmetohet prej Zerareh se Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nuk e ka hallall të marrë zekat as profesionisti dhe as ai që fizikisht është i shëndetshëm e që ka mundësi ta përballojë punën e lodhjen.”

Nëse dikush thotë se për këtë person është e drejtë të quhet i varfër, ne i përgjigjemi: Në fakt ai është i pasur, derisa është i fuqishëm ta mbajë veten. Prandaj, cili është dallimi mes këtij njeriu dhe atij që ka pasuri, por nga koprracia nuk shpenzon asgjë për vete, derisa vdes i uritur?

Autori i librit “Misbàhul Fakijh”, i ka dhënë përgjigjen më të bukur autorit të librit “El Xheuàhir” në lidhje me këtë çështje: “Qëllimi me të pasurin, të cilit nuk i jepet zekat, në fakt, ai është i pasur, sepse është i fuqishëm për të fituar dhe ka mundësi të bëjë

punë të ndryshme, megjithëkëtë ai rri pa punë si shumë të tjerë të papunë.”

Edhe lypësit e të ngjashmit me lypësit që kanë fuqi të punojnë në mjeshtri e profesione të ndryshme të përshtatshme me gjendjen e tyre, por ata janë mësuar të jetojnë, duke marrë zekat e sadaka dhe për këtë lënë rrugët e fitimit dhe durojnë varfërinë e privacionin, madje ata, për të marrë zekatin, arrijnë deri aty sa preferojnë të përballojnë edhe poshtërimin e lypjes.

Një personi të këtillë, në traditën e zakonshme, i thuhet i varfër, kurse, në të vërtetë, ai është i pasur, për faktin se ai mund të mjaftohet me punën e tij. Prandaj thënia për mosdhënien e zekatit për këtë kategori njerëzish, është thënia më e përhapur e më e fuqishme. Për sa i përket thënies që përmendet në librin “El Xhevàhir” dhe për të cilën pretendohet se është nga praktika e jetëshkrimit të Ehli Bejt (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!) për t’i dhënë zekat edhe këtyre njerëzve, është një thënie që le shumë vend për të shikuar, madje edhe për të mos u dhënë atyre asgjë prej zekatit.

Punonjësit në sektorin e zekatit

3- Punonjësit e sektorit të zekatit janë personat e ngarkuar për mbledhjen e zekatit, të emëruar prej Imamit, ose prej zëvendësit të Imamit, që të kryejnë mbledhjen e zekatit prej atyre që e kanë detyrim të japin zekat. Gjithashtu, ata kanë detyrë ta ruajnë zekatin e mbledhur dhe pastaj ta dorëzojnë atë në dorën e të ngarkuarit për shpërndarjen e zekatit te ata që kanë të drejtë të marrin zekat. Pjesa që marrin mbledhësit e zekatit, konsiderohet

rrogë për ata, për punën që kryejnë dhe nuk konsiderohet se ata marrin zekat. Prandaj punonjësve të sektorit të zekatit u jepet prej pasurive të zekatit, edhe nëse ata janë të pasur.

Është kusht që mbledhësi i zekatit të jetë i rritur, i mençur, të jetë besimtar dhe njeri i drejtë, ose më e pakta, të jetë besnik dhe njeri i besueshëm. Prijësi i besimtarëve, Imami Aliu (*Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi të!*), për mbledhësin e zekatit, ka thënë: “Kur të shtiesh në dorë pasuri të zekatit, mos ngarko me këtë detyrë askënd përveç atij që këshillon, që është i mëshirshëm, që është besnik dhe di si ruhet kjo pasuri e mbledhur.”

Gjithashtu, mbledhësi i zekatit të mos jetë prej fisit Hashimi, sepse hashimitë e kanë haram të marrin zekatin e marrë prej një johashimiu.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: Disa prej fisit Hashimi shkuan te i Dërguari Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe i kërkuan që t’i emëronte ata për mbledhjen e zekatit të kafshëve shtëpiake. Ata i thanë: “Kështu që edhe ne do të kemi pjesë në atë që Allahu e ka bërë për punonjësit e mbledhjes e të ruajtjes së zekatit. Madje ne e meritojmë më shumë se të tjerët këtë detyrë.”

Profeti (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha atyre: “O bij të Abdul Mut’alibit, zekati nuk është hallall as për mua e as për ju, por mua më është premtuar ndërmjetësimi, domethënë që zekati nuk është hallall për bijtë e Abdul Mut’alibit, qoftë edhe kundrejt lodhjes së tyre.”

Atyre që u duhet fituar zemra

4- Prej kategorive që u duhet fituar zemra, janë ato grupe që duhet të bashkohen rreth Islamit, për të mënjanuar të keqen që mund të vijë prej tyre, ose që me ta të mbrohen myslimanët dhe Islami. Prandaj këtyre grupeve, me qëllim që t'u fitohet zemra, u jepet prej zekatit, edhe në qoftë se ata janë të pasur.

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me fjalën “duhet të fitohet” në kapitullin e zekatit, vallë është për personin për të cilin Islami nuk është bërë i qartë, apo përfshin edhe personin për të cilin Islami është bërë i qartë, por që vazhdon të ketë dyshime për Islamit? Është vërtetuar se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka dhënë zekat për të fituar zemrat e idhujtarëve, ndër të cilët Safvan bin Umej'jeh, ashtu siç ka dhënë zekat edhe për të fituar zemrat e hipokritëve (munafikijn), ndër të cilët edhe Ebu Sufjanit. Në lidhje me këtë çështje, ka transmetime të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*). Nga ky shpjegim, rezulton se fjala është e përgjithshme për të dyja kategoritë.

Në disa medh'hebe islame kjo kategori përfituesish ka rënë, sepse, pas përhapjes së Islamit, nuk ka mbetur më vend për të përfituar zemrat e tyre me anë të zekatit, pasi Allahu e forcoi fenë e Tij me forcën e myslimanëve e me shtimin e numrit të tyre. Fukahatë e shi'ave kanë thënë: “Jo. Kjo kategori përfituesish mbetet, derisa në tokë ka edhe njerëz të tjerë përveç myslimanëve, ose edhe kundërshtarë të Islamit. Prandaj është e pamundur të

bjerë shkaktari, kur qëndron vetë shkaku dhe të hiqet efekti, kur është fetë sëmundja.”¹

Për lirimin e robërve

5- Dispozita për shpenzimin e zekatit për lirimin e robërve, në Kur’anin Famëlartë ka ardhur me fjalën “firr’rrikàb”. Qëllimi me këtë fjalë janë robërit, por duhet të theksohet, se në ajetin e nderuar kjo fjalë ka ardhur e shoqëruar me parafjalën “fij”, çka tregon se zekati nuk u jepet robërve, por shpenzohet për lirimin e tyre prej robërisë dhe për shpëtimin e tyre prej gjendjes së skllavërisë. Kjo dispozitë është ndër masat që ndërmori Islami për të zhdukur skllavërinë hap pas hapi, derisa në ditët e sotme nuk ka më vend të bëhet fjalë për këtë kategori njerëzish, për të cilët duhet të shpenzohet prej pasurive të zekatit.

Të zhyturit të borxhe

6- Janë personat që kanë borxh, por s’kanë mundësi ta shlyejnë atë që kanë marrë, prandaj kësaj kategorie i jepet prej zekatit, me kusht që ata të mos i kenë shpenzuar paratë e marra borxh në mëkate e në punë jo të denja.

Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) ka thënë: “Të zhyturit në borxhe janë ata që kanë shumë borxhe dhe që shumat e marra borxh i kanë shpenzuar në bindje të urdhrit të Allahut të Lartësuar

¹ “Fitimi i zemrave” është i ngjashëm me propagandat që bëjnë shtetet për të justifikuar qëndrimet e veta dhe për të përhapur parimet e tyre, madje për këtë qëllim kanë edhe ministri të specializuara.

pa asnjë shpërdorim, prandaj është detyrë e Imamit të japë prej pasurive të zekatit, me qëllim që të shlyejë borxhet e kësaj kategorie dhe të çlirohen prej detyrimit për shlyerjen e borxhit.”

Kur një njeri ka borxhe dhe nuk ka mundësi të mbajë fjalën për të shlyer borxhin e marrë, atëherë borxhdhënësi ka të drejtë të llogarisë borxhin si zekat. Me këtë veprim që ai bën, të realizohet në të njëjtën kohë besa e dhënë për shlyerjen e borxhit, si dhe detyrimi që ai ka për dhënien e zekatit. Me fjalë të tjera, me këtë veprim, borxhmarrësi çlirohet nga detyrimi për shlyerjen e borxhit dhe borxhdhënësi kryen detyrimin për dhënien e zekatit. Një burrë e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*): “Unë kam borxhe për të marrë te disa njerëz, por borxhi ka shumë kohë që qëndron i mbyllur te ta, për shkak se ata nuk kanë mundësi të më shlyejnë borxhin e marrë. Njëkohësisht ata janë prej atyre që kanë të drejtë të marrin zekat. A kam të drejtë unë ta lë shumën e borxhit te ata dhe ta llogaris dhënie zekati për ta?”

Imam Sadiku iu përgjigj: “Po.”

Nuk ka dallim në lejimin e llogaritjes së borxhit si dhënie zekati, nëse borxhmarrësi është gjallë ose ka vdekur. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kreditimi i besimtarit është si plaçka e luftës. Nëse ai është në gjendje, të shlyen borxhin që të ka marrë dhe, nëse ai vdes para se të shlyejë borxhin, atëherë këtë shumë t’i llogarite dhënie zekati.”

Në rrugën e Allahut

7- Rrugë e Allahut është çdo punë me të cilën fitohet kënaqësia e Allahut dhe me atë punë synohet afrimi te Allahu, çfarëdo pune qoftë, si për shembull, shtrimi i një rruge, ndërtimi i një institucioni, pastrimi i një rrënimi, ndërtimi i një kanali për ujë, ndërtimi i një xhamie, si dhe punë të tjera prej të cilave kanë dobi njerëzit në tërësi, myslimanë e jomyslimanë.

Shejkh El Hamedànij thotë në librin “Misbàhul Fakijh”, vëllimi. 3, faqe 101: “Rruga e Allahut nuk është vetëm në ato që shpenzohen për shi’at.”

Autori i librit “El Xheuàhir”, në kapitullin “Zekati”, duke trajtuar fjalën e ajetit: “Në rrugën e Allahut”, tekstualisht thotë: “Në rrugën e Allahut”, përfshihet ndërtimi i një kopshti, shkolle, xhamie, botimi i librave shkencorë e libra lutjesh, duke i shpërndarë këto libra falas, me nijetin për të fituar kënaqësinë e Allahut.

Gjithashtu, në fjalën “në rrugën e Allahut”, përfshihet shpenzimi për të martuar beqarët, lënia e pronave vakëf për hir të Allahut, me qëllim që ato të jenë në shërbim të njerëzve. Vlen të theksohet se vakëf mund të lihen bletët, drufrutorët, ose mund të shpenzohet për ndërtimin e burimeve dhe hapjen e puseve, për dërgimin e njerëzve në Haxh, ose dhënia e kontributeve për të kryer vizita, për të ngushëlluar e për të respektuar dijetarët e njerëzit e mirë, për shpëtimin e të dhunuarit nga padrejtësia e dhuna e mizorit, ose për blerjen e armëve që shërbejnë për mbrojtjen e myslimanëve, etj. Nisur nga këto që u thanë, profesori, shehu Xha'fer Kàshif El Gitàul Kebijr, ka thënë: “Kur shpenzohet

për dikë, nuk vihet në konsideratë, as Islami, as besimi (ijmàn), as drejtësia, as varfëria e as të tjera si këto.”, domethënë: Islami nuk është kusht, kur dhënia që i jepet jomyslimanit, ashtu siç theksuam më sipër, pasi edhe kjo dhënie është për interesin e përgjithshëm.

Ai që ka mbetur në rrugë

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Me fjalën “ai që ka mbetur në rrugë”, është qëllimi për ata që udhetojnë në bindje të urdhreve të Allahut, nuk udhetojnë me qëllim që të kryejnë mëkate, por atyre u pritet rruga, u merret edhe pasuria që kanë me vete. Në këto raste, Imami ka detyrë t’i kthejë ata në vendet e veta me shpenzimet e nxjerra prej pasurive të zekatit.

Cilësitë e atyre që kanë të drejtë të marrin zekat

Fukahatë kanë thënë: Është detyrim të plotësohen disa cilësi te ata që marrin zekat:

Prej atyre cilësive janë: të jetë prej shi’ave që respektojnë dymbëdhjetë Imamët. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Mos u jep sadaka e zekat përveçse shokëve tuaj.”

Nuk mendoj se dikush nuk e di sekretin e këtij rregulli, pasi ky zakon është ndjekur që në kohët e hershme, kur çdo grup i ndante të mirat për bijtë e grupit të vet. Madje ky rregull vazhdon edhe në ditët tona, në Perëndim e në Lindje. Në të gjitha

legjislacionet moderne është saktësuar se i huaji nuk trashëgon asgjë prej qytetarit të një vendi, qoftë edhe njeriu më i afërm i tij për shkak të fisit ose për ndonjë shkak tjetër, përveçse kur ligjet e vendit e theksojnë tekstualisht se të huajt e afërm kanë të drejtën e trashëgimisë. Sikur të supozohet se një burrë me shtetësi angleze ka prona në Angli, por djali i tij ka shtetësi franceze, djali francez nuk e trashëgon babain e tij anglez, ose më saktë, nuk trashëgon pasuritë e pronat e tij që gjenden në Angli, vetëm atëherë kur ligji francez shprehet tekstualisht se i huaji ka të drejtë të trashëgojë francezin.

Duhet të theksohet se prej këtij kushti përjashtohen ata që hyjnë në kategorinë e atyre që u duhet fituar zemra, sepse supozohet se ata janë mohues, ose janë hipokritë (munàfikë). Gjithashtu, prej këtij kushti përjashtohen edhe personat që u jepet zekat për motive të interesit të përgjithshëm dhe për plotësimin e nevojave të tyre personale, ose për të mbyllur ndonjë mangësi që ai ka.

Gjithashtu, duhet të theksohet se ky kusht është i veçantë vetëm për zekatin, kurse për sadakanë mustehab jo, pasi sadakaja mustehab lejohet t'i jepet çdo nevojtar, mohues ose besimtar qoftë ai, ashtu siç ka ardhur në hadith: "Për çdo bark ka shpërblim."

Prej atyre cilësive janë: dhënia e zekatit të mos ndihmojë për të bërë mëkate, si për shembull, kur zekatmarrësi e shpenzon zekatin për të bërë mëkate, madje mëkate shumë të rënda. Ky kusht nuk ka nevojë fare për argument, sepse është prej atyre çështjeve, që e kanë argumentin më vete, duke shtuar këtu edhe ato që thamë më sipër, për ata që kanë mbetur në rrugë dhe për të zhyturit në borxhe, ku si argument ishte që udhëtimi e borxhi i tyre të mos ishte me qëllim për të kryer mëkate. Disa fukaha e kanë shtrënguar akoma më shumë dhënien e zekatit dhe kanë

vënë si kusht edhe drejtësinë e zekatmarrësit, por duhet të thuhet se me këtë shtrëngim porta e dhënies së zekatit mbyllet me gur e me baltë.

Prej atyre cilësive janë: personi të cilit i jepet zekat, të mos jetë prej atyre personave për të cilët zekatdhënësi ka detyrim të shpenzojë për ta, siç janë prindërit e gjyshërit, qofshin edhe të brezave të mëparshëm, fëmijët, qofshin, edhe kur janë nipat e stërnipat, apo gruaja.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Pesëve nuk u jepet asgjë prej zekatit: babait, nënës, fëmijës, gruas dhe shërbyesit që ke nën zotërim, sepse të gjithë këta janë të familjes dhe zekatdhënësi ka detyrim të shpenzojë për mbajtjen e tyre.”

Për sa u përket të afërmeve të tjerë, si: vëllai, xhaja, daja, etj, lejohet t’u jepet zekat, madje është mustehab që këtyre t’u jepet zekat, sepse ata që kanë të drejtë të marrin zekatin prej teje, para të tjerëve që për ty janë të largët. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nuk ka sadaka, kur i afërmi është nevojtar.”

Gruaja t’i japë zekatin e pasurisë së vet burrit të saj, kur burri është nevojtar, sepse gruaja nuk ka detyrim të shpenzojë për të mbajtur burrin. Disa fukahë kanë thënë: “Nuk lejohet që burri të shpenzojë për gruan e vet prej pasurisë së zekatit që ai e mori prej asaj, por për këtë thënie nuk ka argument, përveç atij miratimi në të cilin nuk mbështetesh dot për nxjerrjen e dispozitave.

Lejohet për babain të shlyejë borxhin e djalit dhe djali të shlyejë borxhin e babait, ose babai të martojë djalin e djali babain me shumë e zekatit, sepse martesë dhe shlyerja e borxhit nuk është detyrim për të afërmin, pasi detyrimi për të afërmin që ke në ngarkim, është vetëm sigurimi i banesës, i ushqimit dhe i veshjes.

Gjithashtu, lejohet për të dy (babën e djalin) të paguajë zekatin për tjetrin prej pjesës së zekatit që ka marrë si punonjës i mbledhjes së zekatit, sepse këtë pjesë zekati ai e ka marrë si shpërblim kundrejt punës që kryen dhe jo si zekat, madje ai e merr këtë pjesë, edhe nëse është i pasur.

Prej atyre cilësive janë: zekatmarrësi të mos jetë prej fisit Hashimi, sepse hashimive nuk u lejohet t'u jepet zekati i dhënë prej një tjetri që nuk është hashimi, por lejohet që hashimiu të marrë zekat prej një hashimiu tjetër. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për llojin e sadakasë që e kanë haram të marrin hashimitë, se cila ishte kjo sadaka. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: "Është zekati." Pyetësi tha: "Vallë, a është hallall, që ata t'i japin zekat njëri-tjetrit?" Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) u përgjigj: "Po."

Është e kuptueshme se, kur hashimiu, nga nevoja, është i detyruar të marrë zekat prej një tjetri që nuk është hashimi, për shkak se nuk gjen prej një të pestës e as zekat prej ndonjë hashimiu tjetër, me fjalën e përbashkët të fukahave, lejohet që edhe hashimiu, në këtë gjendje, të marrë zekat prej një johashimiu. Gjithashtu, lejohet që hashimiu të marrë sadaka mustehab, cilado qoftë natyra e asaj sadakaje, prej hashimut e prej johashimiut, gjithnjë kur hashimiu ka nevojë tepër të ngutshme për ta marrë këtë zekat ose këtë sadaka, ndryshe do të rrezikonte.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur: "A është hallall të marrin sadaka pjesëtarët e fisit Hashimi?" Ai tha: "Sadakaja detyrim nuk është hallall për ne, kurse për sadakatë jo detyrim, s'ka ndonjë problem."

* * *

DISPOZITAT E ZEKATIT

Nijeti

Zekati nuk vlen, kur nuk jepet me qëllimin e afrimit të Allahu i Gjithëpushtetshëm, sepse zekati është adhurim (ibàdet). Prandaj kush e kryen detyrimin për dhënien e zekatit vetëm për t'u dukur që ka autoritet e për hipokrizi, në të vërtetë, ai e ka bërë zekatin pa asnjë vlerë. Nuk ka ndonjë problem njoftimi për dhënien e zekatit, sidomos kur njoftimi bëhet me qëllim inkurajimi për dhënien e zekatit dhe për të ndjekur shembullin e zekatdhënësit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Sikur një burrë të mbartë në shpinë zekatin dhe ta japë atë sheshit, për këtë veprim ai nuk ka asnjë qortim e asnjë të metë.” Në një transmetim tjetër tregohet se ai ka thënë: “Njoftimi për dhënien e zekatit sheshit është më i mirë se dhënia e tij në fshehtësi.”

Allahu i Lartësuar thotë:

“إِنْ تُبْدُوا الصَّدَقَاتِ فَنِعِمَّا هِيَ ۚ وَإِنْ تُخْفُوهَا وَتُؤْتُوهَا الْفُقَرَاءَ فَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ ۚ...”

“Nëse lëmoshat i jepni haptazi, kjo është mirë, por nëse ato ua jepni të varfërve fshehurazi, kjo është më e mirë për ju...”
 (“Sure El Bekare”, ajeti 271)

S’ka ndërmjetësues mes Allahut e njeriut

Islami, në dallim nga shumë fe të tjera, karakterizohet me cilësinë e tij të veçantë: në Islam nuk ka ndërmjetësues mes Krijuesit e të krijuarit, prandaj çdo njeri ka mundësi të lidhet me Allahun nëpërmjet rrugës së devotshmërisë, me qëllimet e me punët e tij, pa ndërmjetësimin e ndonjë dijetari, apo të ndonjë njeriu të mirë (eulijà). Allahu i Gjithëpushtetshëm, ashtu siç pranon prej robit agjërimin, namazin e Haxhin, pa pohimin e pa miratimin e këtyre adhurimeve prej ndonjë njeriu, po kështu pranon prej robit edhe zekatin, pa ia dhënë atë zekatdhënësi një juristi të fesë, i cili patjetër që i plotëson të gjitha kushtet. Prandaj kush e bën detyrim një veprim të tillë, që të ketë një ndërmjetësues, atij ne i kemi vënë pikëpyetje.

Autori i librit “El Hadàik” ka thënë: “Fukahatë më të dëgjuar, sidomos fukahatë e mëvonshëm, janë shprehur për lejimin e shpërndarjes së zekatit prej vetë atij që ka detyrim të japë zekatin, ose edhe prej të ngarkuarit prej tij. Këtë pohim ata e bëjnë duke u bazuar në tërësinë e transmetimeve të përmendura për temat që kemi kaluar dhe për ato që do të vijjnë, pasi ato janë transmetime të ardhura prej Ehli Bejt (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!).

Gjithashtu, ata janë mbështetur te njoftimet për urdhrin e çuarjes së zekatit te ata që kanë të drejtë të marrin zekat, por janë

mbështetur edhe te njoftimet që flasin për transferimin e zekatit prej një vendi në një vend tjetër, kur në vendin e zekatdhënësit nuk gjenden të atillë që kanë të drejtë të marrin zekat, pa përjashtuar njoftimet që flasin për blerjen e robërve, me qëllim lirimin e tyre prej robërisë me pasuritë e zekatit, ashtu siç janë mbështetur edhe në shumë njoftime të tjera, që shpesh edhe janë përsëritur.”

Në vijim, autori i librit “El Hadàik” thotë: “Në ndihmë të asaj që thamë më sipër, flet edhe transmetimi që tregon historinë e një burri që shkoi te Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i tha: “Allahu të mëshiroftë! Merri këto pesëqind dirhemë dhe jepi aty ku me të vërtetë duhet të jepen, sepse kjo shumë është zekati për pasurinë time.”

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: “Mbaji vetë dhe jepja komshinjeve të tu, jetimëve, atyre që s’kanë asgjë, si dhe vëllezërve të tu myslimanë.”

Mënyra e shpërndarjes së zekatit

Më sipër shpjeguam se ata që kanë të drejtë të marrin zekat, ishin shtatë kategori njerëzish: të varfrit, të mjeruarit (shpjeguam dallimin mes të varfrit e të mjeruarit dhe thamë se i varfëri nuk lyp, kurse i mjeruari lyp), mbledhësit e zekatit, atyre që u duhet t’u fitohet zemra, për lirimin e robërve, të zhyturit në borxhe, ata që kanë mbetur në rrugë dhe luftëtarët në rrugën e Allahut. Këtu vetvetiu lind një pyetje: A është detyrë që zekatdhënësi ose i ngarkuari prej tij ta shpërndajë zekatin në mënyrë të barabartë për të gjitha kategoritë që u thanë, në qoftë se ka prej tyre, ndryshe e

shpërndan vetëm për ato kategori që janë, në atë mënyrë që të mos i lërë pa i dhënë asnjërës kategori, kur gjenden prej asaj kategorie, apo lejohet që ai të japë zekatin për një kategori të vetme, madje edhe kur janë mundësitë për të dhënë për të gjitha kategoritë në mënyrë të barabartë?

Përgjigje:

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët për dëshminë që sjell autori i librit “El-Xhevàhir”, askush nuk është i detyruar ta ndajë zekatin në mënyrë të barabartë për të gjitha kategoritë që kanë të drejtë të marrin zekat, si dhe për lejimin e për dhënien e zekatis një kategorie dhe një kategorie tjetër jo, ose i jep një grupi të njërës prej kategorive, madje lejohet ta japë zekatin edhe vetëm një individ ndër disa kategori.

Për këtë lejim tregon qartë fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) zekatin e marrë prej banorëve të shkretëtirës e pjesëtonte ndër banorët e tjerë të shkretëtirës dhe zekatin e marrë prej banorëve të qyteteve e pjesëtonte ndër banorët e tjerë të qyteteve.”

Njoftimet tregojnë se Profeti (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e shpërndante zekatin në mënyrë të barabartë, por jepte aq pasuri sa ishte mbledhur prej tyre.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që, në krye të vitit, duhet të jepte zekatin, por atij i vdes babai dhe babai kishte borxh për të larë. Si të veprojë ky burrë, të japë

zekatin që ka detyrim apo me zekatin që ka detyrim të japë, të shlyejë borxhin e babait të tij? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Askush nuk ka më të drejtë të marrë zekatin prej tij, se sa borxhi që ka lënë babai i tij. Kur ai e jep zekatin për të shlyer borxhin e babait të tij, kur babai nuk ka lënë trashëgimi, shlyerja e borxhit të babait e plotëson detyrimin që ai ka për të dhënë zekat.”

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nëse ti zekatin ua jep të gjithëve, ose i jep vetëm njërit, detyrimi është kryer.”

Padyshim që ndër ata që kanë të drejtë të marrin zekat, është mustehab të shikohen me përparësi të afërmit, dijetarët e njerëzit e mirë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur atij që e ka pyetur se si t’ua japë zekatin atyre që kanë të drejtë të marrin zekat. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Jepi atyre që lënë vendin për të ruajtur fenë dhe atyre që shkojnë për të mësuar çështjet e fesë dhe logjikën.”

Në një transmetim tjetër, ka thënë: “Pëlqehet ai që nuk lyp ndaj atij që lyp.”

Pronari i pasurisë është i vërtetë në fjalën e tij

Kur pronari i pasurisë thotë: “E kam dhënë zekatin e pasurive të mia.”, ose thotë: “Për këtë pasuri që kam, nuk është detyrim që unë të jap zekat.”, në mënyrë absolute, fjala e tij pranohet pa dëshmitarë e pa betim, kur dihet se ai nuk gënjen. Kjo dispozitë është prej burimeve që flasin për pranimin e fjalës së

pretenduesit thjesht vetëm me fjalën e tij. Burimi për këtë gjykim është nxjerrë nga transmetimi që tregon se, kur Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), dërgonte mbledhësin e zekatit, i thoshte: “Kur të shkosh te pronari i pasurisë, i thuaj: ‘Allahu të mëshiroftë, jepe zekatin për atë pasuri që të ka dhënë Allahu.’ Nëse ai largohet prej teje, mos u kthe më te ai.”

Kjo fjalë e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), shërben si argument për sa thamë më sipër, se nuk ka ndërmjetësues mes Allahut e njeriut. Prandaj askush nuk ka të drejtë ta shpallë veten i ngarkuar nga ana e Allahut të Gjithëpushtetshëm dhe për punën e zekatit të kërkojë argumente e të grindet.

Transferimi i zekatit

Fukahatë kanë thënë: “Transferimi i zekatit prej një vendi në një tjetër lejohet, kur në vendin e zekatdhënësit nuk gjenden prej atyre që kanë të drejtë të marrin zekat.”

Këtë çështje po e trajtojmë, megjithëse dihet që janë shumë pak ata që kanë interes për transferimin e zekatit në një vend tjetër, madje mund të thuhet pa ngurrim se, në mënyrë absolute, nuk gjenden të tillë njerëz që të kenë interes për transferimin e zekatit. Por qëllimi ynë është që të tërheqim vëmendjen dhe të tregojmë se njerëzit e një kohe e ndienin thellë detyrimin për dhënien e zekatit, madje tregonin shumë interes për kryerjen e këtij detyrimi.

Përveç kësaj, edhe i varfëri nuk pranonte të merrte zekat. Në këtë gjendje, zekatdhënësi ishte i detyruar të transferonte zekatin prej vendit të vet në një tjetër, pra, ndodhte e kundërta e asaj që ndodh në ditët tona, kur ndodh të transferohet ekspozimi dhe shtohet kërkesa, megjithëse dihet që pasuria dje ishte më e shtrenjtë e më e paktë se sot, kurse në ditët e sotme pasuria me të vërtetë është me shumicë.

Sasia më e paktë që i jepet të varfrit

Transmetohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Asnjërit nuk i jepet zekat më pak se pesë dirhemë, domethënë dhënia të mos jetë më pak se pjesa e parë e dhënies në argjend, pasi kjo është sasia më e paktë që Allahu i Gjithëpushtetshëm ka bërë obligim të jepet zekat prej pasurive të myslimanëve, prandaj asnjërit të mos i jepni zekat më pak se pesë dirhemë.”

Në një transmetim tjetër tregohet se ai është pyetur: “A lejohet që burri të japë zekat dy ose tre dirhemë?” Ai tha: “Kjo është e lejueshme.”

Një grup fukahash kanë thënë: “Qëllimi i fjalës së tij “Kjo është e lejueshme.”, tregon se zekatdhënësi ka të drejtë të japë më pak se pesë dhe ligji i fesë e pranon këtë dhënie prej tij. Kurse qëllimi i fjalës së tij “nuk jep” dhe “nuk lejohet” më pak se pesë, do të thotë se dhënia e më pak se pesë dirhemëve është me kerahet, është veprim jo i pëlqyer. Me këtë bashkim ndërmjet dy transmetimeve, bie edhe kundërthënia, pasi është një bashkim konvencional, që e ka argumentin me vete, prandaj nuk është e nevojshme për argument nga jashtë, pasi është plotësisht si

bashkimi ndërmjet të veçantës me të përgjithshmen, ose si bashkimi ndërmjet absolutes dhe të kushtëzuarës. Më lart e kemi trajtuar këtë çështje, por menduam ta rikujtojmë edhe në lidhje me këtë rregull.

Mashtrimi ndaj Allahut e njerëzve

Sej'jid Kàdhim, në librin “El Urvetul Uthkà”, thotë: “Nuk i lejohet as të varfrit e as gjykatësit ligjor të marrë zekat prej pronarit të pasurisë dhe pastaj t’ia kthejë atij, ose që të bëjë ndonjë lëshim të vogël në marrëveshje mes të dyve, ose të pranojë prej tij më shumë se vlera e zekatit, si dhe të tjera gjëra të kësaj natyre, sepse të gjitha këto janë mashtrime për humbjen e së drejtës së të varfrit.” E njëjta gjë është edhe në lidhje me një të pestën, për detyrimin për shlyerjen e padrejtësive dhe të ngjashmet me këto.

Sej'jid El Hakijm, në librin “El Mustemsek”, duke komentuar mashtrimin në zekat, tekstualisht thotë: “Është e qartë se në marrjen nuk ka veshje, kur pagesa është e pakushtëzuar me kthim, por është absolute, ose me pretendimin për kthim, sepse ky rregull është fqinji i rregullit të parë.”

Ky shpjegim do të thotë: Zekatdhënësi i thotë të varfrit, me fjalë të qarta, se unë të jap këtë shumë prej zekatit që kam detyrim të jap, me kusht që të ma kthesh, pasi unë ta jap ty dhe i varfëri pranon. Ky veprim është i papranueshëm dhe detyrimi për dhënien e zekatit nuk është kryer. Në qoftë se pronari i pasurisë nuk e ka thënë kushtin me fjalë, por i ka dhënë pjesën e zekatit të varfrit, me nijet që i varfëri t’ia kthejë atij dhe i varfëri ia kthen, sapo e ka marrë prej tij, ose vetë i varfëri e ka marrë zekatin me

këtë nijet e me këtë motivim, pastaj ia kthen pronarit të pasurisë dhe te i varfëri nuk mbetet asgjë prej zekatit, ose te i varfëri mbetet diçka prej zekatit, kur është kështu, zekati është i vlefshëm dhe detyrimi për dhënien e zekatit bie.

Këtu dalin pyetje të shumta dhe çdo pyetje kërkon përgjigje, para pyetjes tjetër: Vallë ky nijet i pronarit të pasurisë, a përputhet me nijetin për afrim te Allahu, që është kusht në dhënien e zekatit, apo nijeti i pronarit të pasurisë është në kundërshtim me nijetin për afrim? Realisht, a ka dallim, sipas rezultatit, mes marrjes së sendit me kusht dhe marrjes së sendit sipas pretenduesit? Sikur të supozohet diskutimi i pranisë së dallimit mes dy gjendjeve, konkretisht, a është i kuptueshëm, ky dallim në masën e njerëzve, ose atë e kuptojnë vetëm disa njerëz të veçantë, ashtu siç e kupton Sej'jid El Hakijm e të ngjashëm me të, apo ai ka supozuar se thënia është për ta kuptuar njerëzit e veçantë? A kanë zbritur dispozitat e ligjit të fesë vetëm për njerëzit mendjehollë, ose për ata që e kuptojnë më mirë tradicionalen? Veç kësaj, nëse dispozitat e ligjit të fesë, do të ndiqnin interesat e shprishjet konkrete, ashtu siç thuhet në medh'hebin e shi'ave imamij, si është e mundur të ndryshojë një realitet i vetëm i hallallit ose i haramit, ose e kundërta, thjesht për shkak të ndryshimit të formës së fjalës dhe jo për ndonjë arsye tjetër?

Sikur kjo të ishte e lejuar, ç'kuptim do të kishte fjala e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): "Sikur të drejtat të shpenzoheshin për ata që kanë të drejtë t'i marrin, nuk do të kishte mbetur asnjë i varfër."? Apo mos vallë, lejimi do të thotë se të varfrit të varfërohen e të vuajnë edhe më shumë dhe, nga ana tjetër, të pasurit të kenë edhe më shumë mall e pasuri?

Për më tepër, a mund të ketë në mashtrimin hallall e haram, të drejtë e të gabuar, gabim e veprim të drejtë, apo çdo mashtrim është haram, ashtu siç e tregon vetë fjala mashtrim? Por Allahu i Gjithëpushtetshëm shikon realitetin e punëve dhe nuk shikon format e fjalëve.

* * *

SADAKAJA E FITRIT

Detyrimi për dhënien së sadakasë së Fitrit

Sadakaja e Fitrit, quhet edhe pastruesja e trupave, ose ruajtësja e qafave. Sadakaja e Fitrit është detyrim të jepet me rastin e përfundimit të agjërimit të Ramazanit. Detyrimi për dhënien e sadakasë së Fitrit është prej domosdoshmërive të fesë, plotësisht ashtu siç është detyrim dhënia e zekatit për pasuritë e disponueshme. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Prej plotësimit të agjërimit është dhënia e sadakasë së Fitrit, ashtu siç është prej plotësimeve të namazit salavati për Profetin Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!), sepse ai që agjëron dhe nuk jep sadakanë e Fitrit me qëllim, për atë nuk ka agjërim, ashtu siç nuk ka namaz, edhe për atë që e le me qëllim salavatit për Profetin Muhamed, sepse Allahu i Lartësuar e ka përmendur zekatin (pastrimin e adhurimit) para vetë namazit dhe thotë:*

“قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى. وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى”

“Ka shpëtuar ai që është pastruar; që kujton madhësinë e Zotit të vet dhe fal namaz.” (Sure “El A'la”, ajetet 14-15)

Kujt është detyrim t'i jepet?

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Është haram të marrë zekat ai që ka ushqim për një vit dhe është detyrim ta japë sadakanë e Fitrit ai që ka ushqim për një vit.” Gjithashtu, ai ka thënë: “Jetimi s’ka detyrim të japë zekat.”

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se kush e ka hallall ta marrë sadakanë e Fitrit. Ai është përgjigjur: “Ai që nuk ka, e ka hallall ta marrë sadakanë e Fitrit dhe nuk ka detyrim që ai ta japë këtë sadaka. Kurse për atë që e ka detyrim të japë, nuk është hallall që ai ta marrë sadakanë e Fitrit.”

Fukahatë

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se sadakaja e Fitrit është detyrim për këdo që është në këtë jetë në darkën e Bajramit të Ramazanit, domethënë natën e fundit të ditës së Ramazanit, me kusht që ai të ketë arrirë moshën e pjekurisë, të jetë i mençur dhe të mos ketë humbur vetëdijen. Në qoftë se humb qoftë edhe njëra prej këtyre cilësive, mbi atë njeri nuk rëndon asnjë detyrim, si për shembull atë e zë darka e Bajramit të Ramazanit pa arritur moshën e pjekurisë, ose e gjen të çmendur, ose ai ka humbur vetëdijen, ose ai nuk disponon ushqim për vete e për njerëzit që ka në ngarkim, ngaqë realisht nuk ka fuqi të punojë për një vit të plotë.

Për kë është detyrim të jepet sadakaja e Fitrit?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Sadakaja e Fitrit është detyrim të jepet për të voglin e për të madhin, për të lirin e për robin. Për çdo njeri jepet një “saun” grurë, ose një “saun” hurma, ose një “saun” stafidhe.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë, në shtëpinë e të cilit ka ardhur mik njëri prej vëllezërve të tij dhe gdhin aty ditën e Bajramit të Ramazanit. A ka detyrim mikpritësi të japë sadakanë e Fitrit edhe për këtë mik? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po, sadakaja e Fitrit është detyrim të jepet për çdo person që ai ka në ngarkim, mashkull ose femër, i vogël ose i madh, i lirë ose rob.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Burri ka detyrim ta japë sadakanë e Fitrit për veten e tij dhe për çdo person që ai e ka në ngarkim. Është e barabartë, qoftë kur përkujdesjen për të e ka detyrim, qoftë kur e mban për bamirësi. Madje i pari i shtëpisë ka detyrim ta japë sadakanë e Fitrit edhe për mikun që i vjen në shtëpi, si dhe për foshnjën që lind para se të perëndojë dielli i ditës së fundit të Ramazanit, qoftë edhe kur fëmija lind vetëm një çast para perëndimit të diellit të kësaj dite.

Sadakaja e Fitrit nuk është detyrim të jepet për ata pjesëtarë të familjes që nuk kanë qenë nën kujdestarinë e kryefamiljarit darkën e Bajramit, qoftë edhe kur ndonjë prej tyre ka shkuar mik te të afërmit e miqtë.

Sasia dhe lloji i sadakasë së Fitrit

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) çfarë jepet për sadakanë e Fitrit. Ai ka thënë: “Jepet një “saun” prej çdo gjëje: hurma, stafidhe e ushqime të tjera.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Është detyrim që për çdo njeri, të jepet sadakaja e Fitrit katër “med” grurë, ose elb, ose hurma, ose stafidhe, që bëjnë plot një “saun”.

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Sadakaja e Fitrit jepet me atë lloj ushqimi që sadekadhënësi ushqen njerëzit që ka në ngarkim, si qumësht, stafidhe, ose ushqime të tjera. Me çdo lloj ushqimi që ata ushqehen, me ato jepet edhe sadakaja e Fitrit.”

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) , nëse sadakaja e Fitrit jepet në monedha argjendi, me vlerën e ushqimeve të lartpërmendura. Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) është përgjigjur: “Po, madje kjo është më e dobishme për atë që e merr sadakanë e Fitrit, sepse me ato para ai ble sendet që dëshiron.”

Fukahatë

Detyrimi për sadakanë e Fitrit është një “saun”: grurë, ose elb, ose hurma, ose stafidhe, ose qumësht i tharë, pa i hequr gjalpin, ose oriz, ose misër, ose çdo lloj tjetër që ka emrin ushqim. Fukahatë kanë thënë: “Është më e pëlqyeshme që sadakaja e Fitrit të jepet në grurë, elb, hurma e stafidhe, sepse këto katër lloje ushqimesh janë përmendur në tekst më shumë se një herë. Por

nuk është larg mendjes të thuhet se këto katër ushqime ishin më të zakonshmet e me shumicë, që gjendeshin në atë kohë. Prandaj është më e pëlqyeshme që sadakaja e Fitrit të jepet në ushqime që janë të zakonshme e me shumicë për çdo kohë, ashtu siç kuptohet edhe prej fjalës së Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Prej të gjithë llojeve të ushqimeve.”

Një “saun” është afërsisht tre kilogram. Por sadakaja e Fitrit kryhet edhe nëse jepet në para, në shumën e çmimit të tregut që kanë ushqimet. Madje dhënia e sadakasë së Fitrit në para është më e pëlqyeshme, sepse është më e dobishme dhe i varfëri ka mundësi që me ato para të blejë atë çka dëshiron, ashtu siç ka thënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*).

Koha e dhënies së sadakasë së Fitrit

Është pyetur për kohën se kur jepet sadakaja e Fitrit. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Jepet para faljes së namazit të Bajramit të Ramazanit.”

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për foshnjën që lind darkën e Bajramit të Ramazanit. A jepet sadakaja e Fitrit për këtë foshnjë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Për këtë të lindur nuk jepet sadakaja e Fitrit, pasi sadakja e Fitrit jepet vetëm për fëmijën që ka mbushur një muaj nga jeta e tij.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Për dhënien e Sadakasë së Fitrit janë dy kohë: *e para*: koha e bërjes detyrim për dhënien e sadakasë së Fitrit dhe shqetësimi për mbajtjen e besës për dhënies e saj dhe, *koha e dytë*: është koha konkrete e dhënies së sadakasë së Fitrit. Koha e parë realizohet me hyrjen e hënës së re të muajit Sheu’al. Kush e sheh hënën e re të muajit Shev’vâl dhe plotësohen të gjitha kushtet, ai ka detyrim ta japë sadakanë e Fitrit dhe mban përgjegjësi për dhënien e saj. Koha e dhënies së sadakasë së Fitrit shtrihet prej fillimit të kohës që ajo bëhet detyrim, deri në kohën kur dielli i ditës së Bajramit të Ramazanit kapërcen zenitin. Është më mirë që sadakaja e Fitrit të jepet para faljes së namazit të Bajramit të Ramazanit. Në lidhje me këtë çështje, flasin disa transmetime të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*).

Burri as nuk e jep sadakanë e Fitrit e as nuk e ndan atë veç, deri para kohës kur dielli i ditës së Bajramit të Ramazanit të kapërcejë zenitin dhe e jep pasi dielli ka filluar animin kah perëndimi, me qëllim afrimin të Allahu i Gjithëpushtetshëm dhe jo me qëllim se po e kryen detyrimin kaza, ose sikur po jep në kohën e caktuar për dhënien e saj. Në lidhje me këtë çështje, një grup prej fukahave të mëdhenj, si Saduku, Mufijdi dhe studiuesi El Hil’lij, kanë thënë: “Sadakaja e Fitrit bie si detyrim, pasi dielli i ditës së Bajramit të Ramazanit të kapërcejë zenitin, sepse dhënia e sadakasë së Fitrit është e përcaktuar në kohë dhe, adhurimi i përcaktuar, të kryhet në kohë. Kjo duket qartë edhe në fjalët e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur ti e jep atë (sadakanë e Fitrit) para se të shkosh për të falur namazin e Bajramit të Ramazanit, ajo është

sadaka e Fitrit dhe, nëse ti e jep atë pas faljes së namazit të Bajramit, atëherë ajo është sadaka e zakonshme."

Nuk lejohet të shpejtohet dhënia sadakasë së Fitrit para hyrjes së hënës së re të muajit Shev'vâl, sepse është adhurim që duhet të kryhet në kohën e vet dhe nuk është detyrim kryerja e këtij detyrimi pas kalimit të kohës, kur dihet që është e kushtëzuar me daljen e hënës së re, pra, është plotësisht si falja e namazit, para se të hyjë koha për faljen e atij namazi. Patjetër që lejohet dhënia për të varfrin si borxh dhe pastaj, kur të hyjë koha e detyrimit për dhënien e saj, e llogarit borxhin e dhënë sadaka të Fitrit.

Kujt i jepet sadakaja e Fitrit?

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): *"Kujt i jepet sadakaja e Fitrit?"* Ai është përgjigjur: *"I jepet atij që s'ka asnjë send."*

Gjithashtu, ai ka thënë: *"Sadakaja e Fitrit u takon atyre që kanë të drejtë ta marrin atë, përveç rasteve kur nuk gjenden të tillë. Nëse nuk gjenden, atëherë ajo i takon atij që nuk sulmon."*, domethënë, atij që nuk shfaq armiqësi ndaj Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*).

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: *"Sadakaja e Fitrit u jepet po atyre që u jepet edhe zekati për pasuritë, ashtu siç tregojnë transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta!),*

sepse sadakaja e Fitrit bën pjesë në tërësinë e sadakave që përfshihen në ajetin e nderuar të Kur'anit:

“إِنَّمَا الصَّدَقَاتُ لِلْفُقَرَاءِ وَالْمَسْكِينِ”

“Lëmoshat janë për të varfrit e për të ata s’kanë asgjë (të mjeruarit)...” (Sure “Et Teubeh”, ajeti 60)

Prej tetë kategorive që kanë të drejtë të marrin zekatin, për marrjen e sadakasë së Fitrit, fukahatë kanë përjashtuar vetëm dy kategori: kategorinë e atyre që u duhet përfituar zemra dhe punonjësit e mbledhjes së zekatit. Gjithashtu, fukahatë kanë lejuar që sadakaja e Fitrit t’u jepet edhe myslimanëve të pafuqishëm, që nuk janë prej shi’ave imàmij, kur nuk gjendet as edhe një i vetëm prej shi’ave imàmij.

Çështje

1- Të varfrit nuk i jepet më pak se një “saun”, domethënë tre kilogram, sipas fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Askujt mos i jep më pak nga sa jepet për kokë.”

2- Në sadakanë e Fitrit është detyrim nijeti për afrim te Allahu, sepse dhe sadakaja e Fitrit është adhurim.

3- Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Është mustehab që në dhënien e sadakasë së Fitrit të kenë përparësi të afërmit, ashtu siç është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nuk ka sadaka, kur i afërmi është në nevojë.” Pastaj vijnë fqinjët, ashtu siç është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Fqinjët kanë më shumë të drejtë ta marrin sadakanë e Fitrit.”

Gjithashtu, shihen me përparësi njerëzit e virtytshëm, të devotshmit në fe dhe dijetarët, ashtu siç thotë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Jepi atyre që lënë vendin e vet për të ruajtur fenë, për të mësuar dispozitat e ligjit të fesë (fik’hut) dhe logjikën (kuptimi i të vërtetës së gjërave).”*

Më pas, autori i librit “El Xheuàhir”, thotë: “Qëllimi me: afërsinë, fenë, fik’hun dhe logjikën, është se këto kategori kanë përparësi për të marrë sadakanë e Fitrit.”

* * *

NJË E PESTA (KHUMSI)

Detyrimi për dhënien e një të pestës (khums-it)

Allahu i Lartësuar thotë:

“وَأَعْلَمُوا أَنَّمَا غَنِمْتُمْ مِنْ شَيْءٍ فَإِنَّ لِلَّهِ خُمُسَهُ وَلِلرَّسُولِ وَلِذِي الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسَاكِينِ وَابْنِ السَّبِيلِ”

“Dijeni se një e pesta e asaj që fituat i takon Allahut, të Dërguarit të Tij, të afërmeve të tij, jetimëve, nevojtarëve dhe atyre që kanë mbetur në rrugë...” (Sure “El Enfal”, ajeti 41)

Imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*), i biri i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), duke komentuar këtë ajet të Kur’anit, ka thënë: “Ajo që është për Allahun, është për të Dërguarin e Tij dhe ajo që është për të Dërguarin e Tij, është për ne. Pasha Allahun! Allahu i Lartësuar e ka bërë të lehtë furnizimin me ushqim, duke vënë detyrim mbi besimtarët pesë dirhemë, një dirhem e ndajnë për Allahun dhe katër dirhemët e tjerë i hanë hallall.”

Babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur Allahu i Lartësuar bëri haram për ne zekatin, ai zbriti për ne një të pestën, sepse ne e kemi haram të marrim zekat, kurse një e pesta (khumsi) është detyrim të na jepet ne.”

Një e pesta do të trajtohet në katër drejtime; *e para*: pasuritë në të cilat një e pesta është detyrim; *e dyta*: nisabi i një të pestës, *e treta*: ku shpenzohet një e pesta dhe *e katërta*: plaçka e luftës.

Pasuritë për të cilat është detyrim dhënia e një të pestës

Pasuritë për të cilat është detyrim të jepet një e pesta, janë shtatë: plaçka e luftës, mineralet, thesaret, sendet e gjetura në thellësi të detit, toka që ka blerë prej myslimanit jomyslimani, që është në besë të myslimanëve dhe malli hallall i përzier me mall haram. Kufizimi me këto shtatë lloje pasurish është induktiv dhe i nxjerrë prej argumenteve të ligjit të fesë dhe nuk është kufizim logjik, që përsëritet ndërmjet negatives dhe pozitives.

Mallrat, plaçkë lufte

1- Plaçkë lufte është çdo gjë që merret prej vendeve jomyslimane me luftë dhe është e barabartë qoftë kur atë e ka shtënë në dorë ushtria, qoftë kur nuk e ka shtënë dorë ushtria. Gjithashtu, është e barabartë, qoftë kur plaçka e luftës është pasuri e luajtshme si kafshët, mobiliat e paratë, qoftë kur është pasuri e paluajtshme, si tokat, pemët, ndërtesat, pak ose shumë qoftë ajo pasuri, me kusht që pasuria, plaçkë lufte, të jenë sende të lejuara për myslimanët, domethënë të mos jetë verë e derra, të mos jetë tokë e grabitur prej ndonjë myslimani, ose prej ndonjë jomyslimani që është në besën e shtetit islam, ose e ndonjë jomyslimani, me të cilin ka marrëveshje shteti islam.

Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Çdo send për të cilën është vrarë duke luftuar ai që thotë “Là ilàhe il’lall’llàh Muham’medun resùlull’llàh” -“Nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut!”, në ato sende ne na takon një e pesta. Askush nuk lejohet të blejë asnjë send prej një të pestës, derisa të arrijë e drejta jonë te ne.”

Duhet të theksohet se qëllimi me fjalën “luftë” është për pasuritë që myslimanët marrin si plaçkë lufte. Me fjalë të tjera, është lufta që bëjnë myslimanët kundër jomyslimanëve për lartësimin e Islamit, për atë luftë e cila, me të drejtë, meriton të quhet “xhihàd” (luftë në rrugën e Allahut), luftë për hir të fesë, pasi nuk është “xhihad” e luftë “në rrugën e Allahut” çdo luftë që zhvillohet mes myslimanëve e jomyslimanëve, siç janë luftërat që bëhen për interesat e kësaj bote dhe jo për të lartësuar e për të mbrojtur fenë e Allahut.

E vërteta në lidhje me fjalën “luftë” shpjegohet qartë në fjalën e Imamit: “Çdo send për të cilën është vrarë duke luftuar ai që thotë “Là ilàhe il’lall’llàh Muham’medun resùlull’llàh”. Me fjalë të tjera, pasuria e jomyslimanit është hallall për myslimanin vetëm në një formë të vetme, vetëm atëherë kur vërtetohet që jomyslimani është ngritur të luftojë kundër Allahut e kundër të Dërguarit të Tij. Gjithashtu, kur vërtetohet që lufta e myslimanit është luftë në rrugën e Allahut e të Dërguarit të Tij, pikërisht kjo luftë e bën hallall të derdhet gjaku i këtij jomyslimani që lufton myslimanët dhe të merren pasuritë e tij, sepse ky jomysliman me keqpërzgjedhjen e tij bëri të mundur që gjaku e pasuria e tij të jenë të lejuara për myslimanët, në një kohë që ai kishte mundësi të hiqte dorë prej luftës dhe gjaku e pasuria e tij të gëzonin respektin e siguruar prej shtetit islam. Ky kuptim që ne i dhamë ajetit të

Kur'anit, nuk është thjesht komentim e justifikim, por, në të vërtetë, është kuptimi i qartë i ajeteve të Kur'anit, i haditheve profetike dhe i thënieve të të gjitha shkollave juridike islame (medh'hebeve), pa asnjë përjashtim.

Mineralet

2- Minerale quhen ato që dalin prej tokës, që janë krijuar brenda saj, por që nuk janë pjesë e qenësishme dhe nga e vërteta e tokës, me kusht që minerali të ketë vlerë e çmim, si për shembull, floriri, argjendi, plumbi, hekuri, bakri, gurët e çmuar të llojeve të ndryshme, kripa, metaloide nga të cilat nxirren ngjyra për tualet, nafta, squfuri e shumë e shumë minerale të tjera, me kusht që të gjitha këto, emri mineral të jetë i drejtë. Në qoftë se ka dyshim që një element kimik të mbajë emrin mineral, ky element nuk hyn te mineralet.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për mineralin e floririt, të argjendit, të bakrit të verdhë (kimikisht i pastër), të hekurit e të plumbit. Ai është përgjigjur: "*Për të gjitha këto është detyrim të jepet një e pesta (khumsi).*"

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për thesaret e metalet. Ai është përgjigjur: "*Një e pesta.*" Është pyetur Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), për kripën, naftën e sqfurin. Ai është përgjigjur: "*Për këto e për të ngjashmet me këto, është detyrim të jepet një e pesta (khumsi).*"

Në të vërtetë, një e pesta për mineralet jepet kur vlera e tyre arrin njëzet dinarë e më sipër dhe, për vlerë më poshtë se njëzet dinarë, nuk jepet asgjë. Por edhe kur vlera e mineralit të nxjerrë arrin njëzet dinarë, paraprakisht, hiqen shpenzimet e bëra për nxjerrjen dhe përfitimin e metalit të pastër, pastaj prej asaj që mbetet, jepet një e pesta.

E kanë pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Po sikur, pas kësaj të mbetet vetëm një dinar?” Ai është përgjigjur: “Për mineralin nuk jepet asgjë, derisa vlera e tij të arrijë vlerën që e bën detyrim dhënien e zekatit.”, domethënë njëzet dinarë. Bazuar mbi këtë transmetim, janë mbartur edhe transmetime të tjera, që e bëjnë detyrim një të pestën për mineralet, pa i kushtëzuar me arritjen e vlerës së njëzet dinarëve.

Kur minerali nxirret parti-parti, partitë bashkohen me njëra-tjetrën dhe nisabi llogaritet si total. Mbi këtë total është detyrim të jepet një e pesta, qoftë edhe kur mineralet janë të llojeve të ndryshme, si: flori, argjend, bakër, hekur, etj.

Kur në nxjerrjen e mineralit merr pjesë një grup njerëzish, shikohet: Nëse vlera e nisabit arrihet në pjesën e nxjerrë prej çdo personi, atëherë për këtë mineral të nxjerrë jepet një e pesta, ndryshe nuk jepet asgjë.

Kur minerali nxirret prej një toke, që është pronë e dikujt, minerali i nxjerrë i takon pronarit të asaj toke, sepse çdo gjë që gjendet në brendësi të tokës, i përket asaj toke dhe dispozita e mineralit të nxjerrë është dispozita për vetë tokën në fjalë. Por nëse minerali nxirret në një tokë të lejuar, minerali i nxjerrë i takon nxjerrësit, i cili tani e ka në zotërim, prandaj ai ka detyrim që për

mineralin e nxjerrë të japë një të pestën, vetëm kur sasia e mineralit arrin masën e nisabit.

Thesari

3- Thesar quhet gjëja e fshehur. Këtë e tregon fjala e Allahut:

“...أَوْ تَسْمَعُ لَهُمْ رَكْرَأًا...”

“...ose po dëgjon zërin e tyre të ulët (nuk po u dëgjohej zëri).” (Sure “Merjem”, ajeti 98), domethënë, një zë të fshehur. Qëllimi me fjalën “thesar” është pasuria e fshehur në tokë, monedha ose gurë të çmuar, në fillimet e Islamit ose në kohën e injorancës para Islamit dhe që gjendet në një tokë të marrë me luftë ose në kohë paqeje. Kushdo që gjen një pasuri të këtij lloji, ai është pronar i kësaj pasurie dhe ka detyrim që, për këtë pasuri të gjetur, të japë një të pestën, kur ajo arrin shumën e nisabit, që, siç u shpjegua, është njëzet dinarë e sipër, por nuk ka asnjë detyrim, kur është më poshtë se njëzet dinarë.

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*), nipi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për sasinë e thesarit të gjetur, për të cilin është detyrim të jepet një e pesta. Ai është përgjigjur: “Për të njëjtën shumë e sasi të llojit të pasurisë për të cilën është detyrim të jepet zekati, kurse për llojin e pasurisë që nuk e arrin masën e nisabit, për atë pasuri nuk është detyrim as zekati e as një e pesta.”, domethënë që nisabi plotësohet, kur vlera arrin njëzet dinarë (monedha floriri) ose dyqind dirhem (monedha argjendi).

Sikur të supozojmë që ky transmetim është i gradës “*Daijf*” - “*Dobët*”, nga pikëpamja e transmetuesve, puna e fukahave të dëgjuar me këtë transmetim, e forcon gradën e transmetimit, madje e bën të detyrueshëm punën sipas këtij transmetimi, duke shtuar edhe faktin që shejkh El Hamedànij, në librin “*Misbàhul Fakijh*”, e ka cilësuar transmetimin e Bizanti’j’it të gradës “*Sahijh*”, domethënë të saktë plotësisht dhe transmetimi përputhet me transmetimin që ne përmendëm.

Ja edhe fjalët, tekstualisht, të transmetimit të Bizanti’j’it: “E pyeta për sa bëhet detyrim një e pesta për thesarin.” Ai u përgjigj: “Për aq sa është detyrim të jepet zekat, për të njëjtën shumë është detyrim të jepet edhe një e pesta.”

Ai që gjen thesar në tokën e tjetrit

Ai që gjen thesar në një tokë që nuk ka pronar, thesari i gjetur i takon gjetësit. Për këtë thesar të gjetur, ai s’ka detyrim tjetër përveç një të pestës dhe, me fjalën e përbashkët të fukahave, si dhe me dëshminë e autorit të librave “*El Xheuàhir*”, “*El Medàrik*” dhe “*El Hadàik*”, është e barabartë, qoftë kur thesari i përket kohës së fillimeve të Islamit ose jo, gjithashtu, është e barabartë, qoftë kur gjendet në një tokë të marrë me luftë, ose me paqe, në tokë islame, ose në tokën e mohuesve.

Kush blen një copë tokë prej një tjetri dhe aty gjen një thesar, ka detyrë që thesarin e gjetur t’ia tregojë pronarit të parë të tokës dhe ta pyesë, nëse ky thesar është i tij apo jo. Në qoftë se pronari shitës pretendon se është i tij, atëherë është detyrë që ky thesar t’i dorëzohet atij, pa kërkuar prej tij dëshmitarë për vendin

ku e ka fshehur dora e mëparshme. Në qoftë se për thesarin e gjetur, shitësi i tokës nuk ka pretendim që thesari është i tij, ose i ndonjë tjetri prej njerëzve të kohës, atëherë thesari i gjetur i takon gjetësit, i cili ka detyrim që, për këtë thesar, të japë një të pestën për ata që kanë të drejtë ta marrin.

Kur burri e gjen thesarin në një tokë që ka pronar, gjetësit nuk i lejohej të veprojë me thesarin e gjetur, derisa t'ia paraqesë atë pronarit të tokës dhe, nëse pronari pretendon se thesari është i tij, ai ka të drejtë më shumë se kushdo për atë thesar, ndryshe thesari i mbetet gjetësit. Kjo dispozitë i atribuohet dijetarëve më të dëgjuar, ose shumicës së dijetarëve, por ajo që ne konstatojmë, rezulton se kjo çështje, patjetër, ka nevojë për shpjegime më të gjëra, madje ka nevojë edhe të përkufizohet.

Sido që të jetë, kushdo që vështrohet me imtësi në këtë çështje, do të shikojë se ajo që ne kemi cituar prej fukahave nuk është praktike për disa arsye: Cili është ai njëri që gjen një thesar në tokën e tjetrit dhe e njofton pronarin e tokës për thesarin e gjetur? Cili është ai njeri që thotë se nuk është thesari im, kur i vihet përpara thesari? Veç kësaj, si do ta pretendojë këtë thesar, kur më parë thesari për të ishte i panjohur, sepse, sikur ai të kishte dijeni për thesarin, nuk do të vonohej asnjë çast e do ta nxirrte sa më shpejt. A mund të mendohet se ai do ta shiste tokën, duke e ditur në atë tokë gjendet një thesar?

Për sa i përket supozimit të disa fukahave, se ai ka pasur dijeni për thesarin, por më pas e ka harruar dhe është larguar shumë larg, ne themi: Të gjithë e dimë mire se moszbatimi i dispozitave ligjore, nuk do të thotë as mohim i atyre dispozitave dhe as se ato nuk janë ligjore, thjesht për shkak të afërsisë, kur në

të vërtetë duhet të pohohet: Çdo send që është në tokë, ndjek tokën dhe në këndvështrimin e traditës e të zakonit, sendi që është brenda në tokë, hyn në pronësi të pronarit të tokës, edhe nëse nuk është pjesë e tokës dhe është e barabartë, qoftë kjo pjesë është pemë, gurë, mineral, apo ajo është thesar. Gjithashtu, është e barabartë, qoftë kur ai e ka marrë tokën në pronësi me rrugë ligjore, si me dhurim ose me blerje.

Bazuar mbi këto që u thanë, kush gjen një thesar në tokën e tjetrit, në asnjë rast atij nuk i lejohet t’ia ekspozojë pronarit të tokës, por është haram veprimi me pasurinë e tjetrit pa lejen e pa miratimin e tij. Por nëse gjetësi mëkaton dhe vepron pa lejen e pronarit të tokës dhe e nxjerr thesarin, në këtë rast, ai ka detyrë t’ia dorëzojë pronarit të tokës, edhe pse nuk e di që ai është pronari.

Gjithashtu, kur toka, për ndonjë shkak ligjor, kalon në pronësi të tij, së bashku me tokën, kalon në pronësi të tij çdo send që është brenda në tokë, si thesar, minerale, etj. Në mënyrë absolute, nuk është detyrim që ai të njoftojë pronarin e mëparshëm të tokës, përveç rastit kur ka mundësi që thesari të jetë i pronarit të tokës, ose i trashëgimtarit të tij, pasi në këtë rast është pronari ai që e ka fshehur thesarin në tokë. Për këtë çështje që ne preferuam të trajtojmë, flet transmetimi i përcjellë prej Muham’med bin Muslim, i cili e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për dirhemët e gjetur në një shtëpi. Ai është përgjigjur: “Në qoftë se shtëpia është e banueshme, atëherë ato janë për njerëzit e shtëpisë. Në qoftë se shtëpia është e rrënuar, ti, gjetësi ke të drejtë më shumë kushdo tjetër ta marrësh këtë shumë.” Në këtë rast, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), me fjalën “e banueshme”, ka pasur qëllim “në pronësi”.

Gjithashtu, kjo na ndihmon edhe në lidhje me ato që kemi thënë në kapitullin “Sendet e hedhura”, ku kemi shpjeguar se ai që gjen një send në shtëpinë e tjetrit, ka detyrë të tregojë sendin e gjetur.

Kur burri ble një kafshë dhe, kur ai e ther kafshën gjen në barkun e saj monedha argjendi, ose perla, ose sende të tjera të vlefshme, ai ka detyrë t’ia ekspozojë këto shitësit, që ai t’i njohë. Nëse shitësi i njeh, atëherë ato janë për shitësin, ndryshe janë për gjetësin, i cili ka detyrim që të ndajë një të pestën prej atij thesari të gjetur. Si argument për këtë dispozitë shërben gjykimi i veçantë i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për një burrë, i cili ka blerë deve ose lopë për kurban dhe, kur i ther ato, gjen në barkun e tyre dirhemë, ose dinarë, ose gjen perla. Kujt i takojnë këto? Ai është përgjigjur: “Gjetësi njofton shitësin. Nëse ai i njeh, i merr ato. Nëse shitësi i kafshës nuk i njeh, ato janë për gjetësin, sepse Allahu i ka bërë risk (furnizim) për të.”

Por ky transmetim s’ka të bëjë me thesarin, sepse thesari është pasuria e groposur në tokë dhe jo në barkun e kafshëve.

Kur burri ble një peshk dhe në brendësi të peshkut gjen një send, ka detyrë të japë një të pestën e sendit që gjeti dhe atë që mbetet, e ka në pronësi të tij. Gjithashtu, sipas fukahave më të dëgjuar, ai s’ka detyrë të njoftojë shitësin e peshkut për sendin e gjetur në barkun e peshkut. Dallimi mes kafshës e peshkut, qëndron në atë se për të parën ka tekst, kurse për të dytën s’ka tekst, atëherë mbetet të bazohemi në origjinën e çështjes, e cila lejon pronësinë e sendit të gjetur në barkun e peshkut.

Vlen të theksohet se sendi i gjetur në brendësi të kafshës e të peshkut, nuk është i kushtëzuar me arritjen e vlerës së nisabit, sepse ai send nuk është thesar, kurse ajo çka gjendet në brendësi

të tokës është e kushtëzuar të arrijë vlerën e nisabit që, siç u tha, është njëzet dinarë, ose dyqind dirhemë, plotësisht ashtu siç ishte për mineralet.

Sendet e nxjerra me zhytje

4- Në gjuhën arabe fjala “*gaus*” do të thotë sendi i nxjerrë prej detit me anë të zhytjes, si për shembull, perla, diamante, gurë të çmuar të llojeve të ndryshme, metale, minerale dhe bimë që kanë vlerë, por jo peshk e kafshë. Për sendet e nxjerra prej detit me anë të zhytjes, është detyrim të jepet një e pesta, kur vlera e tyre arrin një dinar, e më shumë, por nuk jepet gjë, kur vlera e sendit të nxjerrë është më pak se një dinar.

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) për sendet që nxirren prej detit me zhytje, si perlat, gurët e çmuar të llojeve të ndryshme dhe mineral floriri e argjendi ose edhe flori e argjend metal. Ai është përgjigjur: “Kur vlera e sendit të nxjerrë arrin një dinar, për atë jepet një e pesta.”

Kur në det mbytet një send, si anije e të ngjashme, ajo i takon nxjerrësit dhe, kur sendi i mbytur nxirret prej detit, nuk është detyrim që për atë send të jepet një e pesta. Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) tregon se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: “Kur anija mbytet me gjithçka që ka në të dhe njerëzit i gjejnë sendet që ka nxjerrë deti në breg, ato sende janë për njerëzit e anijes, sepse ata kanë më shumë të drejtë t’i marrin ato sende, kurse mallrat e tjera që pronari i ka lënë dhe njerëzit i nxjerrin me zhytje, ato u takojnë atyre që i nxjerrin.”

Më shumë se nevoja për një vit

5- Ajo çka tepron, pasi plotësohet nevoja për një vit, për vetë personin e për personat që ai ka në ngarkim dhe fitimi është realizuar me anë të tregtisë, të mjeshtërisë, të bujqësisë dhe prej çdo pune tjetër, autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim, që mund t’i bëhet, madje me fjalën e përbashkët të fukahave, qëndron fjala që pohon medh’hebi dhe me të cilën punohet në ditët tona. Madje me këtë fjalë është punuar edhe më përpara në kohët e kaluara, sepse është fjala që mundëson bashkimin me kohën e Imamëve të ruajtur prej gabimeve (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*).”

Në lidhje me këtë çështje, kanë ardhur transmetime të shumta prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*). Prej këtyre transmetimeve është edhe transmetimi që tregon se një burrë i shkroi Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*): “Më njofto për një të pestën. A është për të gjitha fitimet që realizon burri me të gjitha rrugët hallall dhe prej tokës pak ose shumë qofshin? Dhe si bëhet llogaritja e një të pestës?” Me dorën e tij, Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) i shkroi: “Një e pesta është kur me atë shumë ose sasi, plotësohet nevoja për një vit.”

Është pyetur Imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*) për një të pestën. Ai tha: “Jepet në atë që fitojnë njerëzit, pak ose shumë qoftë ai fitim.”

Atëherë, atij që i tepron diçka, pas plotësimit të nevojës për një vit, për këtë tepricë, ai ka detyrim të japë një të pestën, qoftë edhe kur teprica është vetëm një dirhem, ose një kilogram grurë,

etj., domethënë, në krye të vitit është detyrim të jepet një e pesta e asaj që është më shumë se nevoja për një vit. Koha e dhënies ndryshon sipas personave dhe sipas llojit të punës: Viti tregtar llogaritet me kohën e fillimit të tregtisë, bujqësia me kohën e mbledhjes së prodhimit, nëpunësi që nga dita që fillon të marrë rrogën, etj.

Thënia më e përhapur në mesin e fukahave dhe me dëshminë e autorit të librit “El Hadàik” dhe të librit “El Medàrik”, është se nuk ka një të pestë për trashëgiminë, për dhuratën e për mehrin (shumën e kurorës), edhe atëherë kur shuma e këtyre llojeve pasurish është më shumë se nevoja për një vit. Autori i librit “Kàshiful Gitài” dhe i librit “El Urvetul Uthkà”, me tri pasuritë e lartpërmendura ka bashkuar shumën ose sasinë që merret prej një të pestës, ose prej zekatit, për shkak të dyshimit në emrin e dobisjelljes prej këtyre shumave, ose sasive.

Ndërsa ne dyshojmë edhe në thënien e dëgjuar të fukahave për mohimin e një të pestës për tri llojet e pasurive që u thanë më lart, për shkak se ata nuk kanë argument tjetër përveç transmetimit të ibn Mehziàrit, i cili, si transmetim, përmban pak argumente nga ajo që ata pretendojnë,¹ prandaj mbetet fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Një e pesta jepet për gjithçka që njerëzit fitojnë, pak ose shumë. Një e pesta është për të gjitha fitimet që realizon burri prej të gjithë rrugëve, pak ose shumë.”

¹ Për këtë transmetim kanë shfaqur dyshim shumë fukaha dhe kanë përmendur kundër këtij transmetimi disa komplikacione që ai përmban, të cilat i ka cituar autori i librit “El Hadàik”. Në shpjeguesin e librit “El Irshàd”, tekstualisht, thuhet: “Në këtë transmetim, krahas paqartësive, ka shumë dispozita që janë në kundërshtim me medh’hebin.”

Kjo thënie e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) mbetet absolute. Prandaj është detyrë që ajo të përgjithësohet për të gjitha llojet e fitmeve, pa asnjë përjashtim.

Përkufizimi i nevojës për një vit

Në lidhje me plotësimin e nevojës për një vit dhe për shpenzimet e veçuara për një vit, në ligjin e fesë nuk ka ndonjë kuptim të veçantë, prandaj si pikë referimi për përcaktimin e nevojës për një vit, është vetëm tradita. Në këndvështrimin e traditës, nevoja për një vit ndryshon sipas personave. Por rregulli i përbashkët për nevojat e një viti kërkon që të mos ketë as shpërdorim e as mendjelehtësi. Në nevojën e një viti hyn shpenzimi për ushqim, veshje, banesë, veturë, mobilie, pijet hallall, sendet e nevojshme për udhëtimet që burri ndërmer, për shërbimet e tij personale, për mikpritje, për dhurata, për të sprapsur të keqen nga vetvetja, ose prej një besimtari, për të martuar fëmijët e tij, ose për t’u rimartuar vetë, apo për punë të tjera që ai mund të mos i dijë dhe që është vështirë të renditen këtu.

Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Është e pamundur të merret njoftim për të gjitha këto, sidomos duke vënë në konsideratë personat, kohët e vendet, etj. Prandaj, për të mësuar shpenzimet, mbështetja te tradita është rruga më e mirë, si për shembull, kur duam të dimë shpenzimet e nevojshme të familjes për një vit, sepse s’ka asnjë që të mos ketë njerëz në ngarkim. Prandaj detyrimisht ai do të ketë edhe nevoja të ndryshme, të cilat ai duhet të mbulojë për gjithë vitin.”

Pyetje: A llogaritet apo nuk llogaritet borxhi prej nevojave vjetore, në atë mënyrë që mbajtja e besës për shlyerjen e borxhit të numërohet plotësisht si nevoja për ushqim e veshje?

Përgjigje:

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët dhe janë shprehur se borxhi që është marrë brenda vitit të fitimit për të mbuluar shpenzimet, ose për tregti, llogaritet plotësim i nevojës vjetore, kurse borxhi i marrë, pasi kalon viti i fitimit, një e pesta e tij nuk bashkohet me fitimin e vitit të kaluar, sepse borxhi i parë ka ndodhur gjatë vitit dhe llogaritet prej nevojave vjetore, kurse borxhi i dytë ndodhi pas heqjes së nevojave vjetore, prandaj është i huaj për ata.

Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me borxhin e kaluar, që mbetet mbi vitin e fitimit. Disa prej fukahave nuk e llogarisin këtë borxh prej shpenzimeve të nevojës vjetore. Të tjerë mendojnë se në origjinë edhe ky borxh është prej nevojës vjetore, kurse ne jemi me këta të dytët, sepse sekreti i numërimit të një sendi prej nevojës vjetore, është nevoja që ke për atë send dhe, duke ditur se qëndrimi në besë për shlyerjen e borxhit, veçanërisht të borxhit të mëparshëm, rezulton që borxhi është prej nevojave më të mëdha. Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Borxhi i mëparshëm është prej nevojës vjetore, edhe atëherë kur në kohën e marrjes, nuk ke pasur nevojë për të, por meqenëse ti detyrimisht je i shqetësuar për shlyerjen e këtij borxhi, ai bëhet prej nevojës vjetore.”

Kur burri ble për nevojat e vitit një send që mbetet te ai për disa vjet, si për shembull ble një sixhade, karrige, krevat, enë kuzhine, veshje zbukurimi për gratë, veturë etj., a është apo jo detyrim vlerësimi i këtyre sendeve, pas përfundimit të vitit dhe dhënia e një të pestës për to?

Përgjigje:

Për këto pajisje nuk ka një të pestë, sepse nevoja për to vazhdon të jetë. Veç kësaj, këto janë prej sendeve që janë nxjerrë në mënyrë të prerë jashtë argumentit për detyrimin e dhënies së një të pestës në krye të vitit të fitimit, për shkak se këto sende as nuk mund të hyjnë në vitin e fitimit për herë të dytë e as nuk mund të përfshihen në të, përveçse kur ka argument. Por argumente për këto nuk ka.

Jomyslimani në besën e shtetit islam dhe blerja e tokës

6- Pasuria e gjashtë, për të cilën është detyrim të jepet një e pesta, është toka e myslimanit, e blerë prej jomyslimanit, që është në besën e shtetit islam, domethënë se ky jomysliman ka detyrim të japë një të pestën e fitimit që realizon prej tokës që ai ka blerë prej myslimanit, ashtu siç është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Çdo jomysliman që është në besën e shtetit islam dhe që ka blerë tokë prej një myslimani, ka detyrim të japë një të pestën.”

Kur ti e di që ky jomysliman është ithtar i librave të mëparshëm dhe i paguan shtëpisë së pasurisë së myslimanëve

taksën e xhizjes (taksa e sigurimit të jetës, pasurisë e nderit), por, dihet se sot ky parim nuk ka më kredibilitet.

Përzierja e hallallit me haram

7- Pasuria hallall, kur përzihet me pasuri haram, aq sa nuk dallohet dhe nuk dihet sa është sasia e haramit në atë pasuri, për pasojë, pronari i kësaj pasurie nuk ka të drejtë ta mbajë atë. Në një gjendje të këtillë, pronari i kësaj pasurie ka detyrim të nxjerrë prej totalit të kësaj pasurie të përzierë, një të pestën. Pastaj pjesa që mbetet, është hallall. Dijetari i madh El Hil'lij, në librin “Et Tedhkireh” ka thënë: “Ndalimi i tij për të vepruar me këtë pasuri, në fakt atij i mohon të drejtën e pronësisë mbi mallin në fjalë dhe ai nuk e ka këtë pasuri në zotërim të plotë, ashtu siç janë njerëzit e tjerë zotërues të pasurive të tyre. Veç kësaj, ky ndalim për të mos vepruar me këtë pasuri të përzier sjell dëm të madh, pasi heq mundësinë për të përfituar prej pasurisë. Në një kohë kur nevoja për këtë përfitim është gjithmonë, por edhe lejimi për të vepruar me totalin, në fakt, është lejim i haramit, atëherë rezulton se një pjesë e kësaj pasurie të përzierë është pronë e një tjetri, pasi në gjendjen e përzierjes, qoftë pronari, qoftë ai tjetri, janë të përjashtuar prej të drejtës së përfitimit, kështu që nuk mbetet rrugë tjetër përveç nxjerrjes së një të pestës.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon: Një burrë shkoi te Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i tha: “O Prijës i besimtarëve, unë kam pasuri, por nuk e di sa prej saj është hallall e sa është haram.” Imami Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Ndaje një të pestën prej kësaj pasurie, sepse Allahu i Lartësuar është i kënaqur me një të pestën e pasurisë.”

Kur pronari i pasurisë e di sasinë e haramit, ai ka detyrim të nxjerrë pjesën që është haram. Kjo është e barabartë, qoftë kur sasia e haramit është më pak se një e pesta, qoftë kur ajo është më shumë. Nëse ai e di se cila pjesë konkretisht është haram, ai nxjerr vetëm atë pjesë. Por kur ai nuk e di saktësisht sa është pjesa haram në totalin e kësaj pasurie, por di mirë se ajo është më shumë se një e pesta, atëherë ai nxjerr prej totalit vetëm një të pestën, si dhe pjesën që mendon se është më shumë se një e pesta.

Kur pronari i pasurisë e di sa pasuri ka, por nuk di sasinë e saj hallall, ai jep aq sa mendon që duhet të japë. Nëse me këtë dhënie preket interesi i tij, atëherë ai jep vetëm një të pestën, sepse kjo është sasia që Allahu e ka bërë pastruese të pasurisë.

Nisabi

Më sipër kemi trajtuar një të pestën në katër drejtime: *E para*: Kemi shpjeguar të gjitha llojet e pasurive, për të cilat është detyrim të jepet një e pesta. *E dyta*: Nisabi që është i caktuar vetëm për mineralet, thesarin dhe sendet e nxjerra prej detit me zhytje. Shpjegojmë se nisabi për mineralin e për thesarin është njëzet dinarë dhe, kur arrin këtë shumë e më sipër, në mënyrë absolute, është detyrim të jepet një e pesta. Gjithashtu, kemi shpjeguar se për vlerë më pak se njëzet dinarë, nuk ka një të pestë.

Kur vlera e sasisë së mineralit ose e thesarit të gjetur arrin njëzet dinarë, nuk merret një e pesta prej totalit, por vetëm pasi hiqen shpenzimet e nxjerrjes e të rafinimit, sepse shpenzimet janë mjet për të trajtuar e për të shtënë në dorë këtë pasuri.

Nisabi për sendet e nxjerra prej detit me anë të zhytjes është vetëm një dinar dhe nuk jepet asgjë, kur është më pak se një dinar. Kur nisabi është më shumë prej një nxjerrjeje të vetme, është më mirë që për këtë pjesë të jepet një e pesta. Në qoftë se ai e le zhytjen, ose e neglizhon, por më pas i rikthehet zhytjes, ai nuk e bashkon pjesën e parë që ka nxjerrë me pjesën e dytë, ndryshe bashkimi do të ishte detyrë dhe nisabi do të merrej në konsideratë si total.

Nuk është kusht që plaçka e luftës të arrijë vlerën e nisabit, gjithashtu, nuk është kusht arritja e vlerës së nisabit as për nevojën vjetore, as për pasurinë hallall të përzier me pasurinë haram, as për jomyslimanin që është në besën e shtetit islam, kur ai ka blerë një tokë prej një myslimani, as në fitimet e vitit që teprojnë pas mbulimit të nevojës vjetore, por është detyrim për pronarin, që për të gjitha këto pasuri të japë një të pestën.

Sej'jid El Hakijm e ka komentuar këtë çështje në librin e tij "El Mustemsek", me këto fjalë: "Nga tërësia e teksteve (nusûs), sentencave (fetavà) dhe kontraktimet e mbledhjeve."

Ku duhet të shpenzohet një e pesta?

Ana e tretë, ndër katër anët që kemi trajtuar një të pestën, është çështja se ku duhet të shpenzohet një e pesta.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), duke komentuar ajetin e nderuar:

“وَأَعْلَمُوا أَنَّمَا غَنِمْتُمْ مِنْ شَيْءٍ فَإِنَّ لِلَّهِ خُمُسَهُ وَلِلرَّسُولِ وَلِذِي الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسَاكِينِ وَابْنِ السَّبِيلِ”

“Dijeni se një e pesta e asaj që fituat, i takon Allahut, të Dërguarit të Tij, të afërmve të tij, jetimëve, nevojtarëve dhe atyre që kanë mbetur në rrugë...” (Sure “El Enfâl”, ajeti 41), ka thënë: “Një e pesta është për Allahun, për të Dërguarin. Një e pesta për të Dërguarin është për Imamin, është për të afërmit e të Dërguarit, për jetimët e afërmve të të Dërguarit dhe për të mjerët prej tyre, si dhe për ata që kanë mbetur në rrugë, kurse një e pesta që nxirret prej të afërmve të të Dërguarit, është për të tjerët që nuk janë të afërm me të Dërguarin, si dhe për shumë të tjerë që përfshihen në këtë kuptim.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Një e pesta ndahet në gjashtë pjesë dhe janë pjesët për të cilat flet ajeti i Kur’anit: pjesa e Allahut, pjesa e të Dërguarit, pjesa e Imamit, i cili, me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, është prej të afërmve të të Dërguarit, pjesa e jetimëve, pjesa e të mjerëve, pjesa e atyre që kanë mbetur në rrugë dhe që janë prej të afërmve të të Dërguarit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse Allahu e ka bërë haram që të afërmit e të Dërguarit të marrin zekat e sadaka dhe një e pesta nuk është për të tjerët.

Pjesa që është për Allahun, është për të Dërguarin e Tij, pjesa që është për të Dërguarin është për Imamin, atëherë rezulton se prej një të pestës, tre pjesë i takojnë Imamit, domethënë se Imamit i takon gjysma e një të pestës, kurse tre pjesët e mbetura nga një e pesta pjesëtohen për jetimët e familjes së të Dërguarit, për të mjeruarit prej tyre, për ata që kanë mbetur në rrugë prej

tyre. Askush tjetër nuk bëhet pjesëtar në këto pjesë që i takojnë vetëm të afërmve të të Dërguarit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Këto pjesë prej një të pestës, Allahu i ka caktuar vetëm për ata dhe jo për të mjeruarit e për ata që kanë mbetur në rrugë prej njerëzve të tjerë, si kompensim për të afërmit e të Dërguarit për sadakatë e për zekatin që nuk marrin prej njerëzve dhe si pastrim për ta, për shkak të afërsisë që kanë me të Dërguarin e Allahut. Por nuk ka problem për sadakatë e për zekatin që ata i japin njëri-tjetrit.”

Të afërmit e të Dërguarit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) janë ata për të cilët Allahu ka caktuar pjesë në një të pestën dhe janë pikërisht ata që Allahu i Lartësuar i ka përmendur në fjalën e Tij të nderuar: “وَأَنْذِرْ عَشِيرَتَكَ الْأَقْرَبِينَ”-“**Dhe tërhiqi vërejtjen fare-fisit tënd më të afërt.**” (Sure “Esh Shuara”, ajeti 214) Janë vetëm bijtë e bijat e Abdul Mutalibit dhe jo prej shtëpive të tjera kurejshe, ose prej arabëve të tjerë. Ai që e ka nënën prej fisit Beni Hashim dhe babain prej kurejshëve të tjerë, ai e ka hallall të marrë zekat e sadaka, prandaj ai s’merr asgjë prej një të pestës.

Në fisin e Abdul Mutalibit hyjnë të gjithë ata që e kanë babën prej bijve të Abdul Mutalibit, siç janë djemtë e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), bijtë e Ukajlit, bijtë e Harithit, Ebu Lehebit dhe Abasitë. Por më shumë, kjo renditje, në afërsi, duhet të anojë kah ata që kanë lidhje më të ngushta me të Dërguarin më të madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), siç janë ata që rrjedhin prej barkut të Fatimes.

Rrugët e vërtetimit të përkatësisë fisnore

Përkatësia fisnore vërtetohet vetëm me argumente ligjore, ose me vendimin e gjykatësit, ose me fjalën e përhapur, që e bën detyrim të jetë e besueshme. Dikush ka thënë se për përkatësinë fisnore merret në konsideratë fjala e pretenduesit, thjesht nga pretendimi, sepse origjina është vërtetësia në punën e në fjalën e myslimanit. Në përgjigje të këtij dhënësi, ne themi: Kjo origjinë mohon prej tij rrenën me qëllim, por edhe dënimin e ndëshkimin e merituar. Por kjo është një gjë, kurse dhënia prej një të pestës këtij personi dhe shkarkimi i dhënësit nga detyrimi, është një gjë tjetër.

Pjesa e Imamit dhe pjesa e parisë

Më sipër shpjeguan se gjashtë pjesët e një të pestës reduktoheshin në dy pjesë, tre prej pjesëve i takonin Imamit, që ishin pjesa e Allahut, pjesa e të Dërguarit dhe pjesa për më të afërmit, kurse tre pjesët e tjera ishin për ata që kanë afërsi me të Dërguarin, që ishin pjesa për jetimët, për të varfrit dhe për ata që kanë mbetur në rrugë prej të afërmeve të Profetit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në lidhje me atë çka transmetojnë rregullat dhe bazat e medh'hebit, tekstet tregojnë se në kohën e pranisë dhe të mundësisë së arritjes së një të pestës te Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), atij i jepej e gjithë sasia e një të pestës, pa asnjë përjashtim. Nuk ishte e lejuar të veprohej me një të pestën për asgjë, pa lejen e tij. Për sa i përket veprimit të Imamit me një të pestën, pjesën e dytë të një të pestës ai e shpërndan te tre grupet e lartpërmendura, me qëllim që secili grup të marrë aq sa me atë që merr, të mbulojë

nevojat, kurse çka tepron, është për Imamin. Nëse për ata mbetet pa plotësuar ndonjë gjë, atëherë Imami e plotëson pjesën e tyre prej pjesës së vet. Në ditët tona, është krejtësisht pa kuptim ta zgjasim fjalën për këtë të drejtë. Për sa i përket kohës së mospranimit, që është koha në të cilën ne jetojmë, sipas veprimit më të përhapur në kohët e mëparshme e në kohët e mëvonshme, pjesa e të afërmve, të cilët janë jetimët e të mjeruarit, si dhe ata që kanë mbetur në rrugë, në fillim atyre u jepet pa ndërmjetësinë e gjykatësit ligjor, por me autorizim prej tij, me kusht që marrësit të jenë prej ndjekësve të dymbëdhjetë Imamëve dhe çdo jetim e çdo i mjeruar të jetë prej atyre që me të vërtetë janë nevojtarë dhe nuk kanë që të plotësojnë nevojën e një viti.

Gjithashtu, ai që ka mbetur në rrugë të mos ketë lidhje me vendin e tij, të jetë i varfër aty ku ka mbetur, edhe nëse në vendin e vet është i pasur. I mbeturi në rrugë të mos e ketë ndërmarrë udhëtimin me qëllim për të mëkatuar. Nuk është detyrë që pjesa e dytë e një të pestës të shpërndahet në të tri grupet: jetimë, të mjeruar dhe ata që kanë mbetur në rrugë, por lejohet që detyrimin që ke për të dhënë një të pestën t'ia japësh vetëm një nevojtar, me kusht që dhënia të mos jetë më shumë se plotësimi i nevojës së marrësit për një vit, qoftë edhe kur pjesa atij i jepet e gjitha njëherësh. Ai që e ka lejuar dhënien njëherësh të zekatit, e ka ndaluar atë në dhënien e një të pestës.

Autori i librit “El Xheuàhir” ka thënë: “Këtu unë nuk gjej asnjë kundërshtim.” Ndërsa ne e ndalojmë dhënien e njëherëshme në të dyja dhëniet, në dhënien e zekatit e në dhënien e një të pestës, Argumentet për mosdhënien njëherësh i kemi shpjeguar në kapitullin “Zekati”.

Ai që ka detyrim të japë një të pestën, nuk lejohet t'i japë asgjë prej shumës së një të pestës personave që ai e ka detyrim të shpenzojë, plotësisht ashtu siç ishte edhe për atë që ka detyrim të japë zekatin.

Përsërisim se ajo që ne thamë është veprim i praktikuar në kohët e mëparshme e në kohët e mëvonshme, sepse është veprim i argumentuar me fjalën e Kur'anit, me Sunetin e të Dërguarit dhe me fjalën e përbashkët të fukahave, prandaj detyrimi për dhënien e një të pestës, sipas kësaj mënyre, është bërë prej domosdoshmërive të fesë e të Islamit. Thuhet se detyrimi për dhënien e një të pestës ka rënë në kohën e mospranimit, megjithëse përpara ishte detyrim. Për shi'at është hallall të hanë një të pestën, megjithëse më parë për ta ishte haram të hanin një të pestën. Këtyre thënieve ne u themi: Detyrimi për dhënien e një të pestës është vërtetuar në mënyrë taksative dhe shumë të qartë, kurse rënia e detyrimit është e dyshimtë, sepse argumentet, në tërësinë e tyre, janë fare të qarta dhe përfshijnë kohën e mospranimit dhe kohën e pranimit (së imamit). Për sa u përket transmetimeve prej të cilave janë nxjerrë argumentet për rënien e detyrimit, ne themi se te ato argumente ka më shumë se një mangësi, të cilat i ka cituar dhe është përkushtuar në studimin e në klasifikimin të atyre argumenteve shehu El-Hemedanj në pjesën e tretë të librit "Misbâhul Fakijh". Kush dëshiron, le të referohet në këtë libër.

Për sa i përket pjesës së Imamit, që është gjysma e një të pestës, në lidhje me dispozitën për këtë pjesë, në kohën e mospranimit, qarkullojnë shumë thënie e spekulime, të cilat autori i librit "El Hadâik" i ka renditur përfundimisht në katërmbëdhjetë thënie.

E rëndësishme është thënia që flet për mbetjen në fuqi të dispozitës për pjesën e Imamit dhe për mosrënien e kësaj dispozite, si dhe detyrimi për shpenzimin e një të pestës për të mbështetur e për të forcuar fenë, ose për t'i dhënë dijetarëve që merren me mësimdhënie e me studime në fushën e parimeve që kanë lidhje me dispozitën e një të pestës.

Gjithashtu, për t'u dhënë njerëzve të mirë e të varfër që janë prej atyre që ndjekim dymbëdhjetë Imamët. Thënia e dytë përsëri flet për mosrënien e detyrimit për dhënien e një të pestës. Por në këtë thënie shtohet edhe pjesa për parinë, që jepet për jetimët e për të mjeruarit e afërm të të Dërguarit.

Thënia e tretë flet për rënien e detyrimit të një të pestës vetëm për fitimet dhe për tepricat e nevojës për një vit, por jo në të gjitha gjashtë kategoritë e tjera. Thënia e katërt flet për rënien në mënyrë absolute të detyrimit për dhënien e një të pestës dhe për shi'at lejohet të hanë një të pestën dhe për ata nuk është detyrim të japin asgjë prej një të pestës.

Këto ishin thëniet më të rëndësishme, kurse argumentet janë tre llojesh:

Argumenti i parë: Ata që tregojnë detyrimin absolut për dhënien e një të pestës në kohën e mospranimit dhe në kohën e pranimit, pa asnjë dallim, mes pjesës së Imamit dhe pjesës së parisë.

Argumenti për këtë, është ajeti i nderuar i Kur'anit:

“وَاعْلَمُوا أَنَّمَا غَنِمْتُمْ مِنْ شَيْءٍ”

“Dijeni se një e pesta e asaj që fituat” (Sure “El Enfâl”, ajeti 41), si dhe transmetime të shumta, të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*). Një pjesë prej tyre ne i kemi përmendur më parë. Midis këtyre transmetimeve është edhe fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Një e pesta jepet për çdo fitim që njerëzit realizojnë, pak ose shumë qoftë.”

Argumenti i dytë: Janë transmetimet që e shtrëngojnë shumë dhënien e një të pestës dhe për mosrënien e detyrimit në mënyrë absolute për dhënien e një të pestës në kohën e mospranimi të kohës së pranimi të Imami, ashtu siç tregon qartë fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nuk është hallall për asnjërin të blejë diçka prej një të pestës, derisa ajo të arrijë te ne që kemi të drejtë ta marrim. Për plaçkën e luftës dhe fitimet, ajo (një e pesta) është detyrim për ata çdo vit.”

Kjo kategori transmetimesh përforcon dhe mbështet kategorinë e parë të transmetimeve.

Argumenti i tretë, tregon hallallin dhe lejimin, si dhe rënien absolute të detyrimit për dhënien e një të pestës në kohën pranimi të mospranimi, ashtu siç është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Të gjithë ata që kanë të parë prindërit e mi, ata e kanë hallall pasurinë që kanë në dorën e tyre, të ardhur te ata prej të drejtës që na takon neve. Prandaj ai që është i pranishëm, le t’ia komunikojë atij që nuk është i pranishëm. Dëgjoni, ndjekësit tanë në këtë, domethënë në një të pestën. Bijtë e tyre e kanë hallall atë.”

Nuk është i mundur bashkimi mes llojit të dytë të transmetimeve, që vërteton detyrimin dhe mosrënien e detyrimit në mënyrë absolute për dhënien e një të pestës në kohën e pranimi të mospranimi dhe mes llojit të tretë, që e

mohon në mënyrë absolute dhënien e një të pestës, por e lejon një të pestën për shi'at.

Gjithashtu, nuk është i mundur bashkimi mes këtyre dy lloje transmetimesh, që saktësojnë detyrimin për dhënien e një të pestës në kohën e pranimit dhe e mohojnë dhënien e një të pestës në kohën e mospranimit, sepse do të ishte një bashkim arbitrar i mirëfilltë, për më tepër, kur për këtë bashkim s'ka argument as prej ligjit të fesë e as prej traditës. Nuk është i mundur bashkimi mes dy llojeve të transmetimeve, duke mbartur vërtetimin në rrugë veprimi të preferuar (*mustehab*) dhe mbartjen e mohimit në rrugë veprimi detyrim, sepse një kërkesë e këtillë nënkupton që në bazë mosdetyrimin për dhënien e një të pestës, madje as në kohën e pranimit. Kjo është plotësisht si mohimi i detyrimit për të agjëruar, ose mohimi i detyrimit për faljen e namazit, për kryerjen e Haxhit e për dhënien e zekatit.

Për sa i përket anëve të tjera që u përmendën, ose që do të përmenden në lidhje me bashkimin mes dy llojeve të transmetimeve, nuk janë më të mira se këto dy variante që u thanë. Atëherë, kontradikta mes llojit që tregon për mosrënien e detyrimit për dhënien e një të pestës në kohën e mospranimit dhe mes llojit që tregon për rënien e këtij detyrimi, prej të cilit nuk është e mundur të largohesh¹ dhe, bazuar mbi këto që u thanë,

¹ Mund të thuhet se, në origjinë, nuk ka kontradiktë mes transmetimeve që vërtetojnë dhënien e një të pestës dhe të transmetimeve që e mohojnë këtë dispozitë, për shkak të ndryshimit të subjektit e të shumëllojshmërisë së tij, pasi transmetimet që vërtetojnë dhënien e një të pestës, janë të mbartura mbi vullnetin për dhënien e një të pestës për shtatë kategoritë e pasurive dhe të qëndrimit të detyrimit në kohën mospranimit e të pranimit. Gjithashtu, janë edhe transmetime që flasin për plaçkën e luftës të fituar pa luftë, për të cilën do

nuk mund të shpëtohet prej njërit nga dy veprimet: ose përkushtim për qëndrimin e detyrimit për dhënien e një të pestës, përfshirë edhe pjesën e Imamit në kohën e pranimit e në kohën e mospranimit, ose angazhim në mosdetyrimin për dhënien e një të pestës. Prandaj nuk ka më vend për rrugë të tretë. Ai që angazhohet në llojin e dytë, del prej Islamit, për shkak se mohon atë çka është vërtetuar si domosdoshmëri e fesë. Prandaj në mënyrë të prerë rezulton angazhimi në llojin e parë, domethënë detyrimi për dhënien e një të pestës dhe mosrënia e këtij detyrimi në kohën e mospranimit, domethënë detyrimi për dhënien e një të pestës mbetet plotësisht ashtu siç ishte në kohën e prezantimit, pa as më të voglin ndryshim.

Bazuar mbi këto që u thanë, pjesa e Imamit në kohën e mospranimit shpenzohet në rrugën që ne dimë dhe me të cilën Imami është i kënaqur, si për shembull, për të mbështetur fenë, për të propaganduar ligjin e fesë. Prej qëllimeve më të dukshme të këtij propagandimi në kohën tonë është emërimi i profesorëve të aftë për të dhënë mësim e për të mbajtur ligjërata e leksione në fushën e fik'hut të Ehli Bejtit nëpër universitet e kohës, në ato perëndimore e lindore.

Për sa i përket shpenzimit të pjesës së Imamit, që shpenzohet për parazitët, për mercenarët e për ata që bëjnë tregti me fenë, pa diskutim që është prej punëve më të mëdha haram, madje është prej mëkateve të mëdha shkatërruese (*el mubikàt*). Në besimin tim, anulimi i pjesës së Imamit nga një e pesta është një mijë herë më i mirë se sa ta marrë këtë pjesë kjo kategori njerëzish,

të flitet në fundin e këtij kapitulli, prandaj shikoni në paragrafin "Plaça e luftës e fituar pa luftë" (*el enfâl*).

apo të ngjashmit me ta, sepse kjo do të ishte një nxitje për injorantin, që të vazhdojë në rrugën e tij të injorancës, për mendjemadhin, që të shkojë akoma më thellë në rrugën e pëlqimit të vetvetes dhe atij që ka shkarë në rrugën e humbjes, të vazhdojë në errësirën e kësaj rruge që ka nisur.

Gjatë kërkimeve në studimet e mia, jam njohur dhe kam gjurmuar burime të shumta për këtë çështje, jam njohur me thëniet e fukahave të hershëm, të mëvonshëm e të rinj. Gjithashtu, jam njohur me mendimet e tyre, në lidhje me pjesën e Imamit prej një të pestës në kohën e mospranimit të tij. Patjetër jam njohur edhe me fjalët e autorit të librit "*El Xhevahir*", fjalët e të cilit tregojnë qartë për shenjtërinë, madhështinë, përkushtimin e devotshmërinë e këtij autori, si dhe për dimensionet e largëta të vështrimit të tij, kur thotë: "Shembulli ynë për atë që nuk e detyron veten të jetë i përkorë në këtë botë, nuk ka mundësi të njihet me punët e mira e me punët e këqija, ashtu si janë ato në pikëpamjen e Imamit. Prandaj si mund të jenë ato me kënaqësinë e tij, kur nuk ka pastërti shpirti dhe kur, për të arritur gjëra të rëndomta, përdoret miqësia e afërsia e të tjera rrugë prej interesave të kësaj bote?! Në të vërtetë, disa e kanë pëlqyer këtë rrugë, duke i lënë të tjerët në ashpërsinë e urisë e të konfuzionit."

Sekreti i madhështisë në këto fjalë qëndron në faktin se shehu i nderuar e ka bërë pastërtinë e shpirtit prej gjërave të rëndomta, e ka bërë rrugë të drejtë për njohjen e punëve të mira e të punëve të këqija, ashtu siç janë punët realisht edhe te Imami (*Paqja qoftë mbi të!*). Për sa i përket vërtetimit, shikimit me imtësi dhe ndarjes në degë e nëndegë, në këndvështrimin e autorit të librit "*El Xheuàhir*", ato janë gjëra pa rëndësi, nuk janë as rrugë e as mjet për të njohur punët e mira e punët e këqija, për të cilat janë

vënë ligjet, kanë zbritur librat për të shpjeguar fetë dhe për këtë janë çuar të dërguarit, detyrën e të cilëve tani e kryejnë Imamët e pastër dhe dijetarët e nderuar.

Një pyetje: Sikur të supozohet se ai që ka detyrim të japë një të pestën, ka njohuri për vendet ku bëhet bamirësia dhe Allahu e i Dërguari i Tij është i kënaqur, kur pjesa e Imamit shpenzohet në ato vende, ose ai ka mundësi të marrë njoftim për këtë çështje prej një specialisti të kësaj fushe, por jo prej gjykatësit ligjor, a lejohet që ky njeri të punojë sipas asaj që di, ose sipas fjalës së specialistit dhe të shpenzojë pjesën e Imamit aty ku ai mendon se me veprimin e tij është i kënaqur Allahu e i Dërguari i tij, pa e referuar çështjen te gjykatësi ligjor, apo patjetër duhet ta referojë çështjen te ai, në atë mënyrë që, nëse ai shpenzon diçka prej pjesës së Imamit, pa autorizim prej gjykatësit ligjor, a shkarkohet nga detyrimi për dhënien e një të pestës, edhe atëherë kur në realitet dhënia e tij ka qëlluar në vendin e duhur?

Përgjigje:

Thënia më e përhapur është detyrimi për t'iu referuar gjykatësit ligjor, por kjo është prej atyre thënieve të përhapura, për të cilat s'ka argument as prej Kur'anit, as prej praktikës profetike (*sunetit*) e as prej logjikës, sidomos kur i gjithë shpenzimi realisht është bërë në vendin e duhur dhe me qëllim afrimin te Allahu i Lartësuar, duke ditur që argumenti për këtë thënie të përhapur është kundër saj, për shkak se kryerja e detyrimit qëndron në shpërndarjen e pjesës së Imamit.

Bazuar mbi këto që u thanë, kushti për t'iu referuar gjykatësit ligjor duket kusht i tepërt, sepse gjykatësi nuk është pikë referimi dhe mohon origjinën e detyrimit, kur dihet se në Islam nuk ka ndërmjetës mes Allahut e njeriut dhe Allahu i Lartësuar i pranon adhurimet e punët prej robit të Tij pa ndërmjetësues, derisa robi vazhdon të jetë i pastër në qëllimin e tij, kryen detyrimin ndaj Allahut dhe është i bindur ndaj urdhrave të Tij.

Aty ku nuk ka argument për detyrën e referimit të gjykatësi ligjor, në lidhje me pjesën e Imamit prej një të pestës dhe vendet ku ajo shpenzohet, një grup fukahash kanë thënë të njëjtat fjalë që thamë edhe ne, ndër të cilët përmendim sheh Mufijdin dhe autorin e librit “El Hadàik” Sej’jid El Hakijm.

Prej librit “El Mustemsek” do të citojmë tekstualisht: “Prej kësaj rezulton, për rezervë ruajtje nga gabimi, nëse nuk është më e fuqishme, arritja e kënaqësisë së tij, domethënë kënaqësisë së imamit, për lejimin e shpenzimit dhe, kur kënaqësia e Imamit arrihet me shpenzimin e pjesës së tij në një drejtim të caktuar, atëherë poseduesi i kësaj shume lejohet ta marrë vetë në dorë çështjen e shpenzimit të pjesës së Imamit prej një të pestës, pa qenë nevoja që ai t’i referohet gjykatësit ligjor.”

Autori i librit El Hadàik” ka thënë: “Për këtë, domethënë detyra për t’iu referuar gjykatësit ligjor, nuk kemi hasur asnjë argument dhe qëllimi që mësohet prej njoftimeve të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*) qëndron në përfaqësimin e gjykatësit në gjykim e në procedurat ligjore për marrjen e vendimit dhe të sentencave (*fetavà*) ligjore që ai nxjerr, kurse për vënien e pasurive në dorën e gjykatësit ligjor, nuk kam

hasur në ndonjë argument që të flasë as në përgjithësi e as në mënyrë të veçantë.”

Çështja qëndron, ashtu siç ka thënë autori i librit “El Hadàik: Në të vërtetë, përfaqësimi i juristit të fesë (*fakijh*) në vend të Imamit, është vetëm për gjykimin e çështjeve e për nxjerrjen e sentencave (*fetavà*) dhe jo për të marrë në dorë pasuri.

Gjithashtu, juristi i fesë ka detyrë të marrë në dorë të gjitha ato çështje që patjetër duhet të jenë në dorën e tij, siç janë çështja e marrjes në dorë të pronave vakëf, për të cilat nuk ka kujdestar të veçantë, ose ai merr në dorë çështjen e kujdestarisë së jetimëve, kur për të cilët nuk ka kujdestar të njoftuar verbalisht, ose për çështje të tjera, në të cilat përfaqësimi i tij është i domosdoshëm. Por kjo është një gjë, kurse mosdalja prej detyrimit për shlyerjen e borxhit, ose për dhënien e një të pestës në përgjithësi, ose për pjesën e Imamit, nëpërmjet referimit te gjykatësi ligjor, është një gjë tjetër.

Për sa i përket atij që ka thënë: Gjykatësi ligjor është personi që di më mirë vendet, ku është detyrë të shpenzohet pjesa e Imamit, këtij personi ne i përgjigjemi: Dorëzimi i pjesës së Imamit në dorën e gjykatësit, është pohim se gjykatësi ka përvojë në njohjen e vendeve ku duhet të shpenzohet pjesa e Imamit prej një të pestës dhe jo se është detyrë referimi te gjykatësi për çështjen e shpenzimit të pjesës së Imamit nga një e pesta.

Pasuritë e fituara pa luftë (el enfâl)

Drejtimi i katërt prej pesë drejtimeve të studimit mbi një të pestën është ajo që ka ardhur në Kur'an me emrin arabisht "el enfâl". Nga ana gjuhësore, kjo fjalë ka disa kuptime, ndër të cilat: plaçkë lufte, dhuratë dhe shtesë mbi atë që është shtënë në dorë, kurse në terminologjinë e ligjit të fesë, me këtë fjalë, kuptohet pjesa që i takon Imamit, është pjesa që ka kaluar te Imami prej të Dërguarit më të madh (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Allahu i Lartësuar urdhëron e thotë:

“يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْأَنْفَالِ ۖ قُلِ الْأَنْفَالُ لِلَّهِ وَالرَّسُولِ ۚ فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَصْلِحُوا ذَاتَ بَيْنِكُمْ”

“Të pyesin ty (o Muhamed) për pasuritë (e fituara në luftë) i thuaj: ato i takojnë Allahut dhe të Dërguarit, kijeni frikë Allahun dhe futni paqe në mesin tuaj...” (Sure “El Enfâl”, ajeti 1)

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “El Enfâl” është çdo tokë pa njerëz, që nuk sjell dobi, ose një tokë, ku kanë shkelur kuajt e luftës së myslimanëve, ose banorët e kanë dhënë me dëshirën e tyre, pa luftë.”

Në këto lloje tokash atij, domethënë Imamit, i takojnë majat e maleve, luginat, tokat e mbuluara me shkurre dhe çdo tokë pa jetë që s’ka pronar. Gjithashtu, Imamit i takojnë bagëtitë, që janë pronë e mbretërve, por jo bagëtitë e kafshët e rrëmbyera, sepse gjëja e rrëmbyer është e refuzuar.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Pasuria “el enfâl” është për Allahun dhe për të Dërguarin.”

Ajo që është për Allahun, është për të Dërguarin, i cili e vë atë ku të dëshirojë dhe, ajo që është për të Dërguarin, i takon Imamit.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se të gjitha pasuritë "*el enfâl*" i takojnë Imamit, pasi ato i janë kaluar atij prej Profetit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse Imami është zëvendësi dhe trashëgimtari i tij. Pasuritë "*el enfâl*" janë disa llojesh:

1- Toka që u merret jomyslimanëve pa luftë dhe, është e barabartë, qoftë kur banorët e saj janë larguar dhe ia kanë lënë atë mysliimanëve, qoftë kur mysliimanët u kanë dhënë mundësi atyre të qëndrojnë aty vullnetarisht.

2- Tokë e vdekur dhe, është e barabartë, qoftë kur ajo tokë kishte pronar dhe pastaj banorët e kanë braktisur, qoftë kur ajo nuk ka qenë e nuk është në pronësi të dikujt, siç janë shkretëtirat dhe brigjet e detit.

3- Majat e maleve, fundet e luginave dhe tokat e veshura me shkurre.

4- Çdo pasuri private e mbretit të luftës, e luajtshme ose paluajtshme, me kusht që ajo të mos jetë e rrëmbyer prej ndonjë mysliimani ose prej ndonjë jomysliimani, që ka marrëveshje me mysliimanët.

5- Çdo gjë prej plaçkës së luftës që Imami zgjedh për vete, para pjesëtimit të saj, si: kuaj, rroba e robëresha. Të gjitha sa

zgjedh Imami për vete, i takojnë atij, sepse të gjitha këto lloje pasurish janë të përfshira në fjalën “*el enfâl*”.

6- Trashëgimi i pronave që s’kanë trashëgimtar.

Të gjitha pasuritë “*el enfâl*”, me të gjitha pjesët e llojet e tyre, i jepen Imamit dhe nuk lejohet që me këto të bëhet ndonjë veprim, qoftë edhe për diçka të vogël pa lejen e pa miratimin e tij në kohën e pranimi të Imamit, kurse për kohën e mospranimi të Imamit, siç është koha jonë, fukahatë i kanë bërë pasuritë “*el enfâl*” hallall për shi’at dhe kanë dhënë fetva që t’u takojnë atyre, me qëllim që t’i shpenzojnë në ato vende, ku mund të sjellin të mira për Islamin dhe për interesin e përgjithshëm.

Për këtë dispozitë tregon fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Ajo çka na takon ne, u takon ndjekëse tanë. Çdo tokë që është në dorën e ndjekësve tanë, ata e kanë hallall atë dhe ajo mbetet hallall për ta derisa të shfaqet Imami ynë.*”

Dëshmori i dytë, në fundin e fjalës së tij për një të pestën, tekstualisht ka thënë: “Thënia më e saktë në gjendjen e mospranimi, është lejimi i pasurive “*el enfâl*”. Në kapitullin “Rigjallërimi i tokave të vdekura” do të njihemi me fjalën e Imamit: “*Ai që rigjallëron një tokë të vdekur, ajo i takon atij. Toka është e Allahut dhe e atij që e popullon atë tokë.*”

Gjithashtu, më poshtë do të mësojmë se trashëgimia që s’ka trashëgimtarë, i kthehet Shtëpisë së Pasurisë së myslimanëve. Autori i librit “El Hadàik”, në fundin e kapitullit “Një e pesta”, ka thënë: “Nga tërësia e thënieve të fukahave të mëvonshëm, thënia më e përhapur është fjala e tyre për qenien hallall e një të pestës,

në mënyrë absolute. Kjo fjalë e tyre është bazuar në njoftimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*).

Gjithashtu, për këtë lejim tregojnë një tufë transmetimesh të tjera, siç është transmetimi i përcjellë prej Junus bin Dhubjanit, transmetimi i përcjellë prej Mual'la bin Khunejsit, si dhe transmetimet që kanë ardhur në "Sahijhun" e Ebù Khàlid El Kàbelij dhe në "Sahijhun" e Ymer bin Jezijd, përfshirë edhe njoftimet e shumta që kanë ardhur në lidhje me rigjallërimin e tokës së vdekur dhe në lidhje me trashëgimin e pronës që s'ka trashëgimtarë e tjera transmetime të ngjashme me këto."

Es'sej'jid El Hakijm, në librin e tij "El Mustemsek", ka thënë: "Nuk përjashtohet vazhdimësia e gjendjes për të vepruar me tokat që i takojnë Imamit në të gjitha kategoritë e tokave që u thanë më sipër, madje në përgjithësi, pa asnjë mohim si sprovë dhe, nëse nuk do të ishte hallall veprimi me pjesën e Imamit, patjetër që shumica e njerëzve do të kishin rënë në veprimin haram."

Nuk mund të përjashtohet se qëllimi me transmetimet që flasin për rënien në mënyrë absolute të detyrimit për dhënien e një të pestës, ka të bëjë vetëm me rënien e detyrimit për pasuritë "*el enfâl*" dhe jo për shtatë kategoritë e pasurive të përmendura më sipër. Bazuar mbi këtë që u tha, bie edhe kontradikta mes transmetimeve që vërtetojnë detyrimin për dhënien e një të pestës në kohën e pranimiit e të mospranimiit dhe mes transmetimeve që e mohojnë këtë detyrim. Prandaj, për të dalë prej kësaj kontradikte, ne mbartim transmetimet që tregojnë mohimin në transmetimet që bëjnë hallall "*el enfâl*" dhe të transmetimeve që vërtetojnë detyrimin për dhënien e një të pestës dhe qëndrimin e

këtij detyrimi për shtatë kategoritë e pasurive. Por dihet se, kur subjektet janë të ndryshme dhe janë disa, përfundimisht, bie vetvetiu edhe kontradikta mes transmetimeve.

* * *

HAXHI¹

Nga ana gjuhësore, fjala “*haxh*” ka disa kuptime, ndër të cilat: qëllim dhe vajtje-ardhje në një vend. Në terminologjinë e ligjit të fesë, fjala “*haxh*” është qëllim vajtja në Shtëpinë së Shenjtë të Allahut (Qabe), për të kryer pranë saj adhurime të veçanta, të cilat do të sqarohen në vijim.

Detyrimi

Haxhi është një prej shtyllave të Islamit dhe është plotësisht si namazi, agjërimi e zekati, prandaj ai që e mohon Haxhin, me fjalën e Kur’anit, me fjalën e Profetit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë*

¹ E vërteta e Haxhit nuk kuptohet me anë të leximit e me mësim, pa e kryer atë konkretisht, sepse Haxhi është veprim praktik dhe jo teorik. Në kohët e hershme, një dijetar i madh, pasi plotësoi detyrën e Haxhit, tha: “Tani e kuptuam Haxhin, gjithashtu ne nuk kuptojmë as menstruacionet, derisa ato të vijnë. Në vitin 1363H, kam shkruar një libër për Haxhin sipas pesë medh’hebeve, pastaj në të njëjtin vit plotësova detyrën e Haxhit dhe, në vitin 1384 tw hixhrit shkrova librin që kemi në dorë, i cili erdhi pas studimit tim teorik të Haxhit dhe zbatimit të tij praktik. Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun, të Vetmit përgjegjës që e bëri mbarë për mua dhe për ty i dashur lexues të mësojmë e të punojmë.”

mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, del prej Islamit. Prandaj detyrimi për kryerjen e Haxhit nuk është vend për hulumtim (*ixhtihàd*) e as për traditë, sepse Haxhi është prej aksiomave të fesë. Megjithëkëtë, ne do të përmendin disa ajete të Kur'anit dhe disa transmetime që unë kam gjurmuar dhe jam përkushtuar në studimin e kuptimit të tyre, të cilat ne i përmendim në rrethet mësimore, me qëllim që të qartësohemi sa më mirë, prandaj gjithmonë kërkojmë mbështetje të nxjerrim argumente prej ajeteve të Kur'anit dhe prej transmetimeve.

Prej ajeteve të Kur'anit përmendin:

“...وَطَهَّرَ بَيْتِي لِلطَّائِفِينَ وَالْقَائِمِينَ وَالرُّكَّعِ السُّجُودِ”

“...dhe pastroje Shtëpinë Time për vizitorët, të cilët kur falin namaz qëndrojnë më këmbë, përkulur dhe bëjnë sexhde.” (Sure “Et Teubeh”, ajeti 26)

“وَأَذِّنْ فِي النَّاسِ بِالْحَجِّ يَأْتُوكَ رِجَالًا وَعَلَى كُلِّ ضَامِرٍ يَأْتِينَ مِنْ كُلِّ فَجٍّ عَمِيقٍ”

“Thirri njerëzit në Haxh dhe ata do të vijnë ty me këmbë e mbi devetë e rraskapitura prej rrugëve të largëta.” (Sure “Et Teubeh”, ajeti 27)

“وَأَتُمُوا الْحَجَّ وَالْعُمْرَةَ لِلَّهِ”

“dhe kryejeni Haxhin e umren për hir të Allahut...” (Sure “El Bekare”, ajeti 196)

“وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا ۚ وَمَنْ كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ”

“Për hir të Allahut vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi të udhëtojë te ajo dhe, kush mohon (mohon detyrën për të vizituar shtëpinë) Allahu, nuk ka nevojë për njerëzit.” (“Al Imran”, ajeti 97)

Dikush e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për fjalën e Allahut në ajetin e mësipërm: **“وَمَنْ كَفَرَ” - “dhe kush mohon”**: *“Mos vallë kjo fjalë do të thotë se, kush nuk kryen Haxhin, ka mohuar?”* Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha atij: *“Jo. Por kush thotë që nuk është kështu, ai ka mohuar.”*

Kush mohon që Haxhi është detyrim të kryhet, ai është mohues. Shumë fukaha dhe komentues të Kur’anit kanë thënë: *“Fjala mohim në këtë ajet do të thotë ai që e le me qëllim, sepse, nga ana gjuhësore, fjala “mohim” vjen edhe në kuptimin e lënies.”*

Pastaj pyetësi i tha Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): **“Si është kuptimi i fjalës së Allahut: “وَأَتُّوا الْحَجَّ وَالْعُمْرَةَ لِلَّهِ” - “dhe kryejeni Haxhin e umren për hir të Allahut...”?**

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: *“Do të thotë, ai që i kryen të dyja plotësisht dhe ai që ka veshur ihramin, ruhet prej të gjitha gjërave që duhet të ruhet, kur kryen Haxh e umre.”*

Pastaj pyetësi i tha: *“Si është kuptimi “Haxhi i madh” në fjalën e Allahut të Lartësuar:*

“وَأَذَانٌ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ إِلَى النَّاسِ يَوْمَ الْحَجِّ الْأَكْبَرِ”

“Dhe një thirrje prej Allahut e prej të Dërguarit të Tij drejtuar të gjithë njerëzve ditën e Haxhit të madh...” (Sure “Et Teubeh”, ajeti 3)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Haxhi i madh’ është qëndrimi në Arafat, kurse gjuajtja e guralecëve është ‘Haxhi i vogël’.”

Menjëherë

Padyshim që Haxhi është detyrim të kryhet vetëm një herë gjatë jetës. Por a është detyrë të kryhet menjëherë apo kur t’ia kesh ngenë? Në kuptimin që, kur realizohen kushtet e Haxhit dhe gjendet mundësia, personi që ka mundësi, a duhet të shkojë në Haxh, menjëherë në vitin kur gjen mundësinë, apo atij nuk i lejohet ta shtyjë kryerjen e Haxhit për vitin e ardhshëm, pasi në rast shtyrje, ai mëkaton dhe kështu ka detyrë të shkojë vitin e ardhshëm. Kur e le pas dore edhe në vitin e tretë, përsëri mëkaton, madje thotë se do të shkojë vitin e katërt. A bën apo nuk bën mëkat më këtë vonim e me këtë shtyrje për kryerjen e Haxhit, duke qenë mirë me shëndet e me gjendjen, apo ai ka të drejtë të përzgjedhë kohën për kryerjen e Haxhit, e kryen atë në vitin e parë apo në vitin tjetër? Apo kryerja e Haxhit është si puna e faljes së namazit, ai e fal namazin, sapo hyn koha e faljes, ose e vonon faljen e namazit deri afër mbarimit të kohës?

Përgjigje:

Dijetarët e fesë kanë një fjalë të përbashkët: Haxhi islam duhet të kryhet menjëherë dhe jo të shtyhet. Madje shumë prej këtyre dijetarëve kanë thënë se shtyrja e kryerjes së Haxhit është prej mëkateve të mëdha shkatërruese (*mùbikàt*). Prandaj as ne e as

dikush tjetër, nuk mund të vëmë në diskutim këtë fjalë të përbashkët të dijetarëve të fesë dhe aktuale në çdo kohë.

Në lidhje me këtë çështje, ne themi se kjo fjalë e dijetarëve nuk është argument në të cilin mund të mbështetesh, sepse prej bazave të medh'hebit njihet që fjala e përbashkët është argument në të cilin mund të mbështetesh, vetëm atëherë kur dihet se ky argument zbulon mendimin e Imamit të ruajtur prej gabimeve. Por, kur dihet se ka mundësi që ky argument mund të mos jetë bazuar në ndonjë ajet të Kur'anit, ose në ndonjë transmetim, ose në ndonjë njoftim origjinal, ose është me rezervë, ai bie si argument dhe nuk mund të merret në konsideratë, sepse dihet që dituria nuk kundërshton diturinë, gjithashtu, edhe mundësia, në asnjë gjendje, nuk mund të jetë së bashku me diturinë.

Ne dimë se fukahatë, për nxjerrjen e argumentit për detyrimin e kryerjes së Haxhit, janë mbështetur në transmetime që nuk tregojnë detyrimin për kryerjen sa më parë të Haxhit. Transmetimi më i qartë prej këtyre transmetimeve është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *"Kur njeriu ka fuqi e mundësi të kryejë Haxhin, por ai e shtyn kryerjen e tij, megjithëse nuk e pengon ndonjë punë, ose ndonjë ndalim, në të vërtetë, ai ka lënë njërin prej veprimeve të ligjëruara në Islam."*

Fjala "menjëherë" është e huaj në këtë thënie të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), pasi prej fjalës së Imamit kuptohet se zgjatja mund të çojë deri në lënien Haxhit, çka do të thotë se është lënë njëri prej veprimeve të ligjëruara të Islamit prej atij që e vonon kryerjen e Haxhit vitin e dytë ose vitin e tretë, megjithëse ka mundësi të udhëtojë deri atje shëndoshë e mirë.

Veç kësaj, për këtë pohim tregon edhe parafjala “là”, që do të thotë: Sikur thënia e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) të kishte qëllim shtyrjen e kryerjes së Haxhit, do të kishte thënë “e vonoi”. Prandaj nuk është më pak se mundësia e vullnetit për plotësimin e njërit prej dy kuptimeve, që shpreh transmetimi që thotë menjëherë dhe nuk tregon për shtyrjen, por flet vetëm për kryerjen e punës dhe me kaq mjafton. Përveç kësaj, dihet se shumica e njerëzve, madje edhe dijetarët e drejtuesit e fesë e shtyjnë kryerjen e Haxhit deri në vitin e pestë e të gjashtë, pasi edhe për ta nuk është gjendur mundësia për të kryer Haxhin. Prandaj nuk ka arsye të diskutohet, kur e shtyjnë kryerjen e Haxhit për vitin e dytë, pasi as ata e as të tjerët nuk mendojnë se më këtë shtyrje kanë lënë njërin prej veprimeve të ligjëruara të Islamit.

Pavarësisht nga sa u tha, kryerja e Haxhit vitin e parë, pasi gjendet mundësia, është veprimi më i mirë, është veprim që qëndron më mirë në ruajtje të fesë. Allahu i Lartësuar thotë në librin e Tij: “فَاسْتَبِقُوا الْخَيْرَاتِ” - “...shpejtoni në punët e mira...” (*Sure “El Bekare”, ajeti 148*), sepse shtyrja e vonimi mund të sjellë edhe humbjen e mundësisë për kryerjen e Haxhit, për shkak të ndodhivë të kohës.

Kushtet

Haxhi është detyrim me disa kushte:

1- Mendja

Kur njeriu humb gjënë më të vyer që i është dhuruar, për atë bien obligimet. Në qoftë se i çmenduri përmendet për aq kohë sa është e mjaftueshme për kryerjen e Haxhit me të gjitha veprimet, nëse ka mundësi, ky person ka detyrim të kryejë Haxhin. Por nëse koha në të cilën ai ndërgjegjësohet nuk është e mjaftueshme për kryerjen e të gjitha veprimeve të Haxhit, atëherë detyrimi për këtë person bie.

2- Arritja e moshës në të cilën njeriu obligohet me detyrimet e fesë

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Sikur një djalë i vogël të ketë bërë Haxh dhjetë herë dhe pastaj ai arrin moshën e pjekurisë (seksuale), ka detyrë të kryejë farzin (detyrimin) e Islamit.”

Është e kuptueshme se kryerja e një adhurimi për të cilin akoma nuk je i obliguar, nuk e rrëzon detyrimin për kryerjen e atij adhurimi, megjithatë, në vetvete, kryerja e adhurimit, kur nuk je i obliguar, është adhurim mustehab. Por si do të ishte, nëse ai e kryen adhurimin thjesht për t’u ushtruar?¹ Pavarësisht nga sa u

¹ Shumë fukaha ose shumica e tyre mendojnë se adhurimi që kryen fëmija që dallon, është i vlefshëm në kuptimin se fëmija urdhërohet të kryejë adhurim jo si obligim, pasi adhurimi i fëmijës është adhurim mustehab dhe fëmija shpërblehet për adhurimin që kryen. Ne mendojmë se adhurimi i fëmijës është i vlefshëm, qoftë kur kryhet thjesht për t’u ushtruar dhe shpërblimi për adhurimin e fëmijës shkon për kujdestarin e tij që e ushtron në atë adhurim. Në lidhje me këtë çështje: Së pari, tregon transmetimi i ardhur për agjërimin e fëmijës, në të cilin thuhet se “në adhurimin e fëmijës ka ushtrim dhe ndalim nga degjenerimi”. Të njëjtin mendim ka edhe Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!).

Së dyti, obligimi nuk ndahet në pjesë, por meqenëse kryerja e një adhurimi të obliguar prej fëmijës konsiderohet adhurim mustehab dhe i vlefshëm, patjetër

tha, fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se Haxhi që kryen fëmija që dallon (*el ueledul mumej'jiz*), qëndron në lejimin prej kujdestarit të fëmijës.

Për kujdestarin (prindi e të afërmit e tjerë) është mustehab ta veshë me ihram fëmijën që nuk dallon dhe së bashku me fëmijën të kryejë tavavin rreth Qabes e të bëjë për fëmijën gjuajtjen e guralecëve. Gjithashtu, kujdestari ka detyrë të rruajë kokën e fëmijës e të tjera punë të Haxhit. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Shikoni fëmijët që kini me vete dhe shkoni së bashku me ata në pikat e Mikatit (vendi i caktuar për veshjen e ihramit) që edhe fëmijët të veprojnë si ju që do të hyni në ihram, bëni tauaf së bashku me fëmijët, kurse gjuajtjen e gurëve për fëmijët bëjeni ju. Kush nuk ka mundësi të bëjë kurban për fëmijën, kujdestari i tij le të agjërojë për fëmijën.”*

Autori i librit “El Xheuàhir” ka cituar prej fukahave më të dëgjuar se, kur fëmija që ka arritur moshën, kur dallon gjëra, fillon punët e Haxhit. Por më pas, para se të shkohet në Arafat, ai e ndien veten të pjekur (seksualisht). Ai vazhdon kryerjen e veprimeve të tjera të Haxhit. Fakti që ai e arriti moshën, i shlyen atij detyrimin që kishte për plotësimin e Haxhit islam. Kjo vërtetohet me transmetimin e ardhur prej Ehli Bejtit: “Kush arrin Arafatin, ai ka arritur Haxhin.”

3- Mundësia

Në lidhje me mundësinë, do të flitet në një kapitull të veçantë. Kurse për sa i përket bërjes synet, një grup fukahash janë

duhet të jetë i vlefshëm, edhe atëherë kur fëmija kryen adhurim të detyrueshëm. E njëjta gjë është edhe kur fëmija ndalohet prej punëve haram. Për këtë nuk ka asnjë që të ketë thënë ndonjë fjalë kundër.

shprehur se bërja synet e burrit është prej kushteve për kryerjen e Haxhit dhe të vlefshmërisë së Haxhit, por nuk është kusht për origjinën e obligimit për kryerjen e Haxhit. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) në lidhje me një kristian që ka përqafuar Islamin: *"A duhet ta kryejë ai Haxhin para se të bëhet synet?"* Ai tha: *"Jo, duhet të fillojë me synetin."*

Bazuar mbi faktin e vënies në konsideratë të pastërtisë, ky kristian, që përqafoi Islamin, konsiderohet prej atyre që kanë mundësi të pastrohen, sepse, pa pastrim, nuk do të ishte i vlefshëm Haxhi e tauafi.

* * *

PËRMBAJTJA 3

AGJËRIMI.....	5
Kuptimi i agjërimit.....	5
Kategoritë e agjërimit.....	6
Nijeti i agjërimit.....	6
Koha e agjërimit.....	13
Kushtet.....	13
Ai që është në gjumë dhe ai që humb vetëdijen.....	15
PRISHËSIT E AGJËRIMIT.....	17
Qëndrimi në gjendjen xhunub	23
VEPRIME MEKRUH DHE JO MEKRUH.....	28
Veprimet me kerahet.....	28
Veprime jo mekruh	30
PRISHJA E AGJËRIMIT DHE DETYRIMI PËR SHLYERJEN.....	31
Harresa	31
Imponimi.....	32
Mospasja dijeni.....	33
Etja e madhe.....	34
Shlyerja.....	35
Shlyerja e Ramazanit.....	35
Shlyerja për kryerjen kaza të Ramazanit.....	39
Shlyerja për agjërimin e taksur (nedhr).....	40
Shlyerja për agjërimin e iëtikâfit.....	40
Disa shlyerje:.....	41

Ai e prish agjërimin, pastaj agjërimi nuk është më detyrim për të.....	43
Shlyerje dhe rrahje.....	44
Ekzekutimi i agjërimprishësit kundërshtar dhe neglizhues.....	44
Pamundësia për të kryer shlyerjen.....	45
Shpenzimi për shlyerjen.....	46
AGJËRIMI DHE AGJËRIMI KAZA.....	47
Shlyerja pa agjërim kaza.....	47
Agjërim kaza pa shlyerje.....	50
Sëmundja.....	56
Udhëtimi.....	59
Agjërimi kaza për të vdekurin prej më të afërmit të tij.....	62
VËRTETIMI I DALJES SË HËNËS SË RE.....	63
Shikimi me sy.....	63
Lajmi i përhapur (esh shijàu).....	64
Plotësimi i numrit.....	65
Argumenti ligjor.....	66
Vendimi i gjykatësit ligjor.....	68
Fjalët e astronomëve.....	73
I'TIKAFI.....	73
Kuptimi i i'tikafit.....	73
I'tikafi është adhurim i pëlqyer.....	74
Kushtet.....	75
Çështje.....	79
ZEKATI.....	79
Kuptimi i zekatit.....	80
Detyrimi.....	82
Kush ka detyrim të japë zekat?.....	85
Jomyslimani.....	87
Pasuritë për të cilat është detyrim dhënia e zekatit.....	88

Fukahatë.....	91
ZEKATI PËR KAFSHËT SHTEPIAKE.....	91
Devetë.....	92
Fukahatë.....	94
Lopët.....	95
Fukahatë.....	97
Dhentë.....	97
Fukahatë.....	99
Kushte të tjera në lidhje me kafshët shtëpiake.....	102
ZEKATI PËR DY LLOJET E MONEDHAVE.....	102
Floriri.....	102
Fukahatë.....	103
Argjendi.....	104
Fukahatë.....	104
Kushtet.....	106
Çështje:.....	108
ZEKATI I PRODHIMEVE KOKRRA.....	108
Nisabi.....	108
Prona.....	109
Sasia e zekatit.....	111
Fukahatë.....	111
Ushqimi dhe pjesa e pushtetit.....	112
A është zekati e drejtë e njeriut, apo është ortakëri për pasuritë konkrete?.....	113
Fukahatë.....	114
Mallrat e tregtisë.....	116
Fukahatë.....	116
ATA QË KANË TË DREJTË TË MARRIN ZEKAT.....	118
Ata që kanë të drejtë të marrin zekat.....	118
Fukahatë.....	121

Të varfrit e të mjeruarit.....	121
Pasurimi i të varfrit.....	122
Ai që pretendon se është i varfër.....	123
Punonjësit në sektorin e zekatit.....	125
Atyre që u duhet fituar zemra.....	127
Për lirim të robërve.....	128
Të zhyturit të borxhe.....	128
Në rrugën e Allahut.....	129
Ai që ka mbetur në rrugë.....	131
Cilësitë e atyre që kanë të drejtë të marrin zekat.....	131
DISPOZITAT E ZEKATIT.....	135
Nijeti.....	135
S'ka ndërmjetësues mes Allahut e njeriut.....	136
Mënyra e shpërndarjes së zekatit.....	137
Pronari i pasurisë është i vërtetë në fjalën e tij.....	139
Transferimi i zekatit.....	140
Sasia më e pakët që i jepet të varfrit.....	141
Mashtrimi ndaj Allahut e njerëzve.....	142
SADEKAJA E FITRIT.....	145
Detyrimi për dhënien së sadakasë së Fitrit.....	145
Kujt është detyrim t'i jepet?.....	146
Fukahatë.....	146
Për kë është detyrim të jepet sadekaja e Fitrit?.....	147
Fukahatë.....	147
Sasia dhe lloji i sadakasë së Fitrit	148
Fukahatë.....	148
Koha e dhënies së sadakasë së Fitrit.....	149
Fukahatë.....	150
Kujt i jepet sadakaja e Fitrit?.....	151
Fukahatë.....	151

Çështje.....	152
NJË E PESTA.....	154
Detyrimi për dhënien e një të pestës.....	154
Pasuritë për të cilat është detyrim dhënia e një të pestës.....	155
Mallrat, plaçka e luftës.....	155
Mineralet.....	157
Thesari.....	159
Ai që gjen thesar në tokën e tjetrit.....	160
Sendet e nxjerra me zhytje.....	164
Më shumë se nevoja për një vit.....	165
Përkufizimi i nevojës për një vit	167
Jomyslimani në besën e shtetit islam dhe blerja e tokës.....	169
Përzierja e hallallit me haram.....	170
Nisabi.....	171
Ku duhet të shpenzohet një e pesta?.....	172
Fukahatë.....	173
Rrugët e vërtetimit të përkatsisë fisnore.....	175
Pjesa e Imamit dhe pjesa e parisë.....	175
Pasuritë e fituara pa luftë (el-enfâl).....	186
Fukahatë.....	187
HAXHI.....	191
Detyrimi.....	191
Menjëherë.....	194
Kushtet	196

فقه الإمام جعفر الصادق عليه السلام

المؤلف: محمد جواد مغنية

الجزء الثالث

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفى

تيرانا: 2018

اسم الكتاب: فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام - الجزء الثالث

المؤلف: محمد جواد مغنية

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفى

المشرف العام: شيخ وُلُنت مِرِيَا

التصحيح اللغوي: يريدا كولا

الاخراج و الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعية "النسيم"

المطبعة: انتشارات "لبلو"

تيرانا: 2018